

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**K O N C E P T I  
PËR EDUKIM DHE ARSIM FILLOR NËNTËVJEÇAR**

**Shkurt, 2007**

Konceptin për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçar e përpiloi komisioni në përbërje të ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Komisioni në punën e vet udhëhiqej nga të arriturat bashkëkohore në lëmitë që kanë të bëjnë me arsimimin e fëmijëve të moshës prej 6 deri 15 vjeç, si dhe profesionizmit, kompetencave dhe përgjegjësive të tyre.

Anëtarët punën e tyre e kanë bërë në mënyrë të pavarur dhe pa trysni dhe përfshihen në përgatitjen e konceptit varësisht nga mundësitë dhe lëmitë e tyre në interesim dhe profesionalizëm.

Për vendimet e propozuara në koncept anëtarët e komisionit nuk u ngadhënjyhen por të gjithë i shprehën mendimet dhe sugjerimet e tyre për çështje të caktuara. Çdo anëtar e pranoi versionin përfundimtar të konceptit edhe përveç mendimit tjetër të ndonjë çështje të caktuar.

Vendimet përfundimtare i ngërthejnë edhe vërejtjet edhe sugjerimet të marra nga opinioni i profesionalizuar pas debatit publik për propozim dokumentin.

### ***Anëtarë të komisionit për përpilimin e Konceptit për arsimim dhe edukim fillor nëntëvjeçar***

- *Anëtarë për krijimin e kornizës ligjore, konsultime dhe përkrahje gjatë përpilimit të konceptit:*

- Sulejman Rushiti, ministër i Arsimit dhe Shkencës
- Pero Stojanovski, sekretar shtetëror në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

- *Anëtarë për përpilimin e konceptit:*

- Mr. Tashe Stojanovski, udhëheqës i Njësisë për hulumtim, zhvillim dhe çështje sistematike;
- Mitko Çeshllarov, udhëheqës i Sektorit për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore;
- Vesna Horvatović, drejtor në Byronë e zhvillimit të arsimit;
- Liljana Samarxhiska- Panova, udhëheqëse në Njësinë për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe klasor;
- Sillvana Veteroska, udhëheqës në Sektorin për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe punë profesionale këshilldhënëse
- Dr. Nikolina Kenig, Instituti për psikologji, Fakulteti Filozofik, Universiteti „Shën. Kirili dhe Metodi“ – Shkup;
- Dr. Lena Damovska, Instituti për pedagogji, Fakulteti Filozofik, Universiteti „Shën. Kirili dhe Metodi“ – Shkup;
- Dr. Xheladin Murati, Fakulteti Pedagogjik – Shkup;
- Dr. Lulita Isaku, Universiteti shtetëror në Tetovë;
- Dr. Ruhi Baku, Universiteti i Evropës Juglindore- Tetovë.

## Përmbajtja

<i>PJESA E PARË – ANALIZA E ARSIMIT FILLOR</i> .....	6
<i>HYRJE</i> .....	7
<i>ORGANIZIMI DHE UDHËHEQJA</i> <i>Tregues themelor për arsimin fillor</i>	
<i>VAZHDIMI I ARSIMIT TË DETYRUESHËM DHE ORGANIZIMI I</i> <i>BRENDSHËM I TIJ</i> .....	8
<i>Përvoja në Evropë</i> .....	8
<i>Përvoja në Maqedoni</i> .....	9
<i>Organizimi i mësimi dhe pushimet e nxënësve</i> .....	9
<i>STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR</i> .....	11
<i>Lidhshmëria e arsimit dhe edukimit parashkollor me atë fillor</i> .....	11
<i>Karakteristikat e planit mësimor dhe programet mësimore</i> <i>për shkollë fillore</i> .....	12
<i>Lëndë të detyrueshme në klasat e ulta</i> .....	12
<i>Lëndë të detyrueshme në klasat e larta</i> .....	13
<i>Lëndë zgjedhore</i> .....	15
<i>Lëndë fakultative</i> .....	16
<i>Orë për bashkësinë e klasës</i> .....	16
<i>Mësim plotësues dhe shtues</i> .....	16
<i>ARSIMIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË POSAÇME</i> .....	16
<i>NXËNËSIT E TALENTUAR</i> .....	17
<i>PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I MËSIMIT</i> .....	18
<i>Lëndë mësimore sipas periudhave dhe cikleve arsimore</i> .....	18
<i>Lëndë mësimore në periudhën përfundimtare ose ciklin</i> .....	19
<i>Mësimi i individualizuar dhe formimi i paraleleve</i> .....	20
<i>Planifikimi dhe organizimi i mësimi në shkollat tona</i> .....	21
<i>VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE PËRPARIMI I NXËNËSVE</i> .....	21
<i>Përvoja në vendet e zhvilluara</i> .....	21
<i>Përvoja e vlerësimit të njohurive të nxënësve në shkollat tona</i> .....	23
<i>ARSIMIMI I ARSIMTARËVE DHE KOMPETENCAT E TYRE</i> .....	24
<i>Çështjet dhe problemet aktuale</i> .....	25
<i>Zhvillimi i sistemit për trajnimin e arsimtarëve</i> .....	26
<i>BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT</i> .....	27
<i>Funksionet e shërbimit profesional në shkollë</i> .....	28
<i>Ç'ka tregon përvoja jonë</i> .....	28
<i>TEKSTE SHKOLLORE, DORACAKË DHE FLETORË PUNE</i> .....	29
<i>REZULTATE NGA ANALIZAT DHE HULUMTIMET</i> <i>TJERA RELEVANT</i> .....	30
<i>TRANSPORT PËR NXËNËSIT NË NGA SHTËPIA</i> <i>NË SHKOLLË DHE ANASJELLTAS</i> .....	30

SHQYRTIMI PËRFUNDIMTAR SI BAZË PËR NDRYSHIMET	31
PJESA E DYTË – KONCEPTI PËR ARSIM DHE EDUKIM	
FILLOR NËNTËVJEÇAR	
<i>HYRJE</i>	36
<i>PARIMET E ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR</i>	37
<i>Parim i demokracizmit</i>	37
<i>Parim i jodiskriminimit</i>	37
<i>Parim i respektimit të dallimeve individuale ndërmjet nxënësve</i>	37
<i>Parim i zhvillimit të plotë të personalitetit të nxënësit</i>	38
<i>Parim i interesimit më të mirë të fëmijës</i>	38
<i>Parim i pjesëmarrjes aktive të nxënësve të jetës në shkollë</i>	38
<i>Parim i cilësisë së arsimit dhe krahasim ndërkombëtar të njohurisë</i>	38
<i>Parim i karakterit të përgjithshëm arsimor në shkollë fillore</i>	39
<i>Parim i përgatitjes të nxënësve për mësim të përjetshëm</i>	39
<i>Parimi i të kuptuarit të të tjerëve dhe multikulturalizmit</i>	39
<i>Parim për inkuadrim të nxënësve me nevoja të</i>	
<i>posaçme arsimore në arsimin fillor</i>	40
<i>Parim i sigurisë fizike dhe shëndetësore</i>	40
<i>Parim i autonomisë, kompetencës dhe përgjegjësisë</i>	40
<i>Parim i partneritetit ndërmjet shkollës, prindërve dhe mjedisit lokal</i>	40
<i>QËLLIMET E ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR</i>	41
<i>ORGANIZIMI I MËSIMIT NË SHKOLLË FILLORE</i>	42
<i>Fillimi i shkollimit</i>	43
<i>Periudha e parë e mësimit prej klasës së I deri të III</i>	44
<i>Periudha e dytë prej klasës së IV deri të VI</i>	45
<i>Periudha përfundimtare prej klasës së VII deri të IX</i>	45
<i>Arsimi fillor i të rriturve</i>	46
<i>Plani i mësimit në vitin shkollor</i>	46
<i>PLANIFIKIMI I MËSIMIT</i>	
<i>PLAN MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR PREJ KLASËS SË I DERI TË IX</i>	
<i>Karakteristikat elementare të mësimit</i>	50
<i>Lëndë të detyrueshme</i>	50
<i>Lëndë zgjedhore</i>	51
<i>Përcaktimi i nxënësve për lëndët zgjedhore</i>	52
<i>Obligimet e shkollës për lëndët zgjedhore</i>	53
<i>Puna e individualizuar dhe grupore në mësim</i>	53
<i>Mësimi plotësues</i>	54
<i>Mësimi shtues</i>	55
<i>Bashkësia e klasës</i>	56
<i>Programi i zgjeruar në shkollë</i>	56
<i>VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE PËRPARIMI I NXËNËSVE</i>	56
<i>SHKOLLIMI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË POSAÇME ARSIMORE</i>	59
<i>AKTIVITETE JASHTËSHKOLLORE</i>	60
<i>Kujdesi për shëndetin e nxënësve</i>	62
<i>Bashkëpunim me mjedisin lokal</i>	62

<i>ARSIMI FILLOR PËR MUZIKË DHE BALET</i> .....	63
<i>ARSIMIMI I ARSIMTARËVE</i> .....	65
<i>KOMPETENCA, TË DREJTA DHE PËRGJEGJËSI</i> .....	67
<i>Të drejtat dhe obligimet e nxënësit, shkollës, prindërve dhe komunës</i> ....	68
<i>Masat edukative</i> .....	70
<i>BOTIMI, ZGJEDHJA DHE VLERËSIMI I TEKSTEVE DHE</i> <i>LITERATURËS TJETËR SHKOLLORE</i> .....	70
<i>MËNYRAT E APLIKIMIT TË NDRYSHIMEVE NË SISTEMIN</i> <i>SHKOLLOR</i> .....	71
<i>Zbatimi dhe sigurimi i kushteve adekuate</i> .....	71
<i>Përgjegjësia për cilësi në arsim</i> .....	72
<i>Zhvillim i sistemit për përcjellje të cilësisë arsimore</i> .....	72
<i>Lidhshmëria dhe integrimi në programet mësimore</i> .....	73
<i>REZULTATET E PRITURA</i> .....	73
<i>DINAMIKA E ZBATIMIT TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR</i> .....	73
<i>AKTIVITETE, KORNIZA KOHORE DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE</i> <i>PËR ZBATIMIN E ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR</i> .....	74
<i>PJESA E TRETË – SHTOJCAT BASHKANGJITËSE TË KONCEPTIT</i> .....	77
<i>Të dhëna statistikore për arsimin fillor në Maqedoni</i> .....	78
<i>Pikëpamje për arsimin fillor dhe të (mesëm të ulët) në shtetet tjera</i> ....	80
<i>Planet mësimore të vendeve evropiane për arsimin fillor</i> <i>(dhe të ulët të mesëm)</i> .....	82
<i>LITERATURA E SHFRYTËZUAR</i> .....	112

**A N A L I Z A**  
**E ARSIMIT FILLOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE NË VENDET TJERA**

**PJESA E I**

## *I. HYRJJE*

Qëllimi i analizës është që të japë raport për arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë si dhe për vendet tjera të zhvilluara, posaçërisht të Unionit Evropian. Analiza do të përdoret gjatë mendimit për formimin e konceptit për arsimin fillor nëntëvjeçar dhe planin mësimor në shkollë fillore. Për këtë qëllim këtu janë përfshirë aspektet kyçe që vijojnë:

- organizimi dhe udhëheqja në arsimin fillor;
- struktura e planit mësimor;
- planifikimi i mëimit;
- arsimimi i fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore;
- vlerësimi i nxënësve dhe përparimi në arsim;
- arsimimi i arsimtarëve dhe kompetencat e tyre;
- bashkëpunimi me prindërit;
- tekste shkollore dhe doracakët.

Përveç aspekteve të cekura janë përfshirë dhe çështjet kryesore për arsimin fillor të muzikës dhe vallëzimit dhe arsimit fillor për të rriturit.

Shqyrtohen gjendjet për bashkëpunim në shkollë fillore me mjedisin lokal, kurse veçanërisht me prindërit.

Veçanërisht janë bërë vlerësime për problemet aktuale në raport me cilësinë e librave dhe doracakëve për nxënësit dhe arsimtarët, revistat fëmijërore dhe literatura tjetër që është e lidhur me veprimtarinë e arsimit dhe edukimit fillor.

Në analizë janë zgjedhur këto aspekte, para së gjithash për shkak të nevojës që të fitohen njohuri të argumentuara themelore për mangësitë, por edhe për anët e mira të arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë. Siç u theksua, gjatë kësaj merren të dhënat për arsimin fillor në ato shtete që kanë traditë në shkollim në Evropë dhe që kanë reforma të suksesshme.

Për shumë çështje dhe nota që janë përfshirë në analizë, përgjigje edhe më konkrete, tregues apo argumente mund të gjinden në pasqyrën krahasuese, por veçanërisht për zgjatjen e arsimit të detyrueshëm dhe fillimi i shkollimit, organizimi i brendshëm i arsimit të detyrueshëm, struktura e planit mësimor në shkollë fillore dhe për arsimin e detyrueshëm, organizimin e mëimit dhe pushimet e nxënësve, si dhe të dhënat për ngarkesën e nxënësve në arsimin e detyrueshëm.

Në shtojcë ka edhe të dhëna të rëndësishme për gjendjen në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë.

Analiza tërësisht është e formuar me mbikëqyrjet përfundimtare që merren si bazë për ndryshimet.

## *II. ORGANIZIMI DHE UDHËHEQJA*

Në kushtetutën e Republikës së Maqedonisë në nenin 44 është e caktuar se arsimi fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë. Arsimit fillor rregullohet me Ligjin për arsim fillor. Kjo zbatohet në shkolla fillore, kurse për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore, varësisht nga lloji dhe shkalla e nevojave të tyre, organizohen shkolla të posaçme fillore dhe paralele në shkolla fillore. Mësimi dhe format tjera të punës edukativo-arsimore në shkollë në kuadër të programeve të garantuara për nxënësit është pa pagesë dhe financohet me mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Komunat i themelojnë shkollat fillore sipas mendimit të marë paraprak të mendimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Shkolla fillore në qëndrimin e saj mund të ketë një ose disa shkolla rajonale që organizohen në vendbanime me numër të vogël nxënësish, për të cilat vendos themeluesi pas mendimit paraprak të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Veprimtaria edukativo-arsimore në shkollë fillore realizohet sipas planit mësimor dhe programeve mësimore që i sjell Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Shkollat fillore

ju mundësojnë të gjithë shtetasve të Republikës së Maqedonisë që t'a realizojnë të drejtën në arsimin fillor me mësim të organizuar dhe forma tjera të punës edukativo-arsimore edhe atë me vëllim që përcaktohet në Ligjin për arsimin fillor, gjegjësisht me planin mësimor dhe programet mësimore për arsimin fillor.

Obligimet për financimin e mësimin dhe punën tjetër edukativo-arsimore, që janë të paraparë sipas planit dhe programeve mësimore, janë në përputhje me komune dhe shtetit. Nga burimet e vendit ndahen mjete të caktuara për të dalurat dhe të arrdhurat e të punësuarëve për zbatimin e mësimin dhe aktiviteteve të tjera edukativo-arsimore sipas planit mësimor për arsimin fillor, mjetet për të ardhurat e arsimtarëve për qëndrim të vazhdueshëm dhe mësim tërëditor për nxënësit prej klasës së I deri të IV, si dhe për arsimin fillor të muzikës dhe vallëzimit. Nga burime të njejta mbulohen shpenzimet materiale të shkollave për mirëmbajtjen e hapsirës shkollore dhe furnizime të mjeteve dhe përgatitjeve mësimore. Komunitat në bashkëpunim me pushtetin qëndror sigurojnë mjete për transportin e nxënësve dhe për vendosjen dhe ushqimin në konviktet e nxënësve.<sup>1</sup>

#### • **Tregues themelor për arsimin fillor**

Tregues statistikor themelor është numri i nxënësve të cilët regjistrohen në klasën e I. Në periudhën prej vitit 1991 deri në 2005 në arsimin fillor të Republikës së Maqedonisë ka filluar dukshëm të zvogëlohet numri i nxënësve. Prej 33 993 nxënësve të regjistruar në klasën e I në vitin shkollor 1991/92 numri është zvogëluar në 25 791 nxënës të regjistruar në vitin 2004/2005. Në fillim të vitit 2006/2007 në vitin përgatitor në shkollë fillore janë regjistruar 23 684 nxënës, prej të cilëve 17 779 nxënës në shkollë fillore dhe 5905 në kopshte, përderisa përsëri në të njejtin vit në klasë të parë janë regjistruar rreth 23 562 nxënës.

Në vitin shkollor 2004/05 në Republikën e Maqedonisë ka 512 shkolla tetëvjeçare, 496 katërvjeçare dhe 2 shkolla gjashtëvjeçare. Në të njejtin vit shkollor puna edukativo-arsimore është organizuar në 9920 paralele me nga 223.876 nxënës, kurse mësimin dhe punën tjetër edukativo-arsimore e realizojnë 13.970 arsimtarë, edukatorë dhe bashkëpunëtor profesional.

Numri mesatar i nxënësve prej klasës I deri të IV në vitin shkollor 2004/05 sillet rreth 25, 27 nxënës te një arsimtar shkollor, përderisa prej klasës së V – VIII nga 24,37 nxënës te një arsimtar.

### *III. VAZHDIMI I ARSIMIT TË DETYRUESHËM DHE ORGANIZIMI I BRENDSHM I TIJ*

#### • **Përvoja në Evropë**

Në disa shtete evropiane dhe shtete tjera të zhvilluara në arsimin e detyrueshëm fëmijët përfshihen në moshën pesë ose gjashtë vjeçare, përderisa në Irlandën veriore, Luksemburg, Norvegji, Holandë, Angli dhe në disa vende të tjera në moshën katër apo pesë vjeçare. Në Republikën e Maqedonisë, prej vitit 2005/2006, në shkollë fillore në vitin përgatitor regjistrohen të gjithë fëmijët të cilët deri në fund të vitit kalendarik do t'i mbushin gjashtë vjet. Gjegjësisht, arsimit fillor bashkë me vitin përgatitor zgjat nëntë vjet. Shiko shtojcën III. Megjithatë sipas Ligjit arsimi fillor i detyrueshëm përfshin: vitin përgatitor; katër vjet mësim klasor dhe katër vjet mësim lëndor.

Në shtetet e zhvilluara organizimi i brendshëm i arsimit të detyrueshëm është më ndryshe varësisht nga struktura e tërësishme e sistemeve shkollore, duke i përfshirë arsimin parashkollor, arsimin fillor, si dhe arsimin e ulët dhe të lartë të mesëm. Kështu psh., në Belgjik arsimi fillor për fëmijët që fillojnë në moshën 6 vje, zgjat 6 vite, kurse është e ndarë në tri periudha (secila nga ato zgjat dy vjet). Pas arsimit fillor vijon edhe një periudhë e arsimit të detyrueshëm që zgjat 3 vjet.

<sup>1</sup> Nga qershori i vitit 2007 financimi i arsimit fillor është në kompetenca të komunës.



Në Itali niveli i parë i arsimit të detyrueshëm është Schola elementare dhe përfshinë nxënës të moshës prej 6 deri 11, kurse organizohen në dy cikle: i pari zgjat dy, kurse i dyti tre vite. Niveli i dytë i arsimit të detyrueshëm (të mesëm të ulët -Schola media) zgjat tre vjet.

Në Portugal arsimit të detyrueshëm zgjat prej moshës 6 deri 15 vjeçare dhe është i ndarë në tre periudha: periudha e parë zgjat katër vjet, periudha e dytë dy vjet dhe e treta tre vjet.

Në Britanin e madhe (Angli dhe Uells) arsimit të detyrueshëm fillon në moshën pesëvjeçare. Niveli i parë i nxënësve zgjat prej moshës 5 deri 11 vjet dhe ndahet në dy periudha, kurse pastaj vijon niveli i dytë i cili përfshinë gjithashtu dy periudha.

- periudha e I: prej 5 deri në 7 vjet;
- periudha e II: prej 7 deri në 11vjet;
- periudha e III: prej 11 deri në 14;
- periudha e IV: prej 14 deri 16 vjet;

Periudhat kyçe I dhe II i përkasin fazës së parë, ndërsa periudha III dhe IV i përkasin fazës së dytë.

Në Suedi nga viti 1997 shkollat doemos sigurojnë vend për fëmijët e moshës gjashtë dhe shtatë vjeçare. Shkollimi i detyrueshëm zgjat 16 vite.

Për Suedinë është karakteristike arsimit fillor i cili në brendi është mjaft i zbërthyer. Gjegjësisht, shkolla fillore nëntëvjeçare është e ndarë në tre cikle, kurse çdonjëri prej tyre me nga tre vite.

Në disa vende arsimit fillor nuk është i organizuar në cikle, si psh. në Danimarkë, kurse shembull specifik është modeli i arsimit fillor në Gjermani, ku e vetmja shkollë fillore në disa krahina zgjat katër vjet, ndërsa në tjerat pesë ose gjashtë vjet. Pas arsimit fillor vijojnë edhe pesë apo gjashtë vjet nga arsimit të detyrueshëm në suaza të llojeve të ndryshme të shkollave të ulta të mesme: Hauptschule, Realschule, Gimnasium, Gesamtschule. Arsimit të mesëm i ulët është për nxënësit prej moshës 10 deri 16 vjeçare, ndërsa arsimit të mesëm i lartë prej 16 deri 19 vjeç.

Në Republikën e Sllovenisë arsimit fillor nëntëvjeçar është i ndarë në tre cikle edukativo-arsimore që zgjazin nga tre vite.

#### • Përvoja në Maqedoni

Sipas ligjit për arsim fillor në Republikën e Maqedonisë nga viti shkollor 2005/2006 në vitin përgatitor në shkollë fillore regjistrohen fëmijë të cilët deri në fund të vitit kalendarik i mbushin gjashtë vjet. Kështu moshë kronologjike e fëmijëve në vitin përgatitor sillet rreth 5 vjet e 8 muaj dhe 6 vjet e 7 muaj. Megjithatë, kjo dispozitë ligjore ende nuk zbatohet në mënyrë konsekuente, kështu që afër 3% e fëmijëve nuk janë të përfshirë në vitin përgatitor në grupet në shkolla fillore ose në kopshte. Për këtë arsye një numër i konsiderueshëm i nxënësve në klasën e I regjistrohen pas përgatitjes së domosdoshme në shkollë fillore. Kjo është karakteristike për nxënësit nga mjediset rurale si dhe nga familje me arsimim më të ulët dhe nga mjediset më të varfëra. Këto gjendje kanë ndikim të palakmueshëm në zhvillimin e fëmijëve që në klasën e I, posaçërisht për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme për vijimin e mësimin, dhe me këtë edhe për përparimin e rregullt në shkollë fillore.

Probleme ka edhe me kuadrin arsimor. Me Bazat e programit për punën edukativo-arsimore, i sjellur në vitin 2005 është vërtetuar që me fëmijët në vitin përgatitor të punëjnë edukatorë me arsim apo shkollë të lartë dhe me studime të kryera në Institutin pedagogjik.

Por, nga ana tjetër, është vënë obligim ligjor që edukatorët e grupit përgatitor të kenë të kryer studime për mësim klasor me çka krijohet mospërputhje në raport me arsimin inicial të edukatorëve dhe arsimtarëve të cilët punojnë me fëmijë të moshës gjashtë vjeçare. Njëherësh edhe arsimtarët klasor nuk janë të përgatitur në tërësi për punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës gjashtë vjeçare.

Ndaj kësaj analize duhet të shtohet edhe fakti se në vendin tonë është shumë e vogël përfshirja e nxënësve në moshën parashkollore ( rreth 11% fëmijë të moshës 6 vjeçe. Kjo ndikon negativisht për përgatitjen e nxënësve për vajtje në shkollë.

#### • Organizimi i mësimit dhe pushimet e nxënësve

Duke e pasur parasysh fillimin dhe kohëzgjatjen e vitit mësimor ekzistojnë dallime ndërmjet shteteve. Numri i përgjithshëm i ditëve të punës në shkolla në shtete të caktuara sillet prej 175 deri 200 ditë pune. P.sh. Në Slloveni 190 ditë, Greqi 175, Belgjik, 182, Francë 180, Angli dhe Uells minimum 190, Gjermani prej 188-208, Suedi 200. Republika e Maqedonisë gjatë vitit shkollor, sipas numrit të ditëve të punës në shkollë fillore rradhitet në mesin e shteteve me një numër më të vogël të ditëve të punës (Greqia, Spanja, Franca, Belgjika). (Shiko pjesën III, shtojca 2).

Ekzistojnë dallime sipas gjatësisë dhe orarit për nxënësit gjatë vitit shkollor dhe gjatë ditës mësimore. Por, përsëri mbisundojnë dy modele: „*mësim gjysmëditor*“ dhe „*mësim tërëditor*“. Sipas modelit të parë mësimi organizohet me numër të planifikuar të orëve paradite ose pas dite, ndërsa sipas modelit të dytë nxënësit janë në shkollë gjatë ditës punuese dhe kanë pushimin e drekës (psh., në Belgjikë, Spanjë, Francë, Angli) pushimi i drekës zgjat deri në 1 orë (për shembull, në Danimarkë, Irlandë, Angli), në disa shtete një orë e plotë (psh., Luksenburg, Francë, Spanjë).

Ekzistojnë dallime edhe sipas kohës kur fillon mësimi. Në shumë shtete është e pranueshme që nxënësit të shkojnë në shkollë rreth orës 8 e 15 minuta deri në orën 9. Në Gjermani fëmijët shkojnë në shkollë rreth orës 7 e 30 minuta ose në ora 8 në mëngjes, ndërsa në Portugali rreth orës 9 dhe 10.

Në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë organizimi i vitit shkollor rregullohet në pajtim me planin mësimor dhe me Ligjin e arsimit fillor.

Viti shkollor në shkollat fillore sipas rregullës, fillon më 1 shtator kurse përfundon më 31 gusht të vitit vijues. Prej 10 deri 20 qershor organizohet mësimi plotësues, kurse prej 15 – 31 gusht mbahen riprovimet dhe bëhen përgatitjet për vitin e ri mësimor. Mësimi realizohet në kohëzgjatjeje prej 180 ditë mësimore. Organizimi i vitit mësimor dhe pushimet e nxënësve rregullohen me kalendar për organizimin dhe punën e shkollave fillore që e sjell ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Në Republikën e Maqedonisë mësimi në shkolla fillore organizohet me ndërrime, kështu që një ose dy javë nxënësit shkojnë në shkollë para dite, ndërsa javët e ardhshme pasdite. Mësimin në vitin shkollor 2004/05 në dy ndërrime e ndjekin 85 237 nxënës ose 38,07% nga numri i përgjithshëm i nxënësve (paradite ose pas dite në shkollën e njejtë), ndërsa 13 6811 nxënës ose 61,11% në një ndërrim (gjegjësisht vetëm paradite). Edhe më tutje 1702 nxënës ende e ndjekin mësimin në tre ndërrime.

Mungesa e lokaleve të shkollës reflektohet negativisht në organizimin e mësimit. Për këtë arsye, në shkolla shpesh herë nuk përfillet përfshirja e nxënësve në mësimin plotësues dhe shtues, si dhe në aktivitetet e lira të nxënësve. Hapsira e pamjaftueshme ka ndikim si në kuptimin ashtu edhe në angazhimin e arsimtarëve për mësimin plotësues dhe shtues dhe për këtë arsye arsimtarët, posaçërisht në mësimin lëndor, si obligime të veta më shpesh i konsiderojnë vetëm orët e planifikuara për lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore sipas orarit shkollor. Sipas orarit nuk janë vërtetuar orët mësimore për mësimin plotësues dhe shtues gjatë javës punuese.

Nga të dhënat shihet qartë se një numër i madh i nxënësve nuk kanë kushte që gjatë ditës më gjatë të qëndrojnë në shkollë. Megjithatë, përveç kësaj në një numër të caktuar në shkolla fillore që punojnë vetëm në një ndërrim 442 klasat e katërta, 155 klasat e teta dhe 2 shkolla klasat e gjashta me nga 136 811 nxënës, ose për 61,11% nga numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollë fillore nuk organizohet qëndrimi i vazhdueshëm i nxënësve në shkollë fillore gjatë ditës mësimore. Në shtetet tjera gjendjet janë dukshëm më ndryshme. Nxënësit në shkollë qëndrojnë më tepër orë dhe kanë mundësi, përveç mësimit të detyrueshëm, që të angazhohen për kryerjen e detyrave

shtëpiake, të marrin pjesë në aktivitete fakultative ose ta përcjellin mësimin plotësues dhe shtues, të bashkëpunojnë në mes veti etj.

Në Republikën e Maqedonisë nxënësit në shumicën e shkollave pas mësimit të rregullt kanë detyra shtëpie. Në këtë mënyrë krijohet jo vetëm ngarkesë kohore por edhe psikofizike, meqë dita e nxënësit më së shpeshti vazhdon pas mësimit të rregullt në familje edhe atë më së paku 2 deri 3 orë për përvetsimin e përmbajtjeve, përpunimin e detyrave të shtëpisë dhe përgatitjen e mësimit për ditën vijuese. Angazhimi kohor i nxënësve në shkollë fillore në Republikën e Maqedonisë është paraqitur në pasqyrën vijuese:

<b>Klasa</b>	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>V</b>	<b>VI</b>	<b>VII</b>	<b>VIII</b>
<b>Në javë - orë për mësim të detyrueshëm</b>	18	18	19 (21)	20 (22)	23 (26)	25 (28)	28 (30)	28 (30)
<b>- orë për lëndë zgjedhore</b>	-	-	-	1	2- (4)	2- (4)	2- (4)	2- (4)
<b>Në përgjithësi:</b>	18	18	19 (21)	20 (22)	25 (28)	27 (29)	30 (32)	30 (32)
<b>-lëndë fakultative</b>	-	1	2	2	2	2	2	2
<b>-mësim plotësues</b>	1	1	1	1	2	2	2	2
<b>- mësim shtues</b>	-	-	-	2	2	2	2	2
<b>-aktivitete të lira të nxënësve</b>	1	1		2	2	2	2	2
<b>- orë kujdestarie</b>	-	-	-	-	1	1	1	1

*Burimi: Plani mësimor për shkollë fillore 2006.*

Numri i orëve në javë për mësimin e detyrueshëm dhe zgjedhor për nxënësit prej klasës së I deri të IV në Republikën e Maqedonisë është puthuajse i barabartë me një numër të madh të tjera. Gjithashtu, në mësimin lëndor nxënësit tanë janë më të ngarkuar. Nënkuptohe, se ngarkesa në mësim nuk mund të krahasohet në tërësi me atë në shtetet ku ajo është më ndryshe e organizuar për shkak se së paku numri më i madh i nxënësve në shkollë i përgatisin detyrat e shtëpisë, ndërsa kanë edhe mësim plotësues si dhe shtues që është shumë me rëndësi për zhvillimin e aftësive për të kuptuarit dhe zbatimin e njohurive.

Programi i detyrueshëm në shkollën tonë fillore përfshinë mësim sipas lëndëve të detyrueshme dhe nga lëndët zgjedhore për të cilat do të përcaktohen nxënësit në klasën e V ose VII. Nxënësi zgjedh më së paku një lëndë, ndërsa mund të përcaktohet edhe për dy lëndë zgjedhore. Një orë mësimore është caktuar për bashkësinë e klasës. Megjithatë, këtu bëjnë pjesë edhe aktivitetet e lira të nxënësve si dhe mësimi plotësues dhe shtues. Të gjitha këto aktivitete, sipas rregullës, duhet të zhvillohen paradite gjegjësisht pasdite (sipas orarit të ndërrimeve ku nxënësit e ndjekin mësimin). Mësimi fillon në ora 7 e 30 minuta ose në ora 8, ndërsa pas orës katër, pesë ose gjashtë për mësimin e rregullt me disa pushime të shkurtëra dhe një pushim më të gjatë, nxënësit e përmbyllin ditën në shkollë. Nxënësit e grupit klasor prej klasës së I deri të IV mund të

mbeten në mësim të vazhdueshëm, ndërsa në këtë periudhë është e domosdoshme që të hanë drekë dhe t'i bëjnë detyrat e shtëpisë, të relaksohen, të organizohen me aktivitete të lira të ndryshme etj. Megjithatë, në praktikën tonë vetëm në 28 shkolla është i organizuar qëndrimi i vazhdueshëm për nxënësit prej klasës së I-IV, ndërsa në mësimin tërëditor në 32 shkolla.

Ende nuk është vendosur organizim më funksional i mësimin me qëndrim të vazhdueshëm të nxënësve në grupin lëndor dhe klasor. Gjegjesisht, nuk është shfrytëzuar mundësia për nxënësit në orët e pasditës ose drejtpërdrejt pas mbarimit të mësimin të organizohen aktivitete të ndryshme sipas interesave dhe nevojave të tyre. (mësimi plotësues dhe shtues, kryerja e detyrave të shtëpisë, seksione të ndryshme, aktivitete rekreative etj). Nuk është praktikuar që rregullisht të zhvillohet mësim plotësues, sipas rregullës para apo pas kryerjes së orëve të mësimin të rregullt.

#### *IV. STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR*

##### **• Lidhshmëria e arsimit parashkollor me arsimin fillor**

Në vendet e zhvilluara qëllimet dhe përmbajtjet në arsim sistematizohen nga edukimi parashkollor në ciklet arsimore të ardhshme në arsimin elementar dhe të detyrueshëm. Në Republikën e Maqedonisë me vendosjen e obligimit të detyrueshëm që nxënësit të përfshihen në vitin përgatitor krijohen mundësi që të arrihet ngarkesë më e madhe e programeve mësimore veçanërisht në klasën e parë dhe të dytë, ndërsa në mënyrë analoge me atë ndryshimet do të reflektohen edhe me çngarkimin e programeve mësimore për mësimin lëndor (sipas përcaktimit më objektiv të qëllimeve mësimore, zgjidhja e përmbajtjeve dhe metodat e të mësuarit, sigurimi i mjeteve mësimore në cikle arsimore) siç praktikohet në vendet tjera. Megjithatë, me shqyrtimin e kushteve objektive përfshirja e fëmijëve në punën organizuese edukativo-arsimore në vitin përgatitor ende është në nivel të ulët. Nga kjo që u përmend, nuk është arritur lidhshmëri optimale (organizuese dhe përmbajtësore) edhe në punën edukative në vitin përgatitor me mësim klasor në shkollë filllore. E tërë kjo ka ndikim negativ në mësimin e nxënësve të klasës së I, meqë në këtë moshë ekzistojnë dallime të mëdha jo vetëm sa u përket paranojohurive, po edhe socializimit posaçërisht në mes fëmijëve të klasës së I të cilët nuk janë përfshirë në vitin përgatitor me ata që janë përfshirë në grupet përgatitore në shkolla dhe kopshte.

Përveç kësaj e nevojshme është të caktohet, siç u përmend më lartë, model bashkëkohorë për programimin e mësimin sipas klasave dhe në kuadër të cikleve të para dhe vijuese arsimore në përputhje me karakteristikat zhvillimore të nxënësve. Nëse merren parasysh kushtet reale, hapsinore dhe ekonomike në republikën e Maqedonisë mund të vlerësohet se në periudhën e ardhshme duhet të bëhen përpjekje të mëdha për përfshirjen e nxënësve në arsimin fillor nëntëvjeçar prej moshës 6-14/15.

Me zhvillimin e planit të ri dhe programeve të reja mësimore mund të përmirësohet përmbajtja dhe organizimi i arsimit të detyrueshëm në tërësi në përputhje me tendencat e përmendura në arsimin e shteteve të zhvilluara.

##### **• Karakteristikat e planit mësimor dhe programeve mësimore për arsimin fillor**

Duke u nisur nga rregullativa ligjore për arsimin fillor në vendin tonë zbatohet plan i përbashkët mësimor me programe për lëndët e detyrueshme, zgjedhore dhe fakultative. Kjo mënyrë e programimit është e përfaqësuar edhe në arsimin e vendeve të zhvilluara. (Shiko pjesën III, shtojca 3). Gjithashtu, prej vitit 1996 janë bërë ndryshime dhe plotësime në planin dhe programet mësimore, ndërsa veçanërisht janë të njohura përpjekjet për ngarkimin e programeve mësimore nga më voluminozet ose informative dhe përmbajtjet me rëndësi më të vogël që e rrisin ngarkesën psiko-fizike tek nxënësit.

Më konkretisht, njohuritë dhe notat për strukturimin e planit mësimor janë baratur në kapitujt vijues.

### • Lëndët e detyrueshme në klasat e ulta

Analiza e Planit mësimor për vitin shkollor 2006/2007 tregon se për mësimin e gjuhës amtare prej klasës së I-IV ka më pak orë në krahasim me mësimin në gjuhën amtare në vendet tjera. Për shembull, për mësimin e gjuhës amtare në katër klasat e para në shkollat fillore në Danimarkë nga numri i përgjithshëm i orëve ka 33,70%; në Finlandë 25,00%; Austri 30,42%; Gjermani – Baden Vürttemberg 24,07; Slloveni 28,73; Kroaci 27,77 etj; ndërsa në Republikën e Maqedonisë 25,67%.

Në Austri në katër klasët e para mësimi në gjuhën e huaj zbatohet (pa u planifikuar fondi javor i orëve që në klasë të I dhe II). Mësimi në gjuhë të huaj prej klasës së I-IV ka 2,17% nga numri i përgjithshëm i orëve për programet e detyrueshme. Në Gjermani, Baden-Vürttemberg për mësimin e gjuhës së huaj prej klasës së I-IV ka 7,40% nga numri i përgjithshëm i orëve, në Slloveni gjuha e huaj mësohet prej klasës së IV me nga 2 orë në javë, në Kroaci gjuha e huaj mësohet prej klasës së I-IV me nga 2 orë në javë; ose me 11,11% nga numri i përgjithshëm i orëve për programet e detyrueshme. Në Republikën e Maqedonisë nxënësit fillojnë në mënyrë të vazhdueshme ta mësojnë gjuhën e huaj të parë prej klasës së IV në shkollat ku janë krijuar kushte.

Mësimi i lëndës së matematikës në Danimarkë në katër klasat e para në shkollë fillore ka nga 17,97% nga numri i përgjithshëm i orëve; Finlanda 17,18%; Austria 21,73%; Gjermania – Boden Vürttemberg 17,59%; në Slloveni 20,68%, Kroaci 22,22 ndërsa në Maqedoni 25,67%.

Mësimi në teknologji/natyrë dhe punë dore në katër klasët e para në shkollën fillore në Danimarkë është i përfaqësuar me 9,18% nga numri i përgjithshëm i orëve; në Austri për lëndën e punë dore 6,52%; Sllovenia për lëndën natyrë dhe teknikë 3,44%. Këto përmbajtje në shkolla fillore prej klasës së I-IV në vendin tonë janë shndërruar në mësimin natyrë dhe shoqëri.

Në Austri për arsimin për siguri të rrugëve prej klasës së I-IV në orët e detyrueshme janë planifikuar dhjetë orë në vit.

Më konkretisht për përmbajtjet në lëndën e natyrës, shoqërisë dhe njeriut edhe përveç titujve të ndryshëm të lëndëve ka ndarë fond solid të orëve, si p.sh. në Gjermani në lëndën për atdheun dhe botën 11,11% nga numri i përgjithshëm i orëve, në Slloveni për lëndën për njohjen e mjedisit, natyrës dhe teknikës 13,78%, në Kroaci për lëndën natyrë dhe shoqëri 11,53%, në shkollat tona për lëndën natyrë dhe shoqëri 13,51%.

Mësimi në lëndën e edukimit muzikor në shkollat në Danimarkë është përfaqësuar me 7,86%, në Finlandë 4,68%, në Austri 2,17%, në Slloveni 9,18%, në Kroaci 5,5% dhe në Maqedoni 8,81%.

Për mësimin në arsim fizik dhe shëndetësorë në shkollat e Danimarkës janë ndarë 8,98% nga numri i përgjithshëm i orëve, në Finlandë 9,37%, Austri 10,86%, Gjermani 11,11%; Slloveni 13,79%; Kroaci 15,27% dhe në Maqedoni 16,21%.

### • Lëndët e detyrueshme në klasat e larta

Nga analiza e planeve mësimore e shkollave prej klasës së V deri të VIII gjegjësisht IX (në kuadër të shkollës fillore, gjegjësisht të shkollave të mesmet të ulta ashtu siç është caktuar në vendet adekuate shihet se për mësimin e gjuhës amtare dhe letërsisë parashihen më shumë orë mësimore, si psh., në Danimarkë 20, 54 % nga numri i përgjithshëm i orëve për lëndët e detyrueshme; në Austri në klasat e ulta të arsimit të mesëm hauptshule dhe gimnazium 13,38%, në Gjermani në klasat e ulta të arsimit të mesëm prej klasës së V – IX, në Baden Vürttemberg 12,56%; në Slloveni 14,13%, Kroaci 18,55% dhe në Maqedoni prej klasës së V deri të VII 15,38%.

Për mësimin e gjuhës së huaj në shkollat e Danimarkës prej klasës së V deri të IX janë ndarë 10,27% nga numri i përgjithshëm për programet e detyrueshme, në Austri në klasat e ulta të shkollës së mesme prej klasës së I deri të IV 11,02%; në Gjermani prej klasës së V deri të X; në klasë arsimin e mesëm në Baden Vürttemberg 12,56%; Slloveni 12,01%; Kroaci 12,37% dhe në Maqedoni 11,53 %.

Gjuha e dytë e huaj ose gjuha latine në Austri në gjimnazin e nivelit të ulët të arsimit të detyrueshëm është përfshirë me 7,08% nga fondi i përgjithshëm i orëve; në Gjermani në shkollat e Baden Virterbergut prej klasës së V deri të X për gjuhën e dytë të huaj janë ndarë 10,98% të orëve në përgjithsi për programin e detyrueshëm; Në Kroaci gjuha e dytë e huaj mësohet në lëndët zgjedhore me nga dy orë në javë prej klasës së IV deri të VIII edhe në Maqedoni për gjuhën e dytë të huaj janë ndarë 5,76% nga orët për programet e detyrueshme.

Mësimi në lëndën e matematikës në shkollat e Danimarkës prej klasës së V deri të IX përfshihet me 13,69% nga orët e përgjithshme për programet e detyrueshme, në Austri në gjimnaz në nivelin e ulët 11,02%, ndërsa në hauptshule 9,44%; në Gjermani në Baden Virtemberg prej klasës së V deri të IX - 13,13%, në Slloveni prej klasës së V deri të IX - 14,13%, në Kroaci prej klasës së V deri të VIII 17,22% dhe në Maqedoni prej klasës së V deri të VIII 15,76%.

Për shkencat natyrore në shkollat në Danimarkë prej klasës së V deri të IX për lëndën natyrë dhe teknologji ndahen 3,42% dhe për biologji 2,78% nga numri i përgjithshëm i orëve për programin e detyrueshëm dhe për fizikë dhe kimi 4,10%.

Në Austri në shkollën e mesme të ulët prej klasës së I deri të IV për biologji, arsim për mjedisin 6,29% dhe për fizikë dhe kimi 6,29% nga orët e përgjithshme të programit të detyrueshëm, përderisa në gjimnaz – nivel më të ulët për biologji, arsim për mjedisin 6,29%, për kimi 1,57% dhe për fizikë 4,72% në Gjermani në shkollat në Baden Virtemberg prej klasës së V deri të IX në lëndën e dukurive natyrore 1,09%, në fizikë 4,91%, kimi 3,82% dhe biologji 5,46% dhe për kurs praktik nga shkencat natyrore 1,63% nga orët e përgjithshme për programet e detyrueshme, në Slloveni për lëndën natyrë dhe teknikë 2,12%, natyrë 3,50; biologji 2,47%, kimi 2,82% dhe fizikë 2,82%, në Kroaci për lëndën e natyrës 4,86%; biologji 4,12% dhe fizikë 4,12% dhe në maqedoni për Biologji 6,84%, fizikë 3,88% dhe kimi 3,88%. Mirëpo, përveç këtyre orëve në shkollat e Republikës së Maqedonisë realizohet edhe programi fakultativ në ekologji prej klasës së V deri të VIII me nga një orë në javë me çka rritet më tepër fondi i orëve me këtë lëndë mësimore, si dhe lënda zgjedhore Bazat e shkencave natyrore me nga 2 orë në javë prej klasës së V deri të VIII.

Për mësimin në lëndët shoqërore histori, gjeografi, arsim qytetar në shkollat në Danimarkë prej klasës së V deri të IX për lëndën shkencat natyrore janë ndarë 3,42%, për histori 4,72%, gjeografi dhe ekonomi 6,73% nga numri i përgjithshëm për programin e detyrueshëm, në Austri për lëndën e historisë, shkencat shoqërore 4,72%, gjeografi dhe ekonomi 6,29%, në Gjermani në shkollat në Baden Virtemberg për lëndën e gjeografisë, 3,82%, për histori 4,91% dhe për shkencat shoqërore 2,18%; në Slloveni për lëndën e shoqërisë 2,12%, gjeografisë 4,59%, historisë 4,94% dhe për arsimin qytetar dhe etikë 1,4%; në Kroaci për lëndën e historisë 7,69%, gjeografisë 6,73% dhe kulturë qytetare 1,92%.

Për mësimin në muzikë dhe art në shkollat në Danimarkë prej klasës së V deri të IX janë ndarë: për muzikë 1,36% dhe për art figurativ 0,68%, në Austri në hauptshule dhe gimnazium (shkolla të mesme të ulta) për muzikë 5,55% për shkrim dhe vizatim 6,29%, në gimnazium në nivel më të ulët për muzikë 4,72 dhe për art 6,29%; në Gjermani – Baden Virtemberg në shkolla të mesme të ulta prej klasës së V deri të X (gjimnazi, drejtimi shkencat natyrore) për lëndën e muzikës 4,91% dhe për lëndët arte të bukura 3,27%; në Slloveni për lëndën e artit figurativ 4,24% dhe për arsimin muzikor 3,88%, në Kroaci për kulturë artistike 4,12% dhe kulturën muzikore 4,125 dhe në maqedoni për arsimin figurativ 4,805 dhe për arsimin muzikor 4,80% nga orët e përgjithshme për lëndët e detyrueshme.

Në shkollat e Danimarkës prej klasës së V deri të IX për natyrë dhe teknologji ndahen 3,42% dhe për punë dore me dru/metal 7,53% nga orët e përgjithshme për programin e detyrueshëm, në Austri në hauptshule dhe gimnazium (mesme e ulët) për lëndën bazat e punës teknike janë ndarë 5,90% ose punë me tekstil 5,90% (si lëndë të detyrueshme alternative) ndërsa në nivelin më të ulët në gimnazium nga shkolla e

mesme akademika për lëndën punë dore 3,14% nga orët e programit të detyrueshëm. Në Gjermani Baden Vürttemberg në shkollat e mesme (profili gjimnazor shkenca natyrore) për lëndën e muzikës 4,91% dhe për lëndën artet e bukura 3,27 %; në Slloveni për lëndën arsimit figurativ 4,24% dhe për arsimin muzikor 3,88%, në Kroaci për kulturën figurative 4,12% dhe për kulturën muzikore 4,12% dhe në Maqedoni për arsimin figurativ 4,80% nga orët e përgjithshme për lëndët e detyrueshme.

Në shkollat në Danimarkë prej klasës së V deri të IX nga orët e përgjithshme për lëndët e detyrueshme për mësimin në sport janë ndarë 7,53%. Për arsimin fizik në shkollat prej klasës së I deri të VI në Finlandë janë ndarë 9,37% dhe prej klasës së VII deri të IX 8,57% nga orët ndërsa disa përmbajtje janë për arsimin shëndetësor, në Austri në shkollën e ulët të mesme 11,81%, në Gjermani – Baden Vürttemberg në shkollën e mesme të ulët (gimnaz, profili shkenca natyrore) 8,74%; në Slloveni për lëndën e sportit prej klasës së V deri të IX 8,48%, në Kroaci për kulturë fizike dhe shëndetësore prej klasës së V deri të IX 8,24% dhe në maqedoni prej klasës së V deri të VIII për kulturë fizike dhe arsim shëndetësor 7,69% nga orët e përgjithshme për lëndët e detyrueshme.

Në shkollat fillore dhe ato të mesme të ulta në shtetet e zhvilluara në Evropë mësojnë lëndë për mësimin krishter ose religjioz. Psh., në Danimarkë lënda studime për krishterizmin/ mësimi krishter është i përfshirë në shkolla fillore prej klasës së I deri të IV, si dhe prej klasës së V deri të VI dhe në klasën e VIII dhe IX. Për këtë lëndë nga fondi javor i përgjithshëm prej klasës së I deri të IV janë ndarë 5,61% dhe prej klasës së V deri të IX 3,42%. Nxënësi mund të lirohet nga kjo lëndë përderisa prindëri /kujdestari nënshkruan deklaratë me çka për shkaqe personale nuk lejon që fëmija ta ndjek këtë mësim.

Lënda etika/religjioni mësohen edhe në shkollat në Finlandë prej klasës së I deri të IV për këtë lëndë janë ndarë 6,25% dhe prej klasës së VII deri të IX 4,28% nga numri i përgjithgjithshëm minimal i orëve për lëndët e detyrueshme.

Në shkollat në Austri për lëndën e arsimit religjioz prej klasës së I deri të IV janë ndarë 8,69% edhe në shkollat e mesme të ulta (prej klasës së I deri të IV) 6,29% nga orët e përgjithshme në javë për lëndët e detyrueshme. Kjo lëndë me titull të njejtë – arsimi religjioz është i përfshirë edhe në shkollat në Gjermani. Në regjionin e Baden Vürttembergut në shkollat prej klasës së I deri të IV për arsimin religjioz janë ndarë 7,40%, ndërsa në shkollën e ulët të mesme prej V deri X për lëndën religjioni/etika 6,01% nga orët e përgjithshme për lëndët e detyrueshme.

Në Slloveni lënda *religjioni* dhe *etika* mësohen me nga 1 orë në javë në klasën e VII, VIII dhe IX. Kjo lëndë i takon grupit të lëndëve zgjedhore humanitaro-sociologjike. Me ligj është caktuar se shkolla ua ofron këto lëndë nxënësve, ndërsa lënda zgjedhore religjioni dhe etika mësohet në qoftë se ka interesim të mjaftueshëm të nxënësve.

Komisioni i veçantë lëndor ka bërë analizë dhe vlerësim se sinqeriteti dhe lidhshmëria e madhe e botës, si dhe qarkullimi i lirë i njerëzve si dhe ideve mundëson jo vetëm njohje më të mirë të kulturave të tjera, religjioneve dhe traditave fetare, por edhe respekt të ndërsjellë ndërmjet njerëzve me pikëpamje të ndryshme fetare ose ateistike. Për këtë arsye komisioni ka shqiptuar se me rëndësi të veçantë është njohja e krishterizmit i cili në nivele të ndryshme e ka formuar civilizimin në shtete perendimore bashkë me humanizmin, arsimimin dhe pikëpamjet tjera shpirtërore që janë ruajtur ose kanë depërtuar në ballafaqimin kritik me botën dhe realitetin.

Në Kroaci, gjithashtu lënda e mësimin fetar është përfshirë në lëndët zgjedhore prej klasës së I deri të IV dhe prej klasës së V deri të VIII me nga 2 orë në javë.

- **Lëndë zgjedhore**

Sa u përket lëndëve zgjedhore analiza krahasuese tregon se në shkollat në Danimarkë lëndët zgjedhore janë të përfshira në klasën e VIII dhe IX me nga 2 orë në javë ose me 2,73% nga orët për lëndët e detyrueshme.

Në Finlandë për lëndët zgjedhore janë caktuar 3,03% nga numri minimal i përgjithshëm i orëve prej klasës së I deri të VI, ndërsa zgjedhja rritet për maksimum 20 orë ose pothuaj për 28 % në raport me numrin minimal të orëve në klasën e VII dhe VIII.

Në Gjermani në rajonin e Baden Vürttembergut në shkollat me arsim të ulët të mesëm, nxënësit të cilët nuk e kanë ndjekur arsimin religjioz e mësojnë lëndën e etikës duke filluar prej klasës së VII.

Në Slloveni e përbashkët për të gjitha lëndët zgjedhore është ajo që për ato vendosin nxënësit në klasën e VII, VIII dhe IX. Përveç gjuhëve të huaja lëndët tjera sipas rregullës janë njëvjeçare. Në orarë për ata ka nga një orë, përderisa për mësimin e gjuhëve të huaja që do t'i zgjedh nxënësi me nga 2 orë në javë. Lëndën të cilën do ta zgjedh nxënësi është pjesë e detyrueshme nga orari i tij për mësimin në shkollë. Për lëndën zgjedhore nxënësi vlerësohet edhe në lëndët e detyrueshme

Gjithashtu, në Slloveni shkolla u ofron nxënësve lëndë zgjedhore të cilat janë në përputhje me mundësitë dhe interesat e nxënësve.

Secila shkollë duhet t'ju ofroj religjion dhe etikë nxënësve, gjuhë të dytë të huaj dhe retorikë. Çdoherë duhet të sigurohet mundësia që nxënësi të mund të zgjedh dy lëndë humanitaro-sociologjiko dhe një lëndë natyroro-shkencore dhe teknike, ose dy lëndë natyroro-shkencoro-teknike dhe një lëndë humanitaro-sociologjike.

Sipas kësaj, nxënësi nuk guxon të zgjedh tri lëndë nga grupi i njejtë. Në listën e lëndëve bëjnë pjesë: vallet popullore, astronomia, biologjia, njeriu dhe Toka, elektronika me punën e saj, gjurmimet etike, etnologjia, filozofia për fëmijë, veprat muzikore, klubi teatral, mësimi informatik, gjuha italiane, sporti zgjedhor, unë dhe të tjerët, ç'ka flasin veprat artistike, mendimi kritik, gjuha latine, forma dhe stili, edukim i mjedisit, organizmat në natyrë dhe mjedisi artificial, valle dhe vallëzim, projektet nga fizika dhe teknika, rrjetë kompjuteristike, radio, bimët dhe njeriu, gjurmim për mjedisi shtëpiak dhe mbrojtja e rrethit të tij, gjurmimi i qenieve të gjalla, retorika, përgatitjet bashkëkohore të ushqimit, përballimi i kulturave, modernizimet dhe trashëgimitë, gazetari shkollorë, sport për relaksim, sport për shëndetsi, televizori, shtypi, rregullimi i teksteve, jeta dhe historia e artit.

Siç u përmend më lartë, në Kroaci në lëndët zgjedhore përveç mësim-besimit bëjnë pjesë gjuhët e huaja që mësohen me nga 2 orë në javë prej klasës së IV deri të VIII. Edhe për lëndët tjera zgjedhore janë paraparë nga 2 orë në javë prej klasës së V deri të VIII. Në Kroaci ka programe të posaçme në gjuhën latine me nga 3 orë prej klasës së V deri të VIII dhe për gjuhën greke me nga 3 orë në javë në klasën e VII dhe VIII.

Në Republikën e Maqedonisë me Planin mësimor prej klasës së I deri të IV në lëndët zgjedhore bën pjesë gjuha e parë e huaj të cilën nxënësit fillojnë ta mësojnë në mënyrë të vazhdueshme prej klasës së IV në shkolla ku janë krijuar kushte.

Prej klasës së VI deri të VIII në vitet shkollor 2006/2007 janë përfshirë lëndët zgjedhore: gjuha shqipe, arsimit teknik, bazat e teknikës dhe të informatikës. Në klasën e V dhe VII nxënësit zgjedhin më së paku një lëndë, ndërsa mund të përcaktohen edhe për dy lëndë zgjedhore.

#### • **Lëndë fakultative**

Duke i pasur parasysh specifikat e shoqërisë maqedonase dhe traditat në arsimimin e nxënësve në klasët e ulta ju mundësohet që të mësojnë gjuhë vlllehe, rome, boshnjake, ekologji ndërsa në klasët më të larta përveç këtyre lëndëve janë të përfshira edhe tjera siç janë: arsimit figurativ, arsimit muzikor, sporti, edukimi në komunikacion etj.

#### • **Orë për bashkësinë e klasës**

Sipas planeve mësimore është paraparë orë e posaçme edhe për bashkësinë e klasës. Si p.sh. në shkollat në Danimarkë është paraparë nga një orë në javë prej klasës së I deri të X, në Finlandë prej klasës së VII deri të IX janë paraparë nga 2 orë në javë për këshillim me nxënësit, në klasën e I dhe të II në Greqi ka nga 1 orë në javë për jetën shkollorë, në Slloveni për orën me bashkësinë e klasës është planifikuar nga gjysëm orë



në javë prej klasës së IV deri të IX, në Kroaci nga 1 orë në javë prej klasës së I deri të VIII dhe në Republikën e Maqedonisë me nga një orë në javë prej klasës së V deri të VIII.

- **Mësimi plotësues dhe shtues**

Sipas planit mësimor për arsimin e mesëm të ulët të detyrueshëm në Gjermani në rajonin e Baden Vürttembergut prej klasës së I deri të IV është planifikuar nga 2 orë në javë në klasën e I dhe të II dhe nga 3 orë në javë në klasën e III dhe IV për përkrahjen e nxënësve nga ana e arsimtarit (për punë individuale ose punë në grupe). Gjithashtu, edhe prej klasës së V deri të X janë paraparë 12 periudha të ashtuquajtura për kompenzim. Gjatë përcaktimit të periudhave për punë të grupeve nuk duhet të kalojnë më tepër se tre javë për numrin e caktuar të periudhave.

Plani mësimor është zgjeruar sipas orëve, për ndihmën e organizuar individuale dhe ndihmën e përbashkët të nxënësve me pengesa në mësim për gjysëm ore në javë prej klasës së I deri të IX dhe me nga 1 orë në javë prej klasës së I deri të IX për mësimin plotësues dhe shtues. Për aktivitetet shoqërore janë ndarë me nga dy orë në javë prej klasës së II deri të IX.

Në shkollat në Kroaci mësimi plotësues dhe shtues është i përfshirë me 1+1 orë në javë prej klasës së I deri të VIII, ndërsa për aktivitetet jashtëmësimore është caktuar nga një orë në javë prej klasës së I deri të VIII.

Në shkollat e Republikës së Maqedonisë është planifikuar mësim plotësues me nga 1+1 orë në javë prej klasës së I deri të IV klasë dhe me nga 2 orë në javë prej klasës së V deri të VIII. Për mësimin shtues janë paraparë nga dy orë në javë prej klasës së IV deri të VII. Për aktivitetet e lira të nxënësve është caktuar nga 1 orë në javë prej klasës së I deri të III dhe me nga 2 orë në javë prej klasës së IV deri të VIII. Planifikohet edhe kohë për korrin e shkollës dhe orkestër prej klasës së V deri të VIII prej 72 orëve deri 144, gjegjësisht 180 orë në vit.

#### *V. ARSIMIMI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË POSAÇME ARSIMORE*

Në shtetet e zhvilluara nocioni nevoja të posaçme arsimore ka të bëjë me fëmijët me pengesa në zhvillimin psikik, me dëmtim në të pamurit dhe të dëgjuarit, si dhe fëmijë me pengesa në të folur. Ky nocion përfshin fëmijë me pengesa në livizje, fëmijë të sëmurë vazhdimisht, si dhe fëmijë me pengesa në sjellje dhe karakter të cilët kanë nevojë për ndihmë plotësuese profesionale ose për përshtatje, gjegjësisht programe të posaçme për edukim dhe arsimim. Madje, ky nocion ka të bëjë edhe për nxënësit me vështirësi në mësim. Kështu që, shkollat fillore janë të detyruara të përpunojnë programe për fëmijët me nevoja të posaçme, të sigurojnë punëtorë profesional për përgatitjen dhe zbatimin e mësimin si dhe vijimin dhe vlerësimin për të arriturat e nxënësve.

Psh. fëmijët me nevoja të posaçme arsimore në Slloveni përfshihen në klasa të rëndomta vetëm në ato shkolla ku ka arsimtarë adekuat dhe kushte adekuate, si dhe të sigurojnë profesionistë për punën plotësuese me këta fëmijë (defektologë etj).

Gjithashtu, askush nuk i detyronë shkollat për pranimin e këtyre fëmijëve me nevoja të posaçme, ndërsa veçanërisht përderisa nuk kanë përgatitje adekuate dhe kuadër profesional.

Gjithashtu në Slloveni punojnë edhe ente të ndryshme për fëmijët me nevoja të posaçme, si dhe shkolla me programe të përshtatshme, pasi që vetëm fëmijët sipas llojit dhe pengesës së caktuar në zhvillim munden me sukses të përfshihen në mjedisin e rëndomtë shkollor dhe të përparojnë në atë. Komisionet profesionale përkatëse në prani të prindërve të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore bëjnë vlerësime për çdo nxënës se ku është më mirë të udhëzohet dhe për atë propozojnë programe përkatëse. Komisionet propozojnë sipas mundësive përgatitje të përshtatshme dhe plotësuese dhe kuadër të nevojshëm profesional. Në klasën ku do të jetë i përfshirë fëmija me nevoja të

posaçme arsimore ka më pak nxënës nga numri i rëndomtë, ndërsa në klasë të njejtë mund të përfshihen më së shumti tre nxënës me nevoja të posaçme.

Fëmijët me nevoja të posaçme e mbarojnë arsimin fillor nëntëvjeçar me programin i cili mund të parasheh që të mos ketë kontrollim përfundimtar të njohurive. Atëherë vetëm me nota pozitive prej klasës së IX nxënësi do të merr dokument shkollor se i ka plotësuar obligimet për arsimin e detyrueshëm me notë me shkrim për të arriturat.

Fëmijët me nevoja të posaçme mund të arsimohen edhe në kushte shtëpiake. Në Republikën e Maqedonisë është i pranueshëm parimi i fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore në mjedisin e rëndomtë shkollor që është më afër shtëpisë së tyre. Kështuqë, kur janë në pyetje pengesa të vogla në zhvillimin psikik ato fëmijë përfshihen në klasët e rregullta në shkolla fillore, ndërsa në rastet kur është fjala për pengesa të rënda në zhvillimin e fëmijëve atëherë përfshihen në shkolla të posaçme ose në klasa të posaçme në arsimin fillor në shkollat fillore të rregullta.

Përveç organeve dhe shërbimeve për arsimin e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore kujdes të posaçëm mbajnë edhe qendrat për punë sociale.

Për arsimin fillor për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore janë përpunuar plane dhe programe të posaçme me çka u mundësohet për socializim, përvetësimin e njohurive, shprehi dhe vlera të tjera. Me programet dhe metodat në mësim rëndësi më të madhe i jepet aftësimin të nxënësve për punën dhe jetën.

Shkollat fillore për nxënësit me nevoja të posaçme organizohen sipas parimeve të njejtë si dhe shkollat fillore të rregullta. Aty nevojitet që t'i kushtohet vëmendje më e madhe aftësive profesionale dhe pedagogjike të arsimtarëve dhe edukatorëve dhe zhvillimit të shërbimeve për punën këshilldhënëse dhe profesionale me nxënësit dhe prindërit.

Prej vitit 1998 në Republikën e Maqedonisë realizohet projekt për inkluzionin e fëmijëve me nevoja të posaçme në shkollat e rregullta.

Me këtë projekt së pari kanë qenë të përfshirë pesë shkolla fillore, ndërsa më vonë janë përfshirë 13 kopshte. Qëllimi ka qenë që të krijohen kushte më të mira (paragjykime) për përfshirjen në shkollat fillore të rregullta dhe grupet në kopshte të fëmijëve me vështirësi në zhvillimin psikofizik, me pengesa emocionale. Ky projekt ndihmon që të ndryshohen kuptimet dhe qëndrimet e prindërve për përfshirjen e fëmijëve të tyre në grupet arsimore të rregullta dhe më gjerë të nxitet interes më i madh në opinion. Projekti është zgjeruar në 72 shkolla fillore.

## *VI. NXËNËSIT E TALENTUAR*

Në vendet e zhvilluara me vëmendje të posaçme shqyrtohen çështjet për zbulimin e nxënësve të talentuar dhe krijimi i kushteve për zhvillim më të shpejtë. P.sh. në arsimin e ri fillor nëntëvjeçar në Slloveni nxënësit e talentuar zbulohen që t'ju ofrohen mundësi për zhvillim më të mirë dhe më adekuat të aftësive të tyre. Grup i posaçëm i profesionalistëve punon për zhvillimin e modelit i cili do të mundëson vijimin dhe zbulimin e nxënësve të talentuar që në moshën më të re shkollore në shkollë fillore si dhe në klasët më të larta.

Modeli i ri për zbulimin e nxënësve të talentuar përfshihen tre hapa. I pari ka të bëjë me zbulimin e grupeve më të mëdha të nxënësve për të cilët mendohet se janë të talentuar. Gjatë kësaj me rëndësi janë disa matje: suksesi në mësim; të arriturat e nxënësve në lëmi të ndryshme të artit, teknikës, sportit etj; mendimi i arsimtarit, gjatë së cilës rëndësi të posaçme u kushtohet fëmijëve të klasave më të ulta sociale dhe fëmijëve nga mjediset e kulturave të ndryshme. Si kritere merren edhe rezultatet si dhe të arriturat e nxënësit në garat regjionale dhe shtetërore, mendimi i shërbimeve të shkollës për punën këshilldhënëse dhe të dhënat nga evidanca personale e nxënësit duke filluar nga kopshti gjatë tërë procesit të arsimimit. Në grupin më të gjerë, gjegjësisht mund të

bën pjesë secili fëmijë që do t'a plotëson së paku një kusht nga të gjithë kriteret e numëruara.

Me hapin e dytë fillon zbulimi konkret i nxënësve të talentuar në grupin më të gjerë. Gjatë kësaj duhet të përcaktohet notë për specifikën e talentit të nxënësve në shkallë të veçantë. Me testet e aftësive zbulohen ata nxënës me sasi të intelegjencës prej 120 ose më tepër. Testet ndihmojnë për zbulimin e 10% deri 20% të nxënësve të talentuar. Këtu bëjnë pjesë edhe nxënësit që janë të talentuar në lëmi të ndryshme në art, teknikë, sport etj.

Hapi i tretë është informimi i prindërve me faktin se fëmija i tyre është i talentuar dhe me atë do të ketë nevojë për punë më themelore. Profesionistët që janë kompetent në këtë sferë mendojnë se me nxënësit e talentuar mund të punohet më mirë në shkollë gjatë tërë periudhës në arsimin nëntëvjeçar.

Në shkollë fillore në Republikën e Maqedonisë puna me nxënësit e talentuar nuk është e definuar në veçanti. Në praktikë zbatohet koncepti për zhvillimin e mësimi shtues, si dhe për zhvillimin e programeve më të zgjeruara dhe më të thelluara dhe aktivitete në seksionin e shkollës për fëmijët e talentuar. Regullisht organizohen gara rajonale dhe republikane në lëndë dhe fusha të ndryshme që janë të përkrahura nga shoqata përkatëse dhe asociacione në nivel rajonal, komunal dhe republikan. Me Ligjin për arsimin fillor është mundësuar përparim më i shpejtë i nxënësve gjatë shkollimit në shkollë fillore. Gjithashtu, nuk janë vendosur kriteret dhe procedura për zbulimin e hershëm të nxënësve të talentuar, si dhe për krijimin e mundësive për zhvillimin e aftësive të tyre.

## *VII. PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I MËSIMIT*

### **• Lëndët mësimore sipas klasave dhe cikleve arsimore**

Analiza komparative e sistemeve shkollore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët arsim i detyrueshëm në vendet e zhvilluara jep mjaft argumente nga të cilët duket se ekziston organizim i ndryshëm i shkollave. Në të gjitha vendet përfillen tendecat që të krijohen shkolla më të mira që nxënësve t'ju ofrohet, mundësi për zgjidhje të lëndëve të caktuara në pajtim me interesat dhe të arriturat e tyre. Shkolla duhet që nxënësit t'i aftësojë në mënyrë të sigurtë dhe aktive që ta plotësojnë kohën e mbetur pas mësimi në forma të ndryshme për mbrojtje, relaksim, aktivitete sportive dhe kulturore. Kjo nevojë rrjedh, mes tjerash edhe me angazhimin e madh të prindërve për detyrat punuese në ekonomi dhe në veprimtari tjera.

Gjatë kësaj theksohet se nxënësi është personalitet i pavarur dhe se ngarkesa duhet të jetë në përputhje me interesat dhe specifikat e tyre në periudha të caktuara zhvillimore. Shkolla nuk ka të drejtë t'i lë pas dore nevojat e familjes së fëmijës (gjegjësisht organizimi dhe kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijëve në shkollë u përshtatet nevojave të familjes).

Analiza krahasuese e planeve mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vendet e zhvilluara (që realizohen në periudha të caktuara edukativo-arsimore) tregon se atje janë caktuar lëndë mësimore në shkollë që i mësojnë nxënësit sipas klasave, si dhe numri i orëve në javë dhe në vit për çdonjërin prej tyre. Planifikohen edhe orë për aktivitete tjera të nxënësve në shkollë gjatë javës dhe vitit shkollor.

Sipas planeve mësimore, është caktuar kornizë themelore edhe për programet e zgjeruara, se sa orë kanë të bëjnë me mësimin plotësues dhe shtues por dhe për aktivitetet tjera të nxënësve jashtë mësimi si dhe për ndihmën që u nevojiten nxënësve me nevoja të posaçme.

Plani mësimor, si dokument më të rëndësishëm e pranon dhe e mundëson trupin profesional në nivel më të lartë ose organ më të lartë në shtet ku është kompetent për arsimin.

Kështu që, në analizë mund të vërehet se nxënësit në klasën e I në shkollat fillore në vendet e zhvilluara, kryesisht i mësojnë lëndët: gjuhë amtare, matematikë, art figurativ, art muzikor, natyrë dhe shoqëri (njohja e mjedisit) dhe edukatë fizike.

Përveç mësimin të rregullt, me planin mësimor janë planifikuar aktivitete që kanë të bëjnë me kulturën, teknikën, informatikën dhe sportin.

Në klasën e II mësohen lëndët: gjuhë amtare, matematikë, edukatë figurative, edukatë muzikore, natyrë dhe shoqëri (njohja e mjedisit) dhe edukata fizike.

Në moshën 7- vjeçare nxënësit në disa vende mësojnë gjuhë tjetër nacionale ose të huaj me nga 32 orë në vjet. Gjithashtu, nxënësit kanë planifikuar edhe aktivitete tjera për kulturë, mbrojtjen e natyrës/mjedisit, informatikën/ teknikën dhe sportin.

Në klasën e III mësohen lëndët: gjuhë amtare, matematikë, art figurativ, edukatë muzikore, natyrë dhe shoqëri, njohja e mjedisit dhe edukata fizike. Nxënësit vazhdojnë ta mësojnë edhe gjuhën e huaj, gjegjësisht gjuhën tjetër nacionale. Për këto lëndë planifikohen edhe orët javore. Planifikohen edhe aktivitete tjera për kulturën, teknikën, natyrën mjedisin dhe sportin.

Në klasën e IV është bërë analiza dhe rritja e parë e numrit të lëndëve, gjegjësisht mësohet: gjuhë amtare, matematikë, gjuhë e huaj, gjuhë e dytë nacionale, edukatë figurative, edukatë muzikore, shoqëri, natyrë dhe teknikë, informatikë dhe edukatë fizike. Përveç lëndëve të detyrueshme janë planifikuar edhe aktivitete tjera që janë të lidhura me kulturën, natyrën/mjedisin, teknikën, informatikën dhe sportin.

Në klasën e V kryesisht nxënësit vazhdojnë t'i mësojnë lëndët prej klasës së IV: gjuhë amtare, matematikë, gjuhë të huaj, art figurativ, edukatë muzike, natyrë dhe teknikë/informatikë, amvisëri dhe edukatë fizike. Në këtë moshë gjithashtu nxënësit angazhohen edhe me aktivitete tjera të planifikuara dhe të paramenduara nga sfera e kulturës, natyrës, teknikës, informatikës dhe sportit.

Për tërë periudhën e shkollimit të nxënësve prej klasës së I deri të VI është karakteristike edhe ajo se përveç lëndëve të detyrueshme që përfshihen në planin mësimor, në shkolla planifikohet dhe në mënyrë sistematike realizohet ndihma (e përbashkët) individuale dhe grupore e nxënësve me pengesa në mësim, si dhe mësimi plotësues dhe shtues që u përshtatet nevojave, interesave dhe aftësive të nxënësve.

Janë paraparë edhe aktivitete shoqëroro-humanitare të nxënësve në klasë, në shkollë si dhe në bashkësinë vendore.

#### • **Lëndët mësimore në periudhën ose ciklin përfundimtar**

Pas arsimit fillor gjashtëvjeçar nxënësit detyrimisht shkollohen më së paku edhe tri vjet në kuadër të shkollave fillore ose vazhdojnë në shkollë të ulët të mesme. Në klasën e shtatë në arsimin e detyrueshëm nxënësit, zakonisht i mësojnë lëndët vijuese: gjuhë amtare, matematikë, gjuhë e huaj, gjuhë e dytë nacionale, edukatë figurative, edukatë muzike, gjeografi, histori, arsim qytetar dhe etikë, teknikë dhe teknologji, dhe edukatë fizike. Shkolla iu ofron nxënësve që të bëjnë zgjedhje edhe për një gjegjësisht dy lëndëve zgjedhore me nga 1 orë në javë, ndërsa për lëndët zgjedhore për gjuhët dy orë në javë. Përveç këtyre lëndëve nxënësit angazhohen edhe në aktivitete tjera të planifikuara nga kultura, natyra, teknika, informatika dhe sporti.

Me programet që janë përgatitur sipas lëndëve të veçanta është caktuar se çka duhet të dije, të kuptojë dhe ta përdorë njohurinë çdo nxënës prej klasës së I deri të IX sipas lëndës së caktuar. Kështuqë, secili nxënës duhet të arrijë së paku nivel minimal të njohurive, që do t'ju mundësojnë arsimim të mëtejshëm. Për këtë arsye shkolla ka oligime që të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. Nxënësit, arsimtarët dhe prindërit i njohin standardet që janë përcaktuar sipas klasëve dhe cikleve arsimore dhe në këtë mënyrë e dijnë se çka duhet të arrijë nxënësi në lëndë të ndryshme në vite dhe periudha të veçanta në arsimin e detyrueshëm. Tregues për të arriturat e nxënësve janë notat të cilat janë masë për standardet e arritura të njohurive.

### • Mësimi i individualizuar dhe formimi i paraleleve

Gjatë planifikimit të mësimit kërkohen zgjidhje për dilemat sa i përket mësimin të individualizuar dhe zgjedhja e nxënësve për formimin e paraleleve. Ky problem lidhet edhe me diferencimin e nxënësve nga aspekti i njohurive dhe aftësitë e veçanta, ndërsa njëkohësisht ka të bëjë edhe planifikimin e mësimin për grupe të posaçme ku përfshihen nxënësit me njohuri apo aftësi të njejta. Në këtë mënyrë mësimi i është përshtatur njohurive dhe aftësive të nxënësve me çrast krijohen kushte për punë individuale dhe punë të përbashkët në grup, kështu që për këtë aspekt përdoret edhe termi mësimi i individualizuar.

Në më shumë vende të zhvilluara me programet e reja për arsimin e detyrueshëm në vitet përfundimtare në shkollë fillore nxënësit nga paralelet e të njejtës klasë (në klasën e VIII dhe IX) ndahen në grupe të ndryshme për vijimin e mësimin në gjuhën amtare, gjuhën e parë të huaj dhe matematikë. Për plotësimin e qëllimeve arsimore mësimi planifikohet në nivele të ndryshme. Pikërisht, ky model i planifikimit dhe organizimit të mësimin në shkollë ndihmon që të lihet pas dore unifikimi i programeve që ishte karakteristik për shkollën e jashtëzakonshme, e cila në kushte bashkëkohore nuk ka shumë aderues, pasi që ajo ofron masë të lëndës së mësimin që planifikohet sipas mesatares së caktuar, dhe unifikohet mësimi për të gjithë nxënësit në shkollë.

Për këtë arsye si dalje prej këtyre situatave praktikohet ndarje e përkohëshme ose e tërësishme e nxënësve nga klasa e njejtë, të cilët janë të sukseshëm ose të motivuar ndryshe, p.sh. për gjuhën amtare, matematikë dhe gjuhë të huaj, si dhe për interesat tjera të tyre të cilat mundet t'i realizojnë sipas lëndëve zgjedhore.

Kështu me këto mënyra të mësimin mund të tregohet se praktika lihet pas dore me diferencim rigoroz me të cilin nxënësit plotësisht ndahen dhe udhëzohen në të ashtuquajtura shkolla elite, ndërsa tjerët mbeten në shkollat e rëndomta për nxënësit mesatarë.

Sipas formave të reja të diferencimit të brendshëm në mësim paraqitet nevoja që arsimtari të përgatitë detyra plotësuese për nxënësit të cilët janë më të aftë, si dhe detyrat për nxënësit me aftësi më të vogla për t'i përsëritur dhe vërtetuar përmbajtjet.

Arsimtarët për ata duhet të kërkojnë mënyra më të qarta për përpunimin dhe sqarimin e nocioneve, termeve dhe ligjshmërive që përfshihen në programin mësimor, që tju ndihmojnë që të përparojnë bashkarisht me moshatarët e tyre në klasë. Mënyrat e tilla të të ashtuquajturit mësimi individual, pa dyshim janë të pranueshme në teorinë pedagogjike, megjithatë që të mundet arsimtari të punojë në mënyrë individuale me secilin nxënës ose me secilin grup të nxënësve paraqitet nevoja që paralelet të kenë numër më të vogël të nxënësve, që nuk është e mundur të arrihet madje edhe në vendet më të zhvilluara.

Për këtë arsye në shkollat fillore në vendet e zhvilluara zhvillohen modele të diferencimit fleksibil që përmbajnë kombinim të elementeve të diferencimit të jashtëm dhe të brendshëm. Praktikisht, nxënësit në arsimin e detyrueshëm në një numër të madh të lëndëve në orë janë së bashku në klasë të njejtë në paralelen amë, ndërsa vetëm në disa orë në lëndë të veçanta janë të ndarë dhe mësojnë në grupe të ndryshme, grupe homogjene me nxënës me njohuri të njejta, ndërsa për mësimin e orëve tjera kthehen në klasë të vetë. Kjo, gjegjësisht, mund të praktikohet edhe me planifikimin e mësimin në shkollat tona fillore, sepse mundet me rregullshmëri dhe më me sukses të organizohet mësimi plotësues dhe shtues për nxënësit në disa lëndë, ndërsa gjatë mësimin të rregullt nxënësit përsëri të jenë së bashku në paralelen e njejtë me moshatarët e njejtë. Diferencim i njejtë përdoret në shkollat e Sllovenisë dhe në vende të tjera, ku nxënësit tre të katërtat e orëve në lëndët e veçanta janë bashkë në të njejtën paralele dhe klasë me bashkënxënësit e tyre, ndërsa vetëm një e katërta e orëve punojnë sipas programeve të përthelluara në grupet homogjene të përshtatura njohurive të tyre. Gjithashtu, formë më të theksuar të mësimin diferencial ka edhe atëherë kur nxënësit vetë janë ndarë në grupe të veçanta për mësimin e gjuhës amtare, matematikë ose në gjuhë të huaj të parë gjatë tërë vitit shkollor, ndërsa mësimin në lëndët dhe në orët tjera e vijnë në

paralelen am të tyre në klasën përkatëse. Në grupet homogjene janë zgjedhur nxënës nga klasa e njëjtë, por nga paralele të ndryshme me njohuri dhe aftësi të ndryshme.

Mësimi diferencial në grupet homogjene në shkollat fillore në Slloveni mund të zbatohet vetëm për lëndët e përmendura në klasën e VII dhe IX.

Poashtu, ekziston mendim i përgjithshëm se çështjet e përmendura për programimin e mësimi duhet të parashihen edhe me Ligjin për arsimin fillorë të detyrueshëm, të rregullohen kompetencat e shkollës, arsimtarëve dhe nxënësve. Përveç kësaj duhet të sigurohen lokale për grupet e ndryshme, të përpilohet orarë për orët, të caktohen kritere për zgjedhjen e nxënësve në grupe gjatë së cilëve vendim përfundimtar duhet të sjellë nxënësi për shkak se vetë nxënësit mundet më mirë të vlerësojnë dhe të dëshirojnë ta ndryshojnë vendimin që do ta sjellin. Për këto lloje të programimit të mësimi duhet të verifikohen rregulla për kalimin e nxënësve prej njërit në nivelin tjetër mësimor.

#### • **Planifikimi dhe organizimi i mësimi në shkollatona**

Në Republikën e Maqedonisë koncepti për përmbajtjen dhe organizimin e arsimit fillor tetëvjeçar është sjellur në vitin 1996 dhe të njëjtin vit ka filluar gradualisht të zbatohet Plani i ri mësimor me programet e reja mësimore. Programet mësimore janë përgatitur nga komisione të veçanta të përbërë nga arsimtarë të fakulteteve/profesionist për lëndë të veçanta, arsimtarë nga shkollat dhe këshilltarë nga Byroja e zhvillimit të arsimit.

Programet mësimore përmbajnë qëllime të përgjithshme për mësimin (sipas lëndës përkatëse) dhe detyra për mësimin me çka konkretizohet qëllimi i përgjithshëm.

Për çdo tërësi të rrumbullaksuar (temë) nga programi paralelisht janë dhënë përmbajtjet, njohuritë, aftësitë, mjetet dhe aktivitetet. Është bërë përpjekje që të vërtetohen kataloqe të njohurive dhe aftësive themelore. Megjithatë, kjo nuk është e bërë në mënyrë themelore dhe me të drejtë mund të thuhet se edhe standardet e njohurive që janë paraparë me programet mësimore nuk janë të kontrolluar në mënyrë empirike.

Me modelet për planifikimin e mësimi, gjithashtu ishin të theksuara kërkesat për qasje të re në planifikimin dhe organizimin e mësimi në përputhje me nevojat zhvillimore dhe arsimore të nxënësve, megjithatë edhe pse koncepti ishte i pranueshëm për planifikimin procesoro-zhvillimor dhe përmbajtësor janë kontrolluar kryesisht njohuritë, ndërsa për shkathtësitë dhe qëndrimet ekzistojnë terme dhe dëshmi të cilat tregojnë të arritura të pritura.

Për nxënësit të cilët nga shkaqe të ndryshme më ngadalë përparojnë në mësim nuk është krijuar praktikë e theksuar për organizimin sistematik të mësimi plotësues.

Mirëpo, edhe për nxënësit e talentuar shkollat nuk planifikojnë dhe nuk ndërmarrin aktivitete të vazhdueshme jo vetëm për zbulimin e nxënësve të talentuar, por edhe programimin dhe realizimin e rregullt të mësimi shtues. Në praktikë kanë filluar tradicionalisht të bëhen përgatitjet e nxënësve për pjesëmarrje në garat shkollore, komunale dhe shtetërore në lëndë dhe njësi të veçanta.

Përfitimet kryesore në dhjetë vitet e fundit përmbahen në krijimin e mundësive që arsimtarët në mënyrë më të pavarur ta planifikojnë mësimin, t'i zgjedhin metodat dhe mjetet mësimore, të bëjnë zgjedhje të teksteve shkollore dhe burimeve tjera për mësim. Si përfitime të veçanta në proceset e ashtuquajtura planifikim më të hapur të mësimi është lidhja më e theksuar e mësimi me përvojën e nxënësit, organizimin fleksibil të orëve, nxitjen e aktiviteteve individuale të nxënësve dhe punën në grupe, ndryshimet në rradhitjen e mobiljeve në klasë me çka nxitet socializim dhe bashkëpunim më i mirë në mësim etj. Shikuar në tërësi, programet mësimore që janë sjellur dhe plotësuar pas vitit 1996 bashkë me përvojën e më shumë projekteve zhvillimore hulumtuese kanë dhënë bazë më të mirë për gumbullimin e treguesëve më objektiv për suksesin e nxënësve pas përfundimit të cikleve arsimore të veçanta.

## VIII. VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE PËRPARIMI I NXËNËSVE

### • Përvoja në vendet e zhvilluara

Përvoja në shkollat fillore në vendet e zhvilluara tregon se është lëshuar vlerësimi numerik i njohurive të nxënësve në klasët e ulta. Megjithatë, njohuritë tregojnë se me vlerësimin numerik të njohurive theks të veçantë i vihet motivimit të jashtëm të nxënësit për mësim, dhe për këtë arsye arsimtarët nuk kanë aq mundësi që ta zgjerojnë procesin e përgjithshëm të mësimit të nxënësit, kuptimin e nocioneve dhe raporteve të ndryshme, zbatimin e njohurive në detyra të ngjajshme apo të reja, mundësitë dhe aftësitë e nxënësve për njohuri të përgjithshme, zbulimin e pavarur të njohurive me metodat për mësim të pavarur, si dhe për vijimin e njohurive etj.

Duke u nisur nga rezultatet e hulumtimit për rëndësinë e motivimit në mësim në shkollat në vendet e zhvilluara zhvillohen modele për vlerësimin e njohurive që do të ndihmojnë për përmirësimin e objektivitetit të notave dhe motivimi i brendshëm i nxënësve për mësim. Më konkretisht për mësimin në klasat e ulta në shkollë fillore përdoren kombinime të ndryshme për notimin me shkrim dhe numerik. P.sh. nxënësit notohen me shkrim gjatë mësimit, ndërsa në fund të vitit shkollorë u jepen edhe nota me numra. Për këtë qëllim përdoren formularë të ndryshëm në të cilët janë ttheksuar njësitë e lëndëve, ndërsa janë caktuar edhe qëllimet gjegjësisht standardet etj. Zgjidhje të tilla ka në Francë, Danimarkë, Norvegji, Suedi, Portugali dhe në vende të tjera.

Arsimtarët e vlerësojnë përparimin dhe njohuritë e nxënësve me shkrim dhe me numra në të gjitha lëndët (p.sh. në Itali), për disa lëndë japin nota me numra, ndërsa për tjerët me shkrim (në Gjermani, Holandë etj).

Në vendet e zhvilluara notimi i njohurive dhe përparimi i nxënësve është i rregulluar më ndryshe në klasët më të larta në shkollat fillore, si dhe në arsimin e mesëm të ulët. P.sh. në Gjermani pas shkollimit katërvjeçarë në shkollë fillore përdoret vetëm notimi me shkrim, kurse në Danimarkë vlerësimi me shkrim bëhet pas arsimit të detyrueshëm gjashtëvjeçarë. Ndryshe është i rregulluar edhe vlerësimi dhe kontrollimi i njohurive në fund të cikleve të veçanta arsimore edhe në fund të arsimit të detyrueshëm. P.sh. kontrollimi ekstern i njohurive përdoret në moshën prej 7,11 dhe 14 për nxënësit në Britani të Madhe. Në Francë zbatohen teste nacionale të njohurive për shkrim, lexim dhe matematikë në fillim të ciklit të dytë të arsimit të detyrueshëm (prej moshës 8 deri 9 vjet) me çka merren informata kthyesë për të arriturat e nxënësve dhe për punën e arsimtarëve. Në Holandë me kalimin prej shkollës fillore në shkollën e mesme të ulët (në moshën 12- vjeçare përdoren teste nacionale për njohuritë që kanë funksion të japin tregues për fëmijët për orientimin e tyre të mëtejshëm). Në Irlandën veriore dhe në Luksenburg realizohet testim, kurse shkolla testet ua jep prindërve për mbikëqyrje.

Është e domosdoshme të theksohet se çdonjera nga qasjet e cekura gjatë notimit të nxënësve ka përparësi të caktuara, por edhe mangësi. Megjithatë, fakt është se askush nuk e njih nxënësin më mirë se arsimtari i tij, dhe për këtë arsye paraqitet nevoja për barazimin e kushteve në procesin arsimor dhe standardeve për tërë gjeneratën e nxënësve në fund të shkollës fillore, gjegjësisht arsimit të ulët të mesëm. Njëkohësisht me barazimin e kushteve dhe me vendosjen e kriterve për vlerësim krijohen mundësi reale për zbatimin e rezultateve të provimeve të njohurive. Rezultatet nga provimet e njohurive janë gjithashtu, bazë e vetme prej nga fillohet vlerësimi i cilësisë së punës në shkollë dhe arsimtarëve.

Mund të vërehet se me vlerësimin ekstern të njohurive (me ndihmën e testeve të standardizuara dhe detyrat e llojit objektiv) vlerësohet vetëm një pjesë e procesit arsimor dhe një lloj i caktuar i njohurive. Për këtë arsye rezultatet e vlerësimit ekstern janë vetëm një pjesë e të dhënave për përparimin e fëmijës. Gjithashtu, disa herë efektet e vlerësimit të vazhdueshëm të njohurive me shkrim gjatë procesit mësimor me përdorimin e testeve të standardizuara nuk përputhen me efektet e vlerësimit afatshkurtër të njohurive.

Me sistemin dhe mënyrën e vlerësimit është i lidhur edhe përparimi i nxënësve nga klasa në klasë. Në vendet e zhvilluara mbizotëron modeli i përparimit të vazhdueshëm i nxënësve në shkollën fillore. Duke u nisur nga ajo që nxënësi në fund të periudhave të caktuara mund ta përsërit klasën, përderisa nuk i arrijnë standardet e njohurive. Për ilustrim mund të shërbejnë të dhënat nga viti 1995 sipas të cilëve mesatarja e nxënësve të cilët e përsërisin vitin në nivel të parë në arsimin e detyrueshëm sillet p.sh. në Belgjikë 16%, Francë 5%, Greqi 0%, Itali 4%, Portugali 2%, Holandë 3%, Norvegji 1%. Në Slloveni në vitin shkollor 1992/93 në popullsinë e përgjithshme të nxënësve (prej klasës së I deri të VIII) ka pasur 4% nxënës që kanë përsëritur, ndërsa në Republikën e Maqedonisë në vitin 2004/2005 prej klasës së I deri të VIII kanë përsëritur 789 nxënës ose 0,35%.

#### • **Përvoja në vlerësimin e njohurive të nxënësve në shkollat tona**

Vlerësimi i njohurive të nxënësve në shkollë fillore është i rregulluar me Ligjin për arsimin fillor, ndërsa nga afër është sqaruar plotësisht me Rregulloren e veçantë që është sjellur në vitin 1996 dhe plotësuar në vitin 2001 me një anëtar për vendosjen e vlerësimit ekstern të përkohshëm të nxënësve.

Në tri klasat e para (prej klasës I – III) vlerësimi i njohurive të nxënësve është me shkrim, pastaj kalohet në notimin me numra, kështu që në fund të mësimit në klasën e tretë sipas konceptit është paraparë që nxënësi të marrë nota me numra.

Notimi është publik, ndërsa arsimtari i njofton nxënësit me qëllimet e mësimit dhe i cakton mënyrat e notimit, si dhe afatet me në të cilat notohen nxënësit. Notimi bëhet para klasës ose në grup nxënësish dhe për rezultatet e arritura regullisht informohen nxënësit dhe prindërit. Sipas kërkesës së prindërve dhe nxënësve ju mundësohet të bëjnë mbikëqyrje në punimet me shkrim dhe detyrat tjera.

Rregullorjapër vlerësimin e nxënësve nuk është ndryshuar edhe përveç asaj që në këtë lëmi ekzistojnë probleme serioze, sepse në praktikën mësimore nuk përdoren mënyrat dhe procedurat sistematike objektive për vlerësimin e njohurisë të nxënësve as në fillim të vitit shkollor kur planifikohet mësimi e as në fund të procesit mësimor. Në praktik nuk ze vend zbatimi i testeve të standardizuara për t'u vlerësuar lloji dhe niveli i njohurisë të nxënësve që janë treguar me notat shkollore. Janë mbajtur procedura tradicionale edhe sipas rregullës burimi i veçant i të dhënave për zhvillimin dhe përparimin e nxënësve dhe për punën e arsimtarëve kanë mbatur vetëm notet e nxënësve që i marrin në shkollë.

Në vitin përgatitor në shkollë fillore edukatorët udhëheqin dosje për nxënësit në të cilën sublimohen treguesit më të rëndësishëm për zhvillimin e nxënësit. Dosja përmban tregues relevant të sistematizuar për përparimin e fëmijës dhe këto mund t'i përdorë arsimtari në klasën e parë ku vazhdon ta përcjellë zhvillimin dhe përparimin e nxënësit dhe për këtë e informon prindin. Në mbarim të mësimit të klasës së I nxënësi notohet me notim përshkrues. Njohuritë në disa lëndë janë caktuar me programet mësimore për lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore sipas planit mësimor të shkollës fillore. Në gjysmëvjetor dhe në mbarim të vitit mësimor caktohet sukcesi i përgjithshëm i nxënësit, kurse në gjysmëvjetor dhe në mbarim të vitit shkollor nxënësi notohet edhe për sjelljen e tij. Nxënësit, sipas rregullës përparojnë nga klasa e I deri të IV kurse në klasat më të larta ata nxënës të cilët në mbarim të vitit mësimor kanë nga dy nota negative vijojnë mësimin plotësues ose hynë në riprovim. Për përsëritjen e nxënësit në të njejtën klasë vendos këshilli i arsimtarëve në shkollë në bazë të arsyetimit me shtim nga kujdestari i paraleles.

Me konceptin e vitit 1996 ishte paraparë që të realizohej kontrollim përfundimtar i njohurive të nxënësve në mbarim të mësimit klasor dhe në mbarim të mësimit lëndor. Gjithashtu, këto risi në praktik në shkollat fillore nuk hasën ndonjë zbatim më të madh.

U planifikua në bazë të shqyrtimit të rezultateve në mësim dhe në aktivitete të tjera shkollore të përkatisin raporte, analiza, informata, dhe materiale tjera profesionale



për nevojat e organeve profesionale në shkollë si dhe për organet tjera që janë kompetente për punën në shkollë fillore. Por, këto ide nuk hasën përkrahje në praktikë. Byroja e zhvillimit të arsimit ishte e detyruar që t'i caktojë afatet për kontrollimin e njohurive të nxënësve që ishte planifikuar të realizohen në mbarim të mësimit klasor dhe lëndor, gjegjësisht për kontrollimin e njohurive të nxënësve në gjuhën amtare dhe në matematikë në klasën e VIII. Megjithatë kjo mënyrë e kontrollimit të njohurive të nxënësve u zbatua vetëm disa vite gjatë regjistrimit të nxënësve në vitin e I në shkollë të mesme. Për tejkalimin e ngjarjeve të pavolitshme para pesë viteve janë bërë hapat e parë të rëndësishëm për krijimin e sistemit të evaluimit ekstern në shkollë fillore e cila pastaj duhej të zgjerohet në bazë të programit nacional të miratuar për përcjelljen e të arriturave të nxënësve në arsimin fillor (në ekzemplarë reprezentatues ose në tërë popullatën) pas përfundimit të cikleve të caktuar (në mësimin klasor dhe lëndor). Për këtë qëllim Byroja e zhvillimit të arsimit me përkrahje të Qeverisë së Holandës dhe Bankës Botërore dhe me mentorim të Institutit për matje arsimore CITO nga Holanda, përgatiti dhe realizoi testimin nacional të të arriturave të nxënësve në mësimin klasor nga gjuha amtare (gjuhë maqedone dhe gjuhë shqipe) dhe nga matematika. Përderisa, përsëri në vitin shkollor 2005/2006 është realizuar testim vetëm në lëndën natyrë dhe shoqëri. Ende nuk është miratuar programi nacional për zbatimin e evaluimit ekstern në arsimin fillor. Ky program duhet të silllet së shpejti.

Mirëpo, jo vetëm kjo por problem ende më të madh në sferën e vijimit dhe vlerësimit të nxënësve paraqet ajo që nuk planifikohet dhe bashkëkohorizohet vijimi i rregullt dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve gjatë procesit mësimor me qëllim që të merren masa për përmirësimin e suksesit me organizimin dhe mësimin plotësues dhe shtues ose me ndryshime të metodave dhe kushteve të tjera për mësim.

Treguesët statistikor nga raportet e reja tregojnë se më tepër se gjysma nga numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore në fund të vitit shkollor 2004/05 kanë sukses të shkëlqyeshëm. Më konkretisht, në vitin 2004/05 me sukses të shkëlqyeshëm prej klasës së I deri të VIII ka 117 418 nxënës, ose 52,44% nga numri i përgjithshëm, 39 884 nxënës janë me sukses shumë të mirë ose 17,81%. Sipas kësaj, mbi 70% në shkolla fillore kanë sukses të shkëlqyeshëm dhe shumë të mirë. Nxënës me sukses të mjaftueshëm pothuajse nuk ka, ndërsa vetëm 34119 nxënës ose 15% janë me sukses të mirë.

Në periudhën pas vitit 2000-2006 vendi ynë përfshihet në disa projekte për evaluim internacional në arsim. Kështu që, projekti PISA, ose Pragrami që ka të bëjë me evaluimin ndërkombëtarë të të arriturave arsimore të nxënësve pas mbarimit të arsimit të përgjithshëm (nxënës të moshës 15-vjeçare, të cilët në sistemin tonë janë nxënës të vitit të I në shkollë të mesme), ka për qëllim ta vlerësojë përgatitjen e nxënësve për vazhdimin e shkollimit dhe përfshirjen në situata jetësore dhe profesionale. Më konkretisht kontrollohet „shkrim-leximi” i nxënësve në lexim, matematikë dhe shkencat natyrore. Ky projekt realizohet në intervale trevjeçare nën ombrellë të OECD. Aktivitetet në Republikën e Maqedonisë i organizon dhe i zbaton Byroja e zhvillimit të arsimit.

Projekti TIMSS ka të bëjë me studimin ndërkombëtarë të të arriturave arsimore në matematikë dhe shkencat natyrore. Nga ky hulumtim janë përgatitur studime ndërkombëtare komparative në të cilët bën pjesë edhe Byroja e zhvillimit të arsimit. Qëllimet janë që të vërtetohen njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në klasën e VIII në shkollat fillore nga matematika dhe shkencat natyrore (kimi, fizik, biologji, dhe gjeografi), ndërsa kontrollohen edhe faktorët tjerë të cilët kanë ndikim në të arriturat e nxënësve, kulturës, planit mësimor, programet dhe qëllimet, praktika mësimore, si dhe organizimi institucional shkollor. Ky hulumtim zbatohet në cikle prej pesë vitesh.

Studimi ndërkombëtarë PIRLS, gjithashtu paraqet hulumtim ndërkombëtarë që zbatohet në çdo pes vjet me qëllim që të grumbullohen të dhëna për aftësitë e nxënësve në moshën gjashtëvjeçare dhe nëntëvjeçare për të kuptuarit e materialeve të shkruara dhe për përvojën që e kanë arritur në shkollë dhe familje, si dhe për faktorët të cilët janë të lidhur me të arriturat e nxënësve.

Të dhënat nga këto studime na udhëzojnë në disa mbikëqyrje dhe vlerësime. Nxënësit tanë kanë përvoja të ndryshme në mësim në krahasim me moshatarët e tyre në vendet e zhvilluara, kurse treguesit komparativ japin bazë të vlerësojmë se janë ndryshime të domosdoshme për qëllimet, përmbajtjet dhe metodat e mësimit dhe të mësuarit. Gjithashtu, të nevojshëm janë ndryshimet në sistemin e përcjelljes dhe vlerësimit të nxënësve tanë, sipas rezultateve në suaza të hulumtimeve të përmendura, nuk përputhen me notat që i marrin nxënësit në shkollë fillore.

#### **IX. ARSIMIMI I ARSIMTARËVE DHE KOMPETENCAT E TYRE**

Në kushte të përshpejtimit të ndryshimeve të brendshme të përmbajtjes dhe organizimit të shkollave fillore me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit paraqitet nevoja që gjendjet me arsimin inicial të arsimtarëve dhe trajnimi plotësues i tyre të jenë vazhdimisht të përcjellura dhe të vlerësuara.

Numri më i madh i arsimtarëve në shkollat fillore kanë studime dyvjeçare për arsimtarët e akademisë pedagogjike, të grupeve të veçanta studimore për mësimin klasor dhe lëndor, kurse në praktikën mësimore arsimit i vazhdueshëm inicial i lëndëve për arsimtarë lëndorë shpesh herë ju mundësonë, që ta zbatojnë mësimin nga lëndët e ngjajshme në shkencat natyrore gjegjësisht shoqërore, kurse në disa raste edhe në lëndët tjera nga përmbajtja gjuhësore. Dekadave të fundit edhe në kopshte, foshnjore dhe shkollat fillore rritet numri i arsimtarëve me arsimim të lartë. Ky proces është i mbështetur në ligjet sistemore, si dhe me ndryshimet e planeve dhe programeve mësimore në fakultetet për profesionin e arsimtarëve. Në shkollat për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore janë punësuar arsimtarë me shkollë të lartë ose me studime të mbaruara në fakultetin e defektologjisë, si dhe arsimtarë me kualifikime profesionale për lëndë të veçanta mësimore dhe arsimim adekuat defektologjik

#### **Arsimtarë dhe bashkëpunëtorë profesional sipas shkallës së përgatitjes profesionale në shkollat fillore të rregullta**

Viti shkollor	Shkalla e përgatitjes profesionale				
	Sipëror	Lartë	Mesme	Tjetër	Gjithsej
2000/01	3547	9470	902	8	13927
2001/02	3790	9280	874	10	13954
2002/03	4280	9057	826	31	14194
2003/04	4929	8570	820	16	14335
1004/05	5531	8318	736	15	14600

*Burim: Informim për shkollat fillore dhe të mesme, Enti shtetëror statistikor në Republikën e Maqedonisë, Shkup (2001-2004).*

Kërkesat për rritjen e cilësisë në arsimin fillor çdoherë janë të lidhura jo vetëm me rritjen e nivelit të arsimit inicial të arsimtarëve, por edhe me zhvillimin e programeve për stazhim (përgatitja për punë) dhe përsosje profesionale. Me mbështetjen e këtyre mekanizmave në periudhën pas vitit 1996 pritej që të ndërtohet sistem i plotë për shkathtësitë të cilat do t'ju ndihmojnë arsimtarëve që të aftësohen më mirë për shkathtësitë që do t'i mundësojnë për tu përmirësuar cilësia në mësim dhe në të mësuarit, ndërsa me atë edhe mënyra e ndjekjes dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve.

Me dispozitat normative, arsimtarët, edukatorët dhe bashkëpunëtorët, të cilët për herë të parë punësohen në shkolla fillore kanë obligim që pas një viti ta japin provimin profesional, sipas programit që e sjell ministri i Arsimit dhe Shkencës me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit. Pas marrjes të statusit të arsimtarit, gjatë punës së tyre disa vjeçare, arsimtarët, edukatorët, bashkëpunëtorët profesional, dhe drejtorët e shkollave e kanë për obligim t'i ndjekin seminarët dhe format tjera për përsosje profesionale dhe pedagogjike. Përsosja profesionale dhe pedagogjike e arsimtarëve është në kompetencat e institucioneve të larta arsimore në të cilat janë organizuar studime për arsimtarë. Gjithashtu, obligimet më të mëdha për përkryerjen profesionale dhe pedagogjike në praktikë i ka Byroja e zhvillimit të arsimit. Me zbatimin e Ligjit për Byronë e zhvillimit të arsimit pritet që në mënyrë shumë të organizuar dhe profesionale të zgjidhen problemet dhe të përpilohen si dhe të realizohen programe bashkëkohore për trajnimin e arsimtarëve për vendosjen e ndryshimeve në arsimin fillor.

#### • Probleme dhe çështje aktuale

Sipas përvojës së deritanishme gjatë përsosjes profesionale dhe pedagogjike të kuadrove në shkollë fillore evidente janë kufizimet dhe nevojat që vijojnë:

1. Institucionet e larta arsimore të cilat organizojnë studime për arsimtarët ende nuk janë përcaktuar rrënjësisht që t'i ndjekin ndryshimet në mësim në shkolla fillore për përmirësimin e cilësisë në arsim. Kjo do të theksohet më tepër me aplikimin e Konceptit dhe me vendosjen e Planit të ri mësimor dhe programeve të reja mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar të obligueshëm.

2. Arsimi bazik i arsimtarëve që realizohet në suaza të numrit të madh të institucioneve të larta arsimore në vendin tonë është e domosdoshme që të theksohet dhe të garanton standarde për arsimtarët të cilët do të mundësojnë zbatim të suksesshëm të planeve të reja mësimore për arsimin fillor.

3. Institucionet e larta arsimore në bashkëpunim me Byronë e zhvillimit të arsimit e domosdoshme është të sjellin programe bashkëkohore për përsosje permanente profesionale dhe pedagogjike të kuadrit arsimor në shkollat fillore dhe të kenë qasje ndaj zbatimit të tyre.

Këto ndryshime janë të domosdoshme për disa arsye. Para së gjithash, pasiqë kuadri mësimor arsimin inicial e arrinë në më tepër institucione arsimore, secili fakultet për mësimdhënësit krijon standarde të veta, jo vetëm për studimet e lëndëve bazike për të cilat përgatiten arsimtarët, por nuk është vendosur një standard i qartë për përfshirjen e lëndëve shkencore për arsimin dhe metodikën e mësimin. Për arsimin pedagogjiko-psikologjik dhe metodik në disa fakultete për mësimdhënës gjatë studimeve ndahen shumë pak orë (kjo është nën 10% nga numri i përgjithshëm i orëve prej klasës së I deri të IV). Është e njohur se sipas standardit evropian në arsimin inicial të arsimtarëve përfshirja e lëndëve për përgatitje pedagogjike dhe metodike të arsimtarëve të ardhshëm sillet prej 25 deri 30% nga orët mësimore gjatë studimeve. Gjendjet e palakmueshme në arsimimin e arsimtarëve veçanërisht janë karakteristike për mësimin në periudhat fillestare të arsimit fillor prej klasës së I deri të VI. Është e njohur se aftësimi psikologjik, pedagogjik dhe metodik i arsimtarëve, si dhe motivimi i tyre për punën në shkollë janë faktorë shumë të rëndësishëm për mbajtjen dhe përmirësimin e cilësisë në mësim.

Analizat nga përvoja jonë pedagogjike tregojnë se përfshirja e ushtrimeve metodike të studentëve në shkolla, gjithashtu është nën standardet evropiane. Përveç, kësaj në asnjë institucion arsimor nuk zbatohet intervista dhe procedura tjetër për kontrollimin dhe motivimin e interesimit të arsimtarëve të ardhshëm të cilët më vonë mund të paraqesin probleme serioze në praktikën mësimore.

Gjendjet e përmendura tentojnë nevojë urgjente që universitetet të sjellin plane dhe standarde të përbashkëta për arsimimin inicial të arsimtarëve, që do të përputhen

me nevojat për mësimin në arsimimin nëntëvjeçar edhe pse regjistrimi i studentëve të përputhet nevojave e kuadrit arsimor për shkollat fillore që do të vërtetohen sipas lëndëve dhe njësive mësimore. Në disa fakultete dhe institucione të caktuara arsimore është e nevojshme që të ndryshohet praktika e deritanishme që të regjistrohen numër më i madh i studentëve nga kuota e paraparë për profilin e njejtë. Pasojat e këtyre gjendjeve me arsimimin e arsimtarëve janë të shtresave të ndryshme: papunësia, ridimensionimi i rrjetit, mospërputhja e ofertës dhe kërkesa e arsimtarëve për mësimin në shkollë.

Sa i përket përgatitjes së arsimtarëve para punësimit, për realizimin e mësimit, siç u përmend, është i domosdoshëm stazhim njëvjeçar, pas të cilit vijon provimi profesional prej dy pjesësh: pjesa teorike dhe praktike. Pjesa praktike nënkupton realizim të orëve mësimore para komisionit përkatës i cili e vlerëson punën e kandidatit. Pjesa teorike për arsimtarin nënkupton kontrollim të njohurive të tij nga metodika e mësimit dhe rregullativa juridike për arsim fillor.

Megjithatë, edhe në këtë segment të përgatitjes së arsimtarëve janë të domosdoshme ndryshime të mëtejshme me qëllim që të mundësohet modernizim i njohurive profesionale, shkathtësive dhe aftësive të arsimtarëve.

Paraqitet nevoja për formimin e përgjegjësive në punën e mentorit në stazhin e arsimtarëve, si dhe në inovimin e procedurave për ndjekjen dhe vlerësimin e të arriturave të arsimtarëve gjatë stazhit të arsimtarëve.

#### • **Zhvillimi i sistemit për trajnimin e arsimtarëve**

Duke i pasur parasysh ndryshimet në arsimin fillor të detyrueshëm paraqitet nevoja që të përgatiten programe për trajnimin e arsimtarëve. Për përsosjen e arsimtarëve ekziston Rregullativë ligjore sipas të cilës institucione kompetente në këtë sferë janë: Byroja e zhvillimit të arsimit, institucionet e larta arsimore, ku përgatiten arsimtarët, shkollat fillore dhe vetë arsimtarët, edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesional. Institucionet për përsosje permanente të kuadrit arsimor marrin iniciativa të ndryshme gjatë realizimit të trajnimit të arsimtarëve. Institucionet e larta ekzistuese, në të cilët shkollohen arsimtarë, edukatorë, punëtorë profesional të shkollës (pedagogë, psikologë, defektologë etj). Nuk participojnë në programet për përsosjen e tyre permanente profesionale. Ky është një ndër problemet më të mëdha në arsimimin e arsimtarëve dhe mësimdhënësve në Republikën e Maqedonisë.

Byroja e zhvillimit të arsimit duhet të përgatit plan dhe program për përsosjen profesionale të edukatorëve, arsimtarëve dhe mësimdhënësve për implementimin e suksesshëm të programeve të reja mësimore në shkollën fillore.

#### *X. BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT*

Në vendet e zhvilluara prindërit kanë rol të rëndësishëm për përmirësimin e punës në shkollë me mundësit e tyre për bashkëpunim me shkollën si dhe pjesëmarrja për organizimin e jetës dhe aktivitetet e fëmijëve në shkollë. Për këtë qëllim bashkëpunimi i tyre fillon në klasën/paralelen e mbledhjeve prindore me arsimtarin (në klasat e ulta) ose me udhëheqësin e klasave në klasat e larta.

Prindërit së bashku me arsimtarin diskutojnë për aktivitetet e zgjeruara të fëmijëve në shkollë (si p.sh. në shkollat në Slloveni për aktivitetet e nxënësve në ditët për sport, kulturë, teknikë dhe teknologji për mësimin në natyrë, grupet e valleve dhe për aktivitete tjera të planifikuara. Në këtë takime prindërit kanë mundësi që ti paraqesin vërejtjet e tyre lidhur me mbajtjen e mësimit, vlerësimin ose për sjelljen e nxënësve dhe arsimtarëve, si dhe për një varg pyetjesh tjera.

Në shkolla ka ditë të caktuara për bisedë me prindërit. Sipas nevojës prindërit mund të vijnë në shkollë të bisedojnë drejtpërdrejtë me arsimtarin/nxënësin për suksesin e fëmijës dhe të bëjnë plan se si t'i ndihmojnë. Kështu që, arsimtarët dhe prindërit bashkëpunojnë dhe ky bashkëpunim krijohet në praktikën shkollore.

Prindërit nga paralelja, gjegjësisht klasa e njejtë zgjedhin përfaqësuesin e tyre në këshillin e prindërve të shkollës. Ata propozojnë kandidatë për këshillin e prindërve i cili është organ më i lartë në shkollë fillore. Në shkollat në Slloveni në këshillin e shkollës, në të cilin ka 11 anëtarë, tre vende u takojnë prindërve.

Në qoftë se nuk ka mirëkuptim dhe nuk gjenden zgjidhje të mira për vështirësitë e nxënësit, atëherë bashkëbisedues tjetër i prindërit është kujdestari i klasës së fëmijës. Në rastet kur nuk mundet të gjinden zgjidhje për problemet që ndodhin, kompetent është drejtori. Por, përderisa prindërit edhe më tej mendojnë se shkolla nuk i kupton argumentet e tyre dhe se fëmijët e tyre nuk janë fajtor ata mund të drejtohen dhe të kërkojnë ndihmë të drejtëpërdrejt nga inspeksioni i shkollës.

Në shkolla ekzistojnë rregulla të qarta se ç'ka paguajnë prindërit për fëmijët e tyre si psh., në shkollat në Slloveni prindërit i paguajnë shpenzimet për uzhinë dhe drekë (në qoftë se fëmija vendos të merr), dëmshpërblim për shfrytëzimin e teksteve shkollore (nëse janë huazuar nga fondi shkollor për libra); më së shumti gjysma e çmimit të shpenzimeve për qëndrimin e vazhdueshëm të fëmijës nëse ajo është e nevojshme për fëmijët e klasës së V dhe VI në shkollën nëntëvjeçare (meqë për fëmijët prej klasës së I dhe IV shpenzimet për qëndrimin e vazhdueshëm të nxënësve në shkollë në përgjithsi i paguan shteti). Prindërit paguajnë një pjesë edhe për shpenzimet e ushqimit dhe qëndrimin e fëmijëve për mësimin në natyrë. Në qoftë se prindërit mirren vesh me shkollën mund të formojnë fond (dhe aty të futin vlerë të nënshkruar të mjeteve) për furnizimin e mjeteve që është mbi standardin e rëndomtë të shkollës. Fondi ka këshillin drejtues me kryetar dhe anëtarë prej të cilëve së paku tre përfaqësues janë nga shkolla. Punën e fondit e shqyrton këshilli i prindërve dhe këshilli i shkollës. E tërë kjo ndihmon që të rritet përgjegjësia e prindërve për punën dhe jetën e nxënësve në shkollë.

Secilin vit shkollor prindërit zgjedhin nga paralelja përfaqësues të tyre në këshillin e prindërve të shkollës. Në fillim të vitit shkollor mbledhjen e parë në këshillin e prindërve në shkollë e mban drejtori.

Këshilli i prindërve propozon programe të cilat i përmbushin standardet të cilët i ofron shkolla, i miraton propozimet që i jep drejtori për shërbimet e standardeve jep mendim për programin e zhvillimit të shkollës, plan të hollësishëm vjetor të shkollës dhe për raportin e drejtorit për punën e shkollës. Sipas nevojës ky organ i parasheh edhe raportet gjatë mësimin dhe vështirësitë, ankesat e prindërve lidhur me punën e shkollës dhe çështjet tjera aktuale. Këshilli i prindërve të shkollës zgjedh nga të gjithë kandidatët e propozuar tre anëtarë në këshillin e prindërve.

Këshilli i prindërve është organ më i lartë i shkollës fillore publike. Në atë ka tre përfaqësues nga themeluesit, pesë përfaqësues nga të punësuarit në shkollë dhe tre përfaqësues nga prindërit. Ata zgjidhen me vota të fshehura.

Këshilli i shkollës i posedon këto kompetenca;

- e emron dhe shkarkon drejtorin;
- i pranon programet për zhvillim, planin punues vjetor dhe raportet për realizimin e planeve të punës;
- vendos për zbatimin e mundshëm të programeve të standardizuara;
- vendos për ankesat për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve në shkollë;

Vendos për ankesat e prindërve sa i përket punës edukativo-arsimore në shkollë.

#### • **Funksionet e shërbimit profesional në shkollë**

Pedagogët dhe psikologët e shkollave, ndërsa në disa shkolla edhe punëtorët social, pedagogët social dhe defektologët kanë pothuajse kompetenca të qarta. Ata i japin të gjitha këshillat e nevojshme për nxënësit dhe prindërit e tyre, si dhe për arsimtarët. Me udhëheqësinë e shkollës bashkëpunojnë gjatë planifikimit dhe ndjekjes së punës edukativo-arsimore në shkollë, kurse marrin pjesë edhe në përgatitjen e planeve për punën dhe zhvillimin e shkollës së tyre. Për kryerjen e punës më

kompetente të tyre ata lidhen edhe me organet lokale dhe qendrore si dhe institucionet që janë kompetente për arsim.

Si shembull në Republikën e Sllovenisë shërbimet këshillëdhënëse të shkollës kanë ndikim shumë të rëndësishëm për zhvillimin e arsimit fillor nëntëvjeçar. Këto shërbime kanë kompetenca që janë të lidhura me regjistrimin e fëmijëve në shkollë, gjatë vendosjes së nxënësve dhe prindërve për lëndët zgjedhore. Ata u japin këshilla nxënësve dhe prindërve edhe për zgjedhjen e programeve për mësim të diferencuar sipas niveleve të përshtatjes/në gjuhën amtare, matematikë, gjuhë të huaj prej klasës së VII deri të IX. Puna e tyre këshillëdhënëse është e lidhur edhe me kontrollimin përfundimtar të njohurive të nxënësve në klasën e IX, si dhe gjatë të menduarit të nxënësve dhe prindërve për regjistrimin në shkolla të mesme.

Shërbimet këshillëdhënëse në shkollë kanë rol të madh për zhvillimin e kriterëve për zbulimin e nxënësve të talentuar gjatë planifikimit të programeve për punën me ato, si dhe për programet për punën me fëmijët me nevoja të posaçme.

Përshtypje e përgjithshme është se prindërit janë maksimalisht të informuar për punën në shkollë, për të arriturat e fëmijëve dhe ju ofrohen mundësi të ndryshme për pjesëmarrjen aktive në jetën dhe punën e shkollës.

#### • Çka tregon përvoja jonë

Në periudhën pas vitit 1996 ka pasur bashkëpunim në mes nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve në shkollat fillore në vendin tonë që të përshpejtohet dhe pasurohet. Në mbledhjet me arsimtarët e klasave dhe kujdestarin e klasës në mësimin lëndor prindërit të kenë marrëveshje dhe t'i planifikojnë aktivitetet me të cilët përmirësohen kushtet për punën edukativo-arsimore, si dhe për zgjidhjen e problemeve që ndodhin në jetën e shkollës së nxënësve me paregullsi gjatë notimit nga ana e disa arsimtarëve ose për tjera çështje gjatë sjelljes në mes nxënësve dhe arsimtarëve.

E domosdoshme ka qenë që të mbahet praktikë në shkollat, të caktohen orë për biseda me prindërit, me arsimtarë të lëndëve të ndryshme, Ndërsa për nxënësit të cilët kanë vështirësi në mësim të caktohen mënyra se si t'i ndihmohet.

Prindërit e klasës zgjedhin përfaqësuesin e tyre në këshillin e prindërve, ndërsa këshilli i prindërve zgjedh përfaqësues në këshillin e shkollës. Prindërit në këshillin e prindërve kanë më së paku tre anëtarë.

Mirëpo, me ligjin, por gjithashtu edhe në praktikë nuk janë rregulluar kompetencat e këshillit të prindërve në shkollë. Për këtë arsye në një far mënyre është lënë pas dore ndikimi i tyre në organizimin e jetës dhe punës së nxënësve dhe arsimtarëve në shkollë, kurse veçanërisht në zhvillimin e programeve dhe planeve për zhvillimin e shkollës.

Prindërit obligimet i kryejnë në kohë që t'i paguajnë shpenzimet për fëmijën e tyre në shkollë, por kuptohet se për ato çështje nuk janë caktuar rregulla të qarta.

Nuk është bërë praktikë për krijimin e fondeve shkollore sipas rregullave të përpunuara për participimin e mjeteve të prindërve në fondet dhe kriteret për mënyrën e udhëheqjes me fondet shkollore si dhe shpenzimi i mjeteve të caktuara.

Prindërit kanë të drejt të marrin informata për punën dhe jetën e nxënësve në shkollë, të njoftohen me të arriturat në mësim dhe në aktivitete tjera. Në përputhje me programin e punës ata mund të marrin pjesë edhe gjatë realizimit të përmbajtjeve të caktuara me nxënësit në shkollë dhe aktivitetet tjera të njejta të cilët kanë rëndësi për edukim dhe arsimim.

Nxënësit mbajnë përgjegjësi që rregullisht ta ndjekin mësimin, të bashkëpunojnë me arsimtarët dhe nxënësit tjerë, të marrin pjesë aktive në mësim, t'i respektojnë rregullat për rendin, mënyrën e sjelljes dhe normat e pranuar që kanë të bëjnë me jetën e përbashkët dhe punën e nxënësve dhe arsimtarëve në shkollë. Megjithatë, nuk është krijuar shprehje për informimin e prindërit, se kur e regjistron fëmijën e vet në shkollë, për planin e punës në shkollë, të drejtat dhe përgjegjësit e nxënësit dhe prindërit, por gjithashtu edhe për detyrimet e shkollës dhe arsimtarëve.

## *XI. TEKSTE SHKOLLORE, DORACAKË DHE FLETORË PUNË*

Në vendet e zhvilluara secila shkollë ka për obligim të krijojë fondin e vet të teksteve shkollore që nxënësit të mundën t'i huazojnë nga biblioteka e shkollës ato komplete që do t'iu nevojiten nxënësve për klasën e ardhshme. Në qoftë se, prindërit kanë interesim, mund të paraqiten për huazimin e teksteve shkollore nga fondi (por kjo nuk është e detyrueshme). Për librat e huazuara në Slloveni, psh. prindërit në shkolla paguajnë më së shumti një të tretën nga çmimi i tregut të teksteve shkollore në disa këste. Mjetet financiar që grumbullohen për përdorimin e teksteve shkollore shpenzohen sipas nevojës për blerjen e librave të reja (për ripërtirjen e fondit shkollor).

Fletoret e punës nuk u jepën nxënësve meqë në ato shkruhen zgjidhjet e detyrave dhe tekste tjera dhe për këtë arsye nuk mund t'i përdor nxënës tjetër.

Për përpilimin dhe botimin e teksteve shkollore janë vendosur standarde të larta, kurse bëhet vlerësim profesional i teksteve shkollore. Psh. në Slloveni, Enti për shkollim punon në mënyrë të vazhdueshme për vlerësimin e teksteve shkollore, doracakëve dhe literaturës tjetër për punën edukativo-arsimore në shkolla fillore.

Në vendin tonë sipas Ligjit për arsim fillor, Byroja e zhvillimit të arsimit ka kompetenca që të përgatit plan vjetor për botimin e teksteve shkollore, të zhvillojë metodologji dhe kritere për vlerësimin e teksteve shkollore. Me Ligjin e Byrosë së zhvillimit të arsimit nga ky vit dukshëm janë rritur kompetencat në këtë sferë.

Përveç që propozon programe për botimin e teksteve shkollore për arsimin fillor dhe për nivelet tjera të arsimit, kompetencat e Byrosë janë zgjeruar për vlerësimin e teksteve shkollore dhe revistave fëmijërore. Byroja jep mendim për përputhshmërinë e dorëshkrimeve të teksteve shkollore me konceptin për tekstin shkollor dhe programet mësimore. Nga e tërë kjo krijohet bazë që të zhvillohet sistem profesionalo-shkencor për procedurat, instrumentet, metodat dhe kriteret për vlerësimin e teksteve shkollore, revistave fëmijërore dhe literaturës tjetër që përdoret në shkollë.

Ndryshimet e theksuara sistematike duhet realisht të ndihmojnë që të tejkalohen dobësitë në të shkruar dhe përmirësimi i dorëshkrimeve të teksteve shkollore për përdoren në shkolla fillore. Me Ligjin për arsimin fillor janë vendosur kërkesa që të rritet përgjegjësia e shkollave deri në fund të vitit sdo shkollor të bëjë zgjedhje të teksteve shkollore dhe të njoftohen prindërit dhe nxënësit se cilët tekste shkollore do t'i përdorin në klasën e ardhshme. Shkolla duhet të mbajë përgjegjësi për zgjedhjen e teksteve shkollore dhe për këtë duhet ta informojë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, gjegjësisht Byronë e zhvillimit të arsimit.

## *XII. REZULTATE NGA ANALIZA DHE HULUMTIME TJERA RELEVANTE<sup>2</sup>*

Marrë në përgjithsi, nxënësit shumë pak marrin pjesë në vendosjen e punëve që kanë të bëjnë me jetën shkollore, nuk kanë mundësi që të marrin informata relevante, e as ta tregojnë mendimin e tyre që të ndikojnë në bazë të vendimeve që aplikohen në shkollë. Raporti i arsimtarëve mund të përshkruhet si mbrojtës/nënçmues dhe nuk e nxit zhvillimin e nevojës për pjesëmarrje të nxënësve, e as që u siguron fëmijëve vegla me të cilat do të mund të zgjedhen për përmbushjen e nevojave dhe interesave të tyre.

Procedurat demokratike nuk respektohen as në zgjedhjen e strukturave në të cilat marrin pjesë nxënësit, e as që janë prezent në kontekst të punës dhe vendosjes në kuadër të shkollës.

Prindërit nuk janë të informuar sa duhet dhe mungon mundësia për ndikimin e tyre sa u përket rasteve në shkollë. Në shkolla formohen trupa të paraparë ligjor ku marrin pjesë prindërit, por nuk janë krijuar mekanizma dhe procedura të cilët do të kishin mundësuar pjesëmarrje të vërtetë në vendosje.

<sup>2</sup> Shkolla sipas vështrimit të fëmijës, grup ekspertësh nga MASH dhe UNICEF, 2006

Konventa për të drejtat e fëmijës nuk është shpërndarë gjerësisht te fëmijët, ndërsa arsimtarët kanë njohuri të pakta të vlerave të cilat promovohen me atë dhe kanë rezistencë ndaj implementimit të Konventës në praktikë. Një ndër pohimet më të shpeshta në mes kuadrit arsimor është se fëmijët kanë shumë të drejta të cilat u respektohen, ndërsa nuk kanë detyrime përkatëse. Konventa nuk promovohet në mes prindërve, ndërsa njohuritë e prindërve nga kjo lëmi nuk zbatohen në praktikë.

Në shkolla zhvillohet mësimi nga lënda e historisë që është etnocentrike, gjegjësisht është i orientuar në etnikumin në të cilën gjuhë zhvillohet mësimi, ndërsa përmbajtjet për të tjerët që ekzistojnë në tekstet shkollore injorohen. Kuadri arsimor mendon se shkolla nuk është faktor i cili mund të ndikojë në marrëdhëniet ndëretnike në vend.

Përmbajtja e materialeve për mësim është e ngarkuar me të vërtet me stereotipe të ngjeshura edhe atë sa i përket përmbajtjes, por edhe më e shprehur në materialin ilustrues. Përveç kësaj, kuadri arsimor në tërësi nuk ka trajnim të mjaftueshëm për zbatimin e mësimin me përmbajtje dhe qasje të ngjeshur.

Disa shkolla nuk kanë kushte për t'iu përshtatur fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore. Shkollat tregojnë rezervë të madhe për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme në mësimin e rregullt, meqë kuadri arsimor nuk është i aftë të punojë me këto fëmijë, ndërsa shkollat nuk kanë defektolog dhe shërbim profesional adekuat.

Një pjesë e vogël e mësimin ka të bëjë me jetën e përditshme dhe nevojat praktike të fëmijëve.

Mësimi nuk është i individualizuar. Aktivitetet gjatë mësimin dhe të mësuarit janë përshtatur nxënësit/fëmijës mesatar i cili mëson vetë ose me të tjerët në kushte të cilat janë jo adekuate për kooperim. Të gjithë fëmijët mësojnë nga burimet e njejta varësisht nga potencialet dhe të arriturat individuale.

Mësimi plotësues dhe shtues praktikisht pothuajse nuk funksionojnë, edhe pse ekzistojnë në nivel deklarativ.

Në shkolla ekziston pothuajse prag i lartë i tolerimit ndaj sjelljes së dhunshme. Në disa shkolla, madje edhe dënimi fizik nga ana e arsimtarëve llogaritet si masë disiplinore e pranueshme. As nxënësit e as arsimtarët nuk janë trajnuar në mënyrë sistematike me shkathtësi për ballafaqimin me dhunën. Marrë në përgjithsi, përveç përmes aktiviteteve projektuese, në shkolla mungon edukimi sistematik i shkathtësive për jetesë (life skills).

### *III. TRANSPORTI I NXËNËSVE NGA SHTËPIA NË SHKOLLË DHE ANASJELLTAS*

Në vendet e zhvilluara nxënësit që jetojnë në lagje që janë në largësi prej 2,3 ose më tepër kilometra nga shkolla kanë të drejtë, sipas ligjit, për transport falas deri në shkollë. Për transportin e nxënësve duhet të merren vesh organet kompetente në komuna, shkolla dhe prindërit dhe të sigurojnë mjete financiare. Transportin e organizon shkolla, ndërsa disa shkolla mund të kenë edhe autobus të tyre shkollor ose së paku mini-autobus.

Psh., në Slloveni nxënësit prej klasës së I (të cilët shkojnë në shkollë në moshën gjashtë vjeçare) kanë të drejtë për transport pamarrparasysh largësinë e shkollës. Shkolla, prindërit dhe komuna bëjnë marrëveshje për transportin e fëmijëve në shkollë. Pas mbarimit të mësimin nxënësit e klasës së I menjëherë i bashkangjiten autobusit të shkollës nëqoftëse është i përputhur orari i vozitjes, në të kundërtën për fëmijët ka të organizuar qëndrim të vazhdueshëm në shkollë deri në arritjen e autobusit.

Në qoftë se fëmija është i inkuadruar në grupet me qëndrim të vazhdueshëm që zgjat më gjatë se koha kur niset autobusi i shkollës, atëherë fëmijën nga shkolla e marrin prindërit dhe ato e kanë obligim të kujdesen për transportin e fëmijës deri në shtëpinë e vet.

Në vendin tonë për nxënësit të cilët jetojnë në lagje në largësi prej 2 kilometrave nga shkolla ka të organizuar transport deri në shkollë. Shkolla dhe prindërit mirren vesh



për transportin e fëmijëve. Megjithatë, për nxënësit të cilët kanë më pak orë në mësimin e rregullt gjatë ditës në shkollë, në krahasim me nxënësit tjerë nga klasët më të larta me çka është organizuar transport i përbashkët, përderisa qëndrojnë në shkollë nuk ka aktivitete të kuptimësuar bazike.

Kjo ka dukshëm ndikim negativ në suksesin e tyre, dhe përveç kësaj rritet edhe ngarkesa e tyre pasi që të gjithë detyrat shkollore duhet t'i plotësojnë kur do të kthehen të lodhur në shtëpi. Për këto arsye duhet të planifikohet dhe të përputhet transporti i nxënësve, ndërsa koha përderisa janë në shkollë të planifikohet dhe plotësohet me aktivitete të nxënësve dhe arsimtarëve për plotësim të suksesshëm të detyrave shkollore.

#### *XIV. SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE SI BAZË E NDRYSHIMEVE*

Prej vitit 2005/2006 në shkolla fillore në vitin përgatitor regjistrohen fëmijë të cilët deri në fund të vitit kalendarik i mbushin 6 vjet. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve nga viset rurale dhe nga familjet me arsimim të ulët në mjediset më të varfëra nuk i ndjekin grupet për vitin përgatitor në shkolla e as në kopshte. Për këtë arsye, në klasë të I regjistrohen në moshën 7 vjeçare pa përgatitje të domosdoshme për shkollë fillore, kurse përveç kësaj nuk është arritur as lidhshmëri optimale (organizuese dhe përmbajtësore) gjatë punës edukative të vitit përgatitor me mësim klasor në shkollë fillore.

Për këto shkaqe, ka nevojë për zhvillimin e planit të ri mësimor dhe programeve të reja mësimore, me të cilët do të arrihen efekte vijuese: 1) për të gjithë fëmijët të garantohet përkrahje në periudhën më të rëndësishme të zhvillimit të tyre; 2) të sigurohen mundësi më të mira për mësim të vazhdueshëm për të gjithë fëmijët e moshës shkollore prej 6 deri 14 vjet në shkollë fillore; 3) të zvogëlohet ngarkesa e nxënësve me përdorimin e metodave të të mësuarit aktiv në lëndë të caktuara, thjeshtësimi i përmbajtjeve krahasuese, korelacion më të madh dhe lidhshmëri të lëndëve mësimore etj.

Në shkolla që punohet vetëm me një ndërrim, nevojitet që të organizohet qëndrim i vazhdueshëm, posaçërisht për nxënësit prej klasës së I deri të III, por sipas nevojës edhe prej klasës së IV deri të VI. Me programet e zgjeruara do të kenë më tepër mundësi edhe nxënësit edhe arsimtarët që gjatë ditës së punës (sikur në shkollat e vendeve të zhvilluara) pas mësimit të detyrueshëm në shkollë t'i përpunojnë detyrat e shtëpisë, arsimtarët të mbajnë më tepër orë për nxënësit me pengesa gjatë të mësuarit, të organizojnë regullisht orë për mësim plotësues dhe shtues, nxënësit të bashkëpunojnë në mes veti rreth aktiviteteve të ndryshme, të relaksohen dhe argëtohen. Me organizimin e ri të ditës së punës, në shkollë do të zvogëlohet ngarkesa e nxënësve në kohën e lirë, për përvetsimin e përmbajtjeve në familje, përpunimin e detyrave të shtëpisë, si dhe për përgatitjen e mësimit për ditën e ardhshme.

Analizat dhe përvojat tregojnë se në shkolla fillore nuk është në nivel organizimi i mësimit gjatë vitit shkollor (në katër tremujor dhe dy gjysmëvjetor). Me kohëzgjatje të kufizuar të tremujorëve, krijohet ngarkesë të nxënësit për shkak të përpunimit të shpejtuar të përmbajtjeve, përdorimit të tepërt të testeve për kontrollimin e njohurive, përpunim i përsheptuar i punimeve me shkrim dhe në vend që të arrihet vijim i vazhdueshëm, vërtimi dhe vlerësimi i njohurive dhe shkathtësive, më tepër ruhet vetëm ana formale që të notohen nxënësit në tremujorë, gjysmëvjetor dhe në fund të vitit.

Me organizimin e mësimit në tre periudha mund të fitohen këto përparsi: 1) të mundësohet planifikim më themelor në mësim dhe në aktivitete; 2) në mënyrë më themelore të planifikohen orët për vërtetimin dhe notimin e njohurive; 3) varësisht nga efektet që në kohë të ndërmerren masa për organizimin e mësimit plotësues dhe shtues, parakontrollim të metodave të cilat përdoren në mësim dhe në të mësuar nga ana e arsimtarëve dhe nxënësve. 4) të merren nota valide aq sa janë të arritur standardet

arsimore në periudha të caktuara gjatë vitit shkollor, por me atë edhe gjatë shkollimit të nxënësve.

Me programet mësimore, prej fillimit të shkollimit në periudhën e parë të arsimit fillor (prej klasës së I deri të III) ka nevojë që të mundësohet gradualisht dhe në mënyrë themelore planifikimi i qëllimeve, përmbajtjeve dhe aktiviteteve që të arrihet përputhje më e madhe në mësim dhe në të mësuar sipas dallime individuale të nxënësve. Nevojitet që qëllimet të përcaktohen në tërë periudhën prej klasës së I deri të III që nxënësit të mundën ato t'i arrijnë me shpejtësi të ndryshme mësuarit deri në fund të klasës së III.

Të gjitha lëndët që do të përfshihen në planin mësimor, ka nevojë të përpunohen dhe vendosen programe të reja mësimore të cilat do të jenë në përputhje në mënyrë optimale për karakteristikat zhvillimore dhe mënyrën e të mësuarit të nxënësve në periudha të caktuara zhvillimore. Me programet e reja mësimore do të mundësohet që të plotësohen kërkesat vijuese për arsimim bashkëkohorë: 1) të vërtetohen standardet themelore dhe më të larta të njohurive në lëndë të caktuara sipas klasave; 2) të udhëhiqet sipas parimeve, por kujdes themelor për standardet e njohurive të cilat i kanë arritur nxënësit gjatë periudhave zhvillimore përfshirëse në tre klasat e para, posaçërisht deri në klasën e VI dhe në periudhën përfundimtare në arsimin fillor nëntëvjeçar.

Sipas planin dhe programeve të reja mësimore ka nevojë që të arrihet planifikim parimor dhe themelor jo vetëm në mësimin e lëndëve zgjedhore dhe të detyrueshme, por edhe mbajtje të rregullt të orëve për ndihmë individuale dhe të përbashkët të nxënësve me pengesa në mësim, mësim plotësues për nxënësit të cilët ju nevojitet ndihmë e caktuar në lëndë të caktuara gjatë vitit shkollor dhe mësim plotësues për nxënësit e talentuar. Më realisht do të mund të planifikohen edhe aktivitetet tjera jashtëmësimore të nxënësve.

Ekipet profesionale / komisione për përpunimin e programit mësimor mund t'i shfrytëzojnë të arriturat shkencore, profesionale dhe përvojat, që ka të bëjë, para së gjithash me qëllimet dhe përmbajtjet mësimore dhe për përcaktim parimor dhe themelor të standardeve të njohurive dhe shkathtësive. Programet mësimore të lirohen nga shumë faktografi dhe përmbajtje krahasuese, kurse qëllimet mësimore të përcaktohen dhe sistematizohen në zhvillimin emocional, social të njohurive, psikomotorike dhe morale të nxënësve.

Sipas programeve të reja mësimore të planifikohen metoda përkatëse në mësim dhe shkencë me çka do të nxitet interesi, si dhe metodat dhe format e mësimit që janë përkatëse për moshën dhe aftësitë e nxënësve. Në klasët më të larta të zbatohet të mësuarit sipas metodës së zbulimit të njohurive, zbatimi i mjeteve, përpjekjet, ushtrimet dhe zgjidhjet e problemeve.

Sipas programeve mësimore të planifikohet numër i duhur i orëve mësimore për arsimtarët dhe nxënësit, për përsëritjen dhe vërtetimin e përmbajtjeve, për kontrollimin dhe vlerësimin e njohurive me gojë, më tepër orë për biseda dhe pyetje në mes nxënësve dhe arsimtarëve).

Nxënësit të fillojnë me mësimin e gjuhës së parë të huaj prej klasës së I në moshën 6-vjeçare me përdorimin e metodave që janë konform aftësive zhvillimore të fëmijëve (si në shkollat e vendeve të tjera në Evropë) dhe periudhë më të gjatë gjatë shkollimit të nxënësve në shkollë fillore.

Për krijimin e mundësive të nejta në arsim ka nevojë, që shkolla të mban llogari për të gjithë nxënësit, por kjo do të arrihet përderisa në fund të vitit shkollor në klasën e tretë të aplikohen kontrollime nacionale me shkrim të njohurive. Me këto do të kontrollohen se sa janë arritur standardet e njohurive që janë planifikuar sipas programeve mësimore. Meqenëse, përsëri pas mbarimit të klasës së VI mund të bëhet kontrollim vullnetar i njohurive, por veçanërisht në gjuhën amtare, matematikë dhe në gjuhë të huaj.

Në fund të klasës së IX ka nevojë të vendoset kontrollimi nacional i njohurive, për të gjithë nxënësit, në gjuhën amtare, matematikë, dhe si lëndë e tretë nga lëndët e detyrueshme që do ta përcakton ministri. Rezultatet nga kontrollimi nacional i njohurive duhet të shfrytëzohen si tregues plotësues për të arriturat e nxënësve.

Me ndryshimet duhet të plotësohen rekomandimet evropiane për mësim të individualizuar dhe të diferencuar, me krijimin e mundësive për zgjidhje të lëndëve në periudhën përfundimtare të arsimit fillor, dhe me kujdes më të madh për interesin e secilit nxënës, gjegjësisht edhe me respektimin e aftësive, interesimit dhe të arriturave të tij. Veçanërisht ka nevojë për një kujdes më të madh për nxënësit e talentuar, si dhe për nxënësit me vështirësi në mësim.

Në përputhje me përcaktimin dhe planifikimin e përfshirjes së të gjithë nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në shkollat fillore duhet të krijohen kushte që mësimi të organizohet në bazë të llojit dhe shkallës së pengesave, vështirësitë në zhvillimin e fëmijëve dhe të ndiqet se sa dhe si të plotësohen standardet që janë të caktuara me programet e arsimit fillor. Shkolla duhet të jetë konform nevojave të fëmijëve, por gjithashtu, duhet që të jetë konform edhe organizimit dhe mënyrat e kontrollimit të njohurive dhe përparimi, orari i orëve të mësimi, si dhe për ndihmën plotësuese të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Është e domosdoshme që të vërtetohet standard i qartë për arsimin në iniciativë të arsimtarëve dhe të sillen programe për trajnim të arsimtarëve për realizimin e e vazhdueshëm të programeve të reja mësimore dhe metodat e të mësuarit aktiv gjatë mësimi. Për këtë qëllim pritet që në arsim iniciativa e arsimtarëve të siguron përfaqësim më të madh të disiplinave pedagogjike dhe psikologjike, si dhe ushtrimet metodike për arsimtarët e ardhshëm.

Në shkollën fillore nuk mundet më të shtyhet nevoja për vijim të rregullt dhe objektiv dhe notimi i të arriturave të nxënësve. Përfitim i madh do të jetë përderisa do të mbetet modeli që kontrollimi dhe vlerësimi të bëhet komponentë përbërëse gjatë planifikimit të mësimi në secilën lëndë mësimore në shkollë fillore. Veçanërisht ky aspekt duhet të përpunohet edhe në konceptcionet dhe planet për botimin e librave të ndryshme. Në shkollë, gjegjësisht në politikën arsimore përparësi do të jetë në qoftë se vendosen rregulla të qarta ç'ka paguajnë prindërit për fëmijët e tyre prej klasës së I deri të III, si dhe në klasët më të larta. Gjatë kësaj duhet të përforcohen kompetencat e këshillit të prindërve në shkollë dhe të krijohen fonde shkollore ku do të investojnë mjete prindërit, organizatat dhe individët për krijimin e kushteve më të mira për mësim dhe të mësuarit.

Veçanërisht është aktuale nevoja që më thellësisht të kuptimsohet puna e shërbimit këshillëdhënës në shkollë fillore (pedagogët, psikologët, defektologët etj.), dhe të mbahet më tepër llogari për trajnimin profesional të këtyre kuadrove për plotësimin e punës këshillëdhënëse dhe profesionale në shkollë fillore.

Gjatë kësaj, më tepër duhet të përforcohet kujdesi i shtetit për krijimin dhe botimin e teksteve shkollore, doracakë dhe literaturë tjetër më cilësore (revista fëmijërore etj.) për përkrahjen e punës edukativo-arsimore dhe për plotësimin e qëllimeve të arsimit dhe edukimit në shkollë fillore.

**K O N C E P T I**  
**PËR EDUKIM DHE ARSIM FILLOR NËNTËVJEÇAR**

**PJESA E II**

## *I. HYRJE*

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë edhe në Ligjin për arsimin fillor ekziston bazë për zhvillimin e planit mësimor me programe mësimore për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvjeçar. Duke u nisur nga analiza për arsimin fillor në RM si edhe nga arsimi i obligueshëm në shtetet e tjera të Unionit Evropian është hartuar propozim për ridefinimin e qëllimeve zhvillimore, Plani i ri mësimor dhe programet mësimore për shkollat fillore me të cilat do të përmirësohet përmbajtja, organizimi dhe cilësia e arsimit dhe edukimit fillor.

Për zhvillimin e ndryshimeve të propozuara janë marrë parasysh arritjet bashkohore në shkencë, arsim dhe edukim, rekomandimet e Këshillit Evropian dhe organizatava të tjera ndërkombëtare, e veçanërisht, planet mësimore dhe përvojat të arsimit fillor dhe arsim të detyrueshëm në Austri, Britani të Madhe, Gjermani, Francë, Danimarkë, Finlandë, Suedi, Slloveni, Kroaci. Megjithatë, vëmendje e veçantë i është kushtuar përvojës në arsimin fillor në RM, veçanërisht që është arritur me hulumtimet zhvillimore dhe risitë në numër të madh të shkollave fillore. Në kuptim të kësaj më shumë nga zgjedhjet e propozuara në Koncepti për arsim fillor nëntëvjeçar, në të vërtetë janë kontrolluar në shkollat fillore në RM. Megjithatë, për disa nga ato është shumë e kuptueshme që do të ketë nevojë për përpunim të mëtejshëm dhe konkretizim në praktikën pedagogjike.

Kështu që, nga përvoja e deritashme gjatë viteve të kaluara ishte e nevojshme që të gjindet model për zhvillimin e arsimit dhe edukimit fillor, si dhe transformim i shkollave fillore sipas qëllimeve zhvillimore, planit të ri mësimor dhe zgjidhjet e tjera të sistemit të vendosur si të atillë. Duke e marrë parasyshë traditën shumëvjeçare dhe përvojën në zhvillimin e arsimit në RM dhe R. Sllovenisë (të zhvilluara në baza dhe parime të njëjta sikurse në sistemin e kaluar). si edhe ndryshimet që janë vendosur në periudhën e tranzicionit në mësimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në të dy shtetet, që në fazën fillestare filluan të lëvizin në sias qëllimeve përafërsisht të njëjta, u vlersua se më e dobishme do të jetë përvoja nga R. Sllovenisë në zhvillimin dhe ndërtimin e sistemit për arsim fillor në R. e Maqedonisë. Qëndrimi i këtillë mbështetet me argumentet vijuese: në të dy shtetet është realizuar plani mësimor tetëvjeçar në të cilën janë ridefinuar qëllimet dhe parimet e arsimit në drejtim të aftësimin të rinjëve për të jetuar dhe punuar në shoqëri demokratike dhe qytetare. Dekadën e fundit, gjithashtu, ekziston vendim për zhvillimin e modelit të arsimit të detyrueshëm fillor nëntëvjeçar që është i zhvilluar në përpunime me karakteristikat zhvillimore të nxënësve në periudha të caktuara zhvillimore siç është në Republikën e Sllovenisë dhe në vendet tjera të zhvilluara të BE.

Në shtojcën e këtij vendimi mjaft me rëndësi është ajo që ndërmjet institucioneve arsimore nga Republika e Sllovenisë dhe nga Republika e Maqedonisë ekziston bashkëpunim shumëvjeçar, si dhe ajo që Republika e Sllovenisë me sukses i ka zbatuar reformat në të gjithë nivelet e arsimit, e veçanërisht në arsimin fillor.

Në veçanti janë të rëndësishme afërsia dhe përpunueshmëria në projektet zhvillimore-hulumtuese për inovimin e procesit mësimor me vendosjen e mësimin interaktiv në arsimin fillor, shfrytëzimi i përvojave për notimin përkrahues (vizita dhe trajnimi i këshilltarëve të Maqedonisë në Slloveni); dhe përvoja nga Republika e Sllovenisë, e veçanërisht nga Mbretëria holandeze për aplikimin e

vlerësimin nacional të nxënësve në mësimin klasor dhe lëndor në shkollat fillore në vendin tonë.

Gjithashtu, përvoja nga Republika e Sllovenisë si më e përshtatshme me zhvillimin e sistemit tonë arsimor dhe më e afërt me vendet e zhvilluara të BE, përputhet edhe me Programin nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë prej vitit 2005-2015.

Në pajtim me përvojën e deritashme në zhvillimin e konceptit për vendosjen e arsimit fillor nëntëvjeçar, paraqitet nevoja jo vetëm për sjelljen e planit të ri dhe programeve të reja por edhe për formimin e elementeve tjera të sistemit të arsimit fillor me sjellje të njëkohëshme të ligjit të ri për arsimin fillor, si dhe ndërmarrja e masave të mëtejshme për përmirësimin e kushteve në shkolla, me zgjerimin e hapësirës, sigurimit të pajisjes, rritja e mjeteve financiare, përforcimi i kujdesit për mirëmbajtjen e hapësirës dhe mjetet për mësim dhe aktivitetet tjera të nxënësve në shkolla fillore.

Me masa bashkërenduese mes organeve shtetërore dhe lokale për arsim, shkollat dhe prindërit, do të mund të krijohet bazë më e mirë për zbatimin gradual në praktikën e planit të ri mësimor, programet e reja mësimore e me atë për zhvillimin e kurrikulumit integruar për përmirësimin e arsimit dhe edukimit të nxënësve në shkollat fillore.

## *II. PARIMET E ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR*

### **• Parimi i demokratizimit**

Arsimi fillor është i obligueshëm dhe dedikuar për të gjithë fëmijët pa marr parasysh gjininë, përkatësinë sociale dhe kulturore, përkatësinë fetare, kombëtare dhe aftësitë fizike dhe intelektuale.

Edukimi dhe arsimi fillor duhet të jetë i orientuar kah zhvillimi i personalitetit të fëmijës dhe vlerave themelore të njeriut: rëndësia e jetës së njeriut, liria individuale, integriteti, dinjiteti dhe të drejtat e barabarta për të gjithë. Në pajtueshmëri me këto vlera shkolla krijon kushte për përforcimin e ndjenjave individuale për liri, tolerancë dhe përgjegjësi.

Njëkohësisht, shkolla fillore duhet t'i mbështesë nxënësit që ta zbulojnë veçantitë e tyre si individ dhe në mënyrë aktive të përgatiten për jetë me përgjegjësi në shoqërinë demokratike qytetare.

Shkollimi fillor duhet t'iu garantojë nxënësve mundësi të njejta për arsim të mëtejshëm në shkollat e mesme.

Personave të cilët për arsye të ndryshme nuk e kanë rrumbullakësuar arsimin e obligueshëm nëntë vjeçar, duhet t'ju mundësohet atë ta bëjnë në arsimin fillor për të rriturit.

### **• Parimi i mosdiskriminimit**

Shkolla do t'i ndërmerr të gjitha masat e duhura që të sigurojë mbrojtje të fëmijës (nxënësit) nga të gjitha format e diskriminimit gjatë qëndrimit të tij në shkollë dhe mbajtjen e të gjitha aktiviteteve në procesin edukativo-arsimor. Shkolla do të promovojë dhe mundësojë realizim të të drejtave të çdo nxënësi dhe kënaqësin e të gjitha **krijësive** në procesin edukativo-arsimor pa asnjëfarë diskriminimi të bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, gjininë, gjuhën, përkatësinë fetare, çështjen politike ose tjetër, prejardhjen kombëtare etnike ose sociale,

gjendjen e pronësisë, paaftësinë ose statusin tjetër të fëmijës, ose të prindit të tij ose tutorë ligjor.

- **Parimi i respektit të dallimeve individuale mes nxënësve**

Në arsimin dhe edukimin fillor duhet të krijohen mundësi që çdo fëmijë maksimalisht t'i zhvillojë predizpozitat e veta, aftësitë intelektuale dhe fizike si dhe talentin. Mësimi dhe aktivitetet tjera në shkollë fillore duhet të jenë në përputhje me dallimet individuale në mes nxënësve, me mënyrën dhe shpejtësinë në mësim dhe përparimi i secilit nxënës. Në këtë mënyrë do të zbatohen edhe metodat e ndryshme për motivim dhe mësim, përmbajtjet mësimore që u përshtaten nevojave individuale dhe mundësi për nxënësit dhe lloje të ndryshme të mësimit të individualizuar që do të sigurojë respekt të dallimeve dhe specifikave të zhvillimit fëmijëror, shpejtësia e përparimit në mësim dhe talenti i fëmijës.

Arsimtarët dhe shkolla kanë përgjegjësi të veçantë ndaj nxënësve të cilët për shkaqe të ndryshme kanë vështirësi në të mësuar dhe në arritjen e qëllimeve arsimore, që vijnë në shprehje me përshtatjen e përmbajtjeve në mësim me tempo të ndryshme në të mësuar dhe përparimi i nxënësve.

- **Parimi i zhvillimit të tërësishëm të personalitetit të nxënësit**

Të gjithë fëmijëve në edukimin dhe arsimin fillor duhet t'u garantohet shkollim i rregullt i vazhdueshëm në shkollë fillore dhe t'u mundësohet të marrin njohuri, përvojë dhe shkathtësi në fushën njohëse, emocionale, sociale dhe psikomotorike. Prandaj në planifikimin dhe në procesin e mësimit dhe mësimnxënies duhet të respektohen ligjshmëritë në zhvillimin e nxënësit, e veçanërisht t'u mundësohet përparim gradual dhe i relaksuar prej një nivel cilësie në nivel tjetër dhe periudhë specifike në mësim.

Gjithashtu, shkolla fillore duhet të jetë mjedis i volitshëm ku nxënësve do t'u mundësohet zhvillim i drejtë social dhe emocional dhe përkrahje për shëndetin fizik dhe mental të nxënësve.

- **Parimi për interes më të mirë të fëmijës**

Gjatë tërë procesit edukativo-arsimor dhe qëndrimit të fëmijës në shkollë me rëndësi primare janë interesat e tij. Të gjithë nxënësit e moshës së rritur në procesin edukativo-arsimor (që nënkupton të gjithë të punësuarit në shkollë, prindërit dhe bashkësinë) në mënyrën e zbatimit të aktivitetetve, zgjidhjet që bëhen dhe sjellja e tyre, vazhdimisht do të mbajnë llogari për interesin më të mirë të fëmijës.

- **Parimi për pjesëmarrje aktive të nxënësve në jetën e shkollës**

Shkolla do të mundësojë pjesëmarrje aktive të nxënësve në rrjedhën e të gjitha aktivitetetve në shkollë që kanë të bëjnë me atë. Kjo nënkupton: a) sigurim të atmosferës dhe kushteve që do t'i stimulojë nxënësit të formojnë mendimin e tyre personal dhe lirshëm ta shprehin atë mendim dhe b) ndërtimi i mekanizmave dhe procedurave të cilët do t'ju mundësojnë nxënësve të kryejnë ndikim përkatës lidhur me ngjarjet dhe vendimet në shkollë.

Ky parim e përmban të drejtën e secilit fëmijë që të kërkojë dhe të pranojë informata, të marrë pjesë në proceset e vendosjes dhe të shoqërohet me fëmijët

tjerë për shkak të formulimit dhe manifestimit më adekuat të interesave dhe nevojave të veta.

- **Parimi i cilësisë së arsimit dhe krahasimi ndërkombëtar i njohurive**

Një nga kushtet e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë të arsimit është që tek nxënësit të nxitet kureshtja dhe motivimi për mësim, veçanërisht tek nxënësit më të aftë dhe më të talentuar.

Përmirësimi dhe mbajtja e cilësisë në arsim nënkupton: përgatitja e programeve mësimore cilësore me planifikim procesoro-qëllimor dhe procesoro-zhvillimor, të garantoj mësim efikas dhe cilësor;

- të vendoset sistem i përcjelljes dhe notimit që do t'i respektoj mundësitë e nxënësve dhe gradualisht do të kaloj prej notimit përshkrues kah notimi numerik;

- të vendosen standarde nacionale të diturive dhe kriteriume për përparim të nxënësve në shkollim, si dhe standarde për arsimtar efikas dhe shkollë fillore efikase.

Me mësimin dhe mësimnxënien nxënësit duhet të nxiten përmes veprimeve hulumtuese, t'i zbulojnë dhe t'i zhvillojnë dituritë , sistematizojnë dhe përdorin në rrethana dhe kushte të reja. Gjithashtu, duhet të zhvillohet ndjeshmëri tek nxënësit për probleme dhe mënyra të ndryshme për aftësimin e tyre.

Me rëndësi është që shkollat të jenë të hapura për inovacione nga shtetet me përvojë më të madhe në arsim dhe që janë treguar me përvojën e tyre edukative. Për përparimin e edukimit dhe arsimit fillor vazhdimisht duhet të përcillen arritjet shkencore dhe profesionale që gjenë përdorim në zhvillimin e programeve mësimore, zgjedhja e metodave të mësimit aktiv dhe veprimet dhe mënyrat e përcjelljes dhe notimit të arritjeve të nxënësve në mësim dhe nxënie. Veçanërisht duhet të përforcohet kujdesi për zhvillimin e sistemit të njohurive shkencore duke përdorur burime të ndryshme për mësim që janë të përshtatura për nevojat, kushtet dhe tempon e përparimit të nxënësve. Sistemi i notimit duhet të mundësoj arritje të standardevetë njohurive dhe shkathtësive që janë të krahasueshme me njohuritë e nxënësve në shkolla të tjera.

- **Parimi i karakterit gjitharsimor në shkollë fillore**

Karakteri gjithpërfshirës në shkollë fillore nuk duhet të ndryshohet në asnjë nga pjesët e saja në përmbaje dhe aktivitete për pregaditje për profesion të caktuar. Lëndët zgjedhore, gjithashtu duhet të kenë karakter gjithpërfshirës dhe të ofrojnë njohuri dhe aftsi aplikative në arsimin e mëtejshëm të nxënësve.

- **Parimi i përgatitjes së nxënësve për mësim të përjetshëm**

Ky parim ka për qëllim që mësimi të pasurohet me përmbajtje, metoda dhe teknika të rejtatë cilat e nxisin mendimin kritik të nxënësit të gjitha moshat dhe në kuadër të të gjitha lëndëve mësimore. E nevojshme është që nxënësit si subjekte në procesin mësimor të aftësohen që të mendojnë në mënyrë kritike, të marrin përgjegjësi për mësimnxënien e tyre, të bashkëpunojnë me të tjerët dhe të zhvillohet kureshtja dhe nevoja nga të mësuarit dhe sendërtimit personal i njohurive. Me motivim dhe aftësim të vazhdueshëm të nxënësve për përdorimin



e metodave dhe teknikave efikase të të mësuarit të pavarur, do to mundësohet që ato të bëhen të lidhur me idenë për mësimin e përjetshëm.

- **Parimi i të kupuarit të të tjerëve dhe multikulturalizmi**

Në edukimin dhe arsimin fillor me përmbajtjet, metodat dhe aktivitetet, si edhe me jetën dhe punën e përgjegjshme të nxënësve dhe arsimtarëve duhet të zhvillohet vlera që bazohen në tolerancë, respektim i dallimeve mes njerëzve dhe të të drejtave dhe përgjegjësi. Gjithashtu, shkolla duhet t'iu ofroj nxënësve mundësi për përfitimin e diturive dhe zhvillimin e shkathtësive për t'i kuptuar dhe respektuar të tjerët.

Multikulturalizmi i shoqërisë maqedonase kërkon që shkollat fillore ta promovojnë zhvillimin e vlerave të nxënësve për bashkëjetesë, respektim i dallimeve mes njerëzve dhe kulturës, gjuhës dhe traditës së tyre. Shkolla mban përgjegjësi për zhvillimin e vetëdijes tek nxënësit për prejardhjen e tyre kulturore, dhe, gjithashtu, edhe për nxitjen e intersimit për njoftimin të trashigimisë kulturore të bashkësive të tjera.

- **Parimi i përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin fillor**

Arsimi fillor për fëmijët me nevoja të veçanta organizohet në mënyrë më të volitshme me qëllim që të mundësohet përparim i tyre më i mirë në mësim dhe nxënie në pajtueshmëri me mundësitë individuale. Duhet të bëhen përpjekje nxënësit me NVA të kyçen në paralelet e rregullta të shkollave fillore, ndërsa kur ekzistojnë arsye, shkollimi fillor për ata organizohet dhe realizohet në shkolla të veçanta ose në paralele të veçanta pranë shkollave fillore.

Në shkollat fillore duhet të krijohen kushte kadrovike dhe kushte të tjera për arsimim të fëmijëve me NVA, e për atë qëllim përdoret edhe qasja e individualizimit në hartimin e programit mësimor.

Në arsimimin e fëmijëve me NVA përfshihet edhe aftësimi i tyre për jetë në mjedis shoqëror.

- **Parimi i sigurisë fizike dhe shëndeti**

Shkolla do t'i ndërmerr të gjitha masat e duhura të cilët janë të domosdoshme që të mundësohet siguria fizike, si dhe ruajtja dhe përparimi i shëndetit të nxënësve. Kjo nënkupton se shkolla do t'i ndërmerr të gjitha masat e sigurisë – a) rumbullaksim i cili paraqet kërcënim potencial ose real në shëndetin fizik dhe integritetin e nxënësve; b) klima pozitive psiko-sociale në shkollë; c) zbatimi konsekuent dhe senzitiv i parimit të jodhunës në çfardo forme; ç) mundësi për të gjithë nxënësit, gjatë mësimit të rregullt, të arrijnë shkathtësi dhe njohuri për atë se si ta ruajnë dhe përparojnë shëndetin, se si të ballafaqohen me stres dhe se si me metoda të padhunshme që të zgjidhin situata konfliktuoze.

- **Parimi i autonomisë, kompetencës dhe përgjegjësisë**

Ky parim e definon shkollën si institucion autonom në marrëdhënie me qeverinë, bashkësitë fetare, partit politike, si dhe arsimtarëve dhe nxënësve. Shkolla nuk duhet të jetë nën ndikim të botkuptimeve religjioze, politike ose të tjera që janë jashtë parimeve dhe qëllimeve të edukimit dhe arsimit fillor,

megjithatë në të ka vend për të gjithë nxënësit pa marr parasysh personalitetin e tyre, mendime dhe bindje fetare dhe të tjera.

Dhe përgjegjësia tjetër shihet në mundësinë e arsimtari vetë ta planifikoj dhe realizoj mësimin dhe me funksionin që e kryen në pajtueshmëri me parimet dhe qëllimet të sistemit të edukimit dhe arsimimit.

Nxënësi ka të drejtë dhe përgjegjësi në të shprehurit dhe liri të kërkoj, të kaloj dhe të jep informata dhe ide nga të gjitha llojet qoftë me gojë ose me shkrim.

#### • **Parimi i partneritetit mes shkollës, prindërve dhe mjedisit lokal.**

Ky parim bazohet në tri komponenta: (1) në obligimin e shkollës prindërve t'iu mundësojnë qasje me kohë në informatë për atë ç'ndodh në shkollë, e që është relevante për shkollimin e fëmijëve të tyre, si dhe informata që janë të lidhura me punën dhe përparimin e fëmijëve në shkollë; (2) të mundësohet participim i plotë i prindërve në sjelljen e vendimeve në shkollë, ndërsa sa i takon edukimit dhe arsimimit të fëmijëve, si dhe përmes pjesmarjes së srejtpërdrejtë në aktivitetet e shkollës, dhe (3) hapja e mundësisë për prindërit dhe bashkësinë lokale në mënyrë aktive ta përkrah jetën dhe punën e nxënësve në shkollë.

Shkolla duhet të realizojë program për përforcimin e kulturës pedagogjike të prindërve dhe të marr pjesë në realizimin e programës në mjedisin lokal që i takon kulturës, traditës, artit, ekologjisë dhe mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit.

Në pajtueshmëri me programin për punën e shkollave fillore, nxënësve dhe prindërve të tyre duhet t'iu sqarohen mirë qëllimet e arsimit, kërkesat e shkollës, si dhe të drejtat dhe obligimet e nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve. Gjatë kësaj, është e domosdoshme të përdoren metoda demokratike që kontribuojnë për jetë proaktive dhe më me përgjegjësi të nxënësve, mendim kritik për vlerat dhe gadishmëria për dialog, komunikim dhe kuptim.

Prandaj shkolla fillore duhet t'iu mundësojë nxënësve dhe prindërve të marrin pjesë jo vetëm në planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta, por edhe në realizimin e tyre në varshmëri nga interesat dhe aftësitë e nxënësve. Në shkollë duhet të kihet kujdesë edhe për mbrojtjen e individualizmit dhe privatësisë, e veçanërisht të rritet kontrolli gjatë dhënies së të dhënave personave të tjerë, institucioneve dhe prindërit e tyre.

Opinionin duhet të ketë mbikëqyrje në cilësinë e punës edukativo-arsimore, ndërsa mënyra dhe veprimet e përcjelljes dhe notimit të të arriturave të nxënësve janë nën ingerenca të shkollës siç është e rregulluar me Ligjin për arsim fillor.

### *III. QËLLIMI I ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR*

Qëllimi i arsimit dhe edukimit fillor është bazë nismëtare për planifikimin e arsimit dhe aktiviteteve e tjera të nxënësit, si dhe për zhvillimin e programeve për punë të shkollave fillore.

Edukimi dhe arsimi fillor ka për qëllim të mundësojë:

***1. Zhvillim të harmonizuar të nxënësve (kognitiv, emocional, social dhe psikomotorik) në pajtueshmëri me aftësitë e tyre individuale dhe ligjet***

## ***zhvillimore dhe zhvillimi i personalitetit të nxënësit mbi baza të parimeve të respektimit të drejtave dhe lirive elementare të njeriut.***

Kjo arrihet me:

- ngritjen e vetëdijes tek nxënësit për individualitetin e vet dhe përkatësinë gjinore, nxitje të vetëbasimit dhe përgjegjësisë të veprimeve të veta;
- edukim për respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive elementare, si dhe të jetuarit në një shoqëri demokratike edhe atë me metoda të cilat i përkrahin këto vlera;
- zhvillim i shkathtësive komunikative, mendim kritik dhe kreativiteti i nxënësve;
- zhvillim i shkathtësive për të njohur ndjenjat e veta dhe ti kuptojë ndjenjat e të tjerëve;
- promovim i rëndësisë së nxënjes dhe punës;
- aftësim i nxënësve ta vlersojnë përparimin e vet.

## ***2. Aftësimi i nxënësve për të përvetësuar njohuri dhe shkathtësi për veprim të pavarur efikas dhe kreativ në mjedisin shoqëror dhe natyror***

Kjo arrihet përmes:

- përvetsim i njohurive të përgjithshme dhe aplikative që janë të nevojhme në jetën e përditshme të nxënësit;
- përvetsim i njohurive elementare nga lëmia e gjuhës, natyrës, shoqërisë dhe njeriut, përmes lëndëve të ndryhme, edhe atë në mënyrë që do të mundësoj standarde ndërkombëtare për krahasim të njohurive në fund të shkollimit fillor.
- Nxitja e kureshtjes intelektuale, ndjenja për të bukurën dhe fryma hulumtuuese të nxënësit;
- Nxitje për kreativitet dhe aftësi për shprehje në lëminë e muzikës, artit figurativ dhe llojve të tjerë të artit;
- Krijimi i kushteve për zhvillim të nxënësve të talentuar dhe për përkrahje dhe zhvillim të fëmijëve me nevoja nevoja të veçanta arsimore;

## ***3. Ngritja e vetëdijes qytetare të nxënësit për përkatësi të Republikës së Maqedonisë dhe kultivim i identitetit nacional dhe kulturor në frymën e respektimit të njerëzve pa dallim nga përkatësia e tyre sociale, kulturor, gjinore dhe fetare dhe aftësitë fizike dhe mentale***

Kjo arrihet përmes:

- zhvillim i aftësive të nxënësve për të kuptuar, informim dhe shprehje në gjuhën maqedonase, kurse në mjediset të cilat janë dy ose më shumë gjuhësore – në maqedonisht dhe në shqip, gjegjësisht turqisht, sërbsisht dhe gjuhë të tjera;
- njoftim me të kaluarën dhe traditën kulturore të popullit maqedon dhe të kaluarën, dhe traditat kulturore të bashkësive në RM, traditën dhe shtetërimin e Maqedonisë.
- Të mësuarit e gjuhëve të huaja dhe aftësimi për komunikim dhe njoftim me kulturat tjera dhe me të arriturat e popujve të tjerë në botë;
- Promovim të parimeve për barazi mes njerëzve, pa dallim nga origjina ose përcaktimi i tyre;
- Promovimi i rëndësisë së sjelljes tolerante, solidaritet dhe aftësim për zgjidhje të konflikteve pa dhunë.

#### **4. Zhvillimi i vetëdijes dhe kujdesit tek nxënësit për shëndetin personal dhe për rëndësinë e mjedisit të shëndoshë.**

Kjo arrihet përmes:

- përparimi i mënyrës së shëndoshë të jetesës dhe edukimit të nxënësve për ndërmarrje të përgjegjësive për shëndetin e vet dhe për ruajtjen e mjedisit dhe të natyrës;

- krijim i klimës së volitshme në shkollë dhe kushteve për siguri fizike dhe psikike të nxënësit në shkollë.

#### *IV. ORGANIZIMI I MËSIMIT NË SHKOLLË FILLORE*

Viti përgatitor në shkollat fillore i bashkangjitet planit mësimor për shkollë fillore ku zhvillohet strukturë e re që ngërthen tri periudha edukativo-arsimore. Çdo periudhë paraqet tërësi relativisht të rrumbulaksuar sa i përket karakteristikave zhvillimore të fëmijëve dhe ligjve të nxënies si dhe sipas mënyrës së notimit të arritjes së nxënësve, format e mësimit të individualizuar dhe mësimit grupor, nivelet e njohurive dhe shkathtësive dhe përparimi i nxënësve. Me organizimin e propozuar të mësimit, pa marrë parasysh specifikat e secilës periudhë, krijohen mundësi të shumta tek nxënësit për zgjerim të vazhdueshëm të sistemit të njohurive dhe shkathtësive.

Propozimi ka të bëjë edhe me specifikat tjera në organizimin e mësimit meqë përveç arsimtarit klasor për realizimin e mësimit në disa lëndë do të angazhohen edhe arsimtarë lëndorë. Këto ndryshime përpunohen qartë me planin dhe programin

mësimor për të tri periudhat zhvillimore të nxënësve prej klasës së I deri të III; prej të IV deri të VI dhe prej VII deri të IX klasë me çka lehtësohet kalimi prej mësimit klasor në lëndor. Lidhshmëria në mes tri periudhave edukativo-arsimore dhe përparimi i nxënësve prej periudhës së parë kur moshë mesatare prej gjashtë, shtatë dhe tet vjet; dhe në periudhën e tretë me moshë mesatare dymbëdhjetë, trembëdhjetë, dhe katërbëdhejtë vjet, përputhet me nivelet zhvillimore që janë të përpunuara sipas teorive të zhvillimit kognitiv dhe socioemocional të fëmijëve. (Shiko shtojcën – literaturë relevante).

Me këto, kryesisht theksohen elementet më subtile në mësim dhe mësim-nxënie, nxënësit në mënyrë aktive të kërkojnë informata dhe ta kontrollojnë besueshmërinë e tyre, ta lidhin përvojën shkencore me përvojën personale, t'i këmbëjnë njohuritë e tyre me të tjerët, të gjejnë zgjidhje të reja për probleme të paramenduara, t'i kontrollojnë raportet shkakoro-pësore të dukurive kontrolluese, të marrin përgjegjësi për mësimin personal, të bashkëpunojnë me nxënësit tjerë në shkollë, të përgatiten për jetë në mjedis social dhe të bëhen lojal ndaj konceptit për mësimin e përgjeshëm.

Për këtë arsye vendimet e propozuara implikojnë organizim tjetër të mësimit, ndërsa arsimtarët merrin përgjegjësi që të krijohet atmosferë në klasë me çka do të nxisë interaksion të hapur dhe me përgjegjësi (mësimi nuk zhvillohet me bartjen e njohurive, por në procesin mësimor duhet të krijohen kushte për komunikim, arsimtarët t'i nxisin nxënësit të parashtrojnë pyetje, të kërkojnë përgjigje dhe t'i ndajnë mendimet në grup edhe me nxënësit dhe arsimtarët

Këto ndryshime në mënyrë më të qartë janë të sqaruara në planin mësimor dhe programet prej I-III; IV-VI dhe VII-IX me çka lehtësohet kalimi prej mësimiit klasor në atë lëndor.

Në të tri periudhat duhet të ndryshohet roli i arsimtari, pasi që duhet të jetë mediatorë mes nxënësve dhe atë që do ta mësojnë ata të gjejë zbatim në jetën e përditshme. Roli i tij është të demostroj, përkrah, trimëroj, të këshilloj dhe sqaroj në ato kushte kur nxënësit prej tij do të kërkojnë ndihmë. Roli i arsimtarit ndryshohet në marrdhënie me notimin pasi që në mësim është e nevojshme nxënësit vazhdimisht të aftësohen për vetënotim, si dhe për notim të njohurive dhe aktiviteteve të nxënësve në grup dhe në paralele.

### **Fillimi i shkollimit**

Në shkollë fillore regjistrohen të gjithë fëmijët që do të mbushin 6 vjet deri në fund të vitit kalendarik të regjistrimit në shkollë.

Sipas kësaj, në shkollë fillore në fillim të vitit shkollor do të ketë fëmijë me 5 vjet e 8 muaj dhe më prej 6 vjet e 8 muaj. Nëqoftëse ekzistojnë mendime profesionale fëmija regjistrimin mund ta anuloj për një vit. Gjatë regjistrimit të fëmijëve në klasë të I nuk bëhet përzgjedhje, kurse shërbimi profesional, komisioni i cili e bën regjistrimin e fëmijëve i përbërë nga pedagogu, psikologu dhe arsimtari për edukim parashkollor ose për mësim klasor duhet të sigurojë hapsirë të përshtatur për bisedë me prindërit për grumbullimin e të dhënave për zhvillimin e fëmijës, gjendjen shëndetësore (sëmundje kronike, alergji, të pamurit e dëmtuar, të folurit, qëndrimin paraprak në kopsh etj.), si dhe për interesat e veçanta të fëmijëve. Mandej, komisioni zhvillon biseda spontane me fëmijët dhe e përcjell komunikimin e tyre në mes veti. Gjatë bisedës me fëmijët vëmendje të posaçme i kushtohet karakteristikave në të folurit e fëmijës, shkathtësive të tyre për komunikim, kureshtje, kreativiteti, përvoja e tyre nga kopshti, familja etj.

Anëtarët e komisionit mbajnë shënime për të dhënat më të rëndësishme të marrura nga prindërit dhe nga biseda me fëmijët. Këto informata shërbejnë në punën e mëtejshme me fëmijët në shkollë.

Punëtorët profesional në shkollë dhe kopshte do t'i ndjekin fëmijët në grupet në klasën e I në shkollë fillore që të mundet vazhdimisht t'u japin ndihmë profesionale këshilldhënëse prindërve, edukatorëve dhe arsimtarëve.

Regjistrimi i nxënësve në shkollë fillore duhet të organizohet në përputhje me kushtet në shkollë. Duke e pasur parasysh rrjetin e tanishëm të kopshteve publike fëmijërore dhe shkollave fillore në kuadër të komunave duhet të kërkohen ato zgjidhje që janë më të volitshme, psh, nxënësit në klasë të I mund të kenë hapsira në kopshte apo në shkolla me qëllim që në mënyrë optimale të shfrytëzohet kuadri mësimor ekzistues, lokali dhe pajisja.

Aktivitet jashtë mësimiit të rregullt gjithashtu mund të organizohen me qëndrim tërëditor në shkolla ose në kopshte dhe në atë mënyrë ato të jenë nën kujdes sipas nevojë së familjes. Zgjidhje të njejta për organizimin e mësimiit dhe aktivitetet jashtëshkollore me fëmijët e kësaj moshe ka edhe në shkollat dhe kopshtet në vendet tjera (psh., në Slloveni, Danimarkë, Suedi, Gjermani, Francë etj.)

Për fillim të suksesshëm të mësimiit duhet të përgatiten programet mësimore për klasën e I – rë dhe për dy klasat tjera të ardhëshme. Përveç kësaj, në pajtueshmëri me qëllimet duhet të rregullohen dhe të pajisen lokalet në shkolla dhe në kopshte sipas standardeve për punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës gjashtëvjeçare.

Ndryshimet kanë për qëllim që aktivitetet jashtëmësimore me fëmijët e klasës së I të mbahet kuadri ekzistues. Arsimitari i mësimit klasor i cili do të fillojë të punojë me nxënësit e klasës së I do të vazhdojë të punojë me nxënësit në paralelen deri në klasën e III, gjegjësisht edhe në klasën e IV edhe të V. Gjithashtu, mësimin në klasën e I mund ta mbajë arsimtari për edukimin parashkollor. Arsimitarët e edukimit parashkollor të cilët zhvillojnë mësim në klasën e I në arsimin fillor nëntëvjeçar do të jenë të angazhuar tërë kohën që të punojnë vetëm me nxënësit e klasës së I. Pastaj nxënësit në paralelen e njëjtë në klasën e II do t'i udhëheq arsimtari i mësimit klasor. Arsimitarët e edukimit parashkollor dhe arsimtarët klasor duhet të aftësohen për planifikimin dhe realizimin e mësimit me fëmijët e moshës së hershme shkollore.

### **Periudha e parë e mësimit prej klasës së I deri në klasën e III**

Me konceptin e ri për arsimin fillor nëntëvjeçar rëndësi të madhe kanë edhe zgjidhjet e reja sistematike në shkollimin e nxënësve. Karakteristike është ajo që në tre vitet e para mësimi dhe llojet e tjera të punës edukativo-arsimore me nxënësit janë të sistematizuara dhe paraqesin një tërësi themelore. Gjegjësisht, në klasë të parë zhvillimi i nivelit paraoperativ të të menduarit tek fëmijët kalon kah niveli i operacioneve konkrete. Megjithatë këto ndryshime nuk ndodhin tek të gjithë nxënësit njëkohësisht dhe njësoj, por vazhdojnë edhe në klasë të dytë dhe të tretë të shkollimit fillor.

Prandaj me programet mësimore në shkollën e re nuk duhet të kërkojmë nga të gjithë nxënësit që në të njetën kohë ti arrijnë standardet e njohurive për lexim, shkrim dhe llogaritje deri në fund të mësimit në klasë të parë, por ato planifikohen duke i pasur parasysh dallimet individuale që nxënësit t'i arrijnë tërësisht edhe në fund të klasës së III-të. Prandaj me konceptin e ri për mësimin nxënësit kanë kohë të mjaftueshme që ta sistematizojnë përvojën dhe njohuritë e tyre dhe të përfitojnë njohuri të reja. Porosia kryesore është që nxënësit të mësojnë nga përvoja personale, t'iu mundësojë vetë të eksperimentojnë, të përdorin sende, të parashtrojnë pyetje, të kërkojnë përgjigje nga zbulimet e tyre t'i krahasojnë me zbulimet e fëmijëve të tjerë.

Me këtë qasje në planifikimin dhe organizimin e mësimit jepet mjaft kohë për përvetësim të përvojave dhe njohurive të reja për çdo nxënës dhe shumë më shumë mundësi arsimtarët t'i përkushtohen dallimeve individuale në procesin e të mësuarit për çdo nxënës në paralele.

Përvojat dhe njohuritë e nxënësve në periudhën prej moshës 6 deri më 9-të ka rëndësi themelore për zhvillimin e tyre të mëtejshëm në shkollimin fillor.

### **Periudha e dytë prej klasës së IV deri VI – të**

Në moshën nëntëvjeçare, gjegjësisht, nxënësit e klasës së katërt në shkollimin e ri paraqitet nevoja që të vazhdoj procesi i përvetësimit të vazhdueshëm të përvojës dhe zhvillimit të ri të aftësive të tyre për mendimin që është më pak i varur nga përvoja konkrete. Operacionet ideore tek nxënësit mund të zhvillohen në mënyrë reverzibile në drejtim të kundërt me të ash.q. „internacionalizim“ i operacioneve, e kjo tregon se nuk duhet edhe më tej t'i zgjidh problemet vetëm me metodën e përpjekjes dhe gabimeve, por të përparojë me zhvillimin e aftësive për konzervim. Këto njohuri tregojnë se është e nevojshme që në këtë stadium nxënësit të nxiten me intuitë dhe në mënyrë konkrete të përvetësojnë dhe kuptojnë ide themelore në sferën e matematikës dhe natyrës. Kjo

tenton që të vendosen qëllime zhvillimore që do të paraqesin dhe rezultate të pritura në klasën e IV, V dhe VI në shkollë fillore.

Me qëllimet, përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore është e domosdoshme zhvillimi i të menduarit të fëmija të shkojë kah stadiumi me të cilin do të mund pavarësisht t'i paramendojë operacionet, t'i anticipoj rezultatet dhe mbi të gjitha të shërbehet për sistemet për klasifikim. Më konkretisht, nxënësi mund të bëjë aktivitet ideor me operacione logjike të komplikuar në shkallë më të lartë (klasifikim, grupim dhe krahasim) etj. Karakteristik e veçantë për këtë moshë është ajo që të menduarit e fëmijës mund të jetë e pavarur nga elementet perceptuese të njohurisë që d.t.th. se fëmija di t'i klasifikojë gjërat në grupin ku bëjnë pjesë dhënë sende, t'i grupojë sipas kategorive dhe rangut të njejtë.

Këto njohuri kanë për qëllim që të përgatiten programe të reja mësimore dhe me këto duhet patur kujdes më të madh që nxënësit të përvetësojnë sistem të njohurive, të përputhen qëllimet, përmbajtjet dhe metodat mësimore në mësim për nxitjen e zhvillimit intelektual të fëmijëve.

Arsimtarët duhet të udhëzohen që fëmija në këtë periudhë të zhvillimit nuk është çdoherë në gjendje të mendojë vetëm në nivel abstrakt.

### **Periudha përfundimtare prej klasës VII deri të IX**

Mosha mesatare e nxënësve në periudhën prej klasës së VII deri më IX, gjatësisht prej 11 deri më 14 vjet, imponon që të vendosen qëllime zhvillimore dhe të zgjedhen përmbajtje dhe metoda me të cilat do të nxitet zhvillimi i aftësive për mendim abstrak – logjik.

Nxënësit në këtë moshë janë në gjendje të paraqesin konkluzione në bazë të mendimit deduktiv, të japin sqarime dhe interpretime, hipoteza. Mendimi i tyre është fleksibil. Ata përdorin metoda të përcaktimit të tyre kauzale si dhe të përdorin gjykime hipotetike dhe deduktive të llojit „nëse..... atëherë...“ etj.

Njohuritë e theksuara për zhvillimin e nxënësve janë të pranueshme nga aderuesit e mësimin interaktiv dhe metodave të mësimnxënies aktive ku me këtë nënkuptohet se programi i plotë mësimor dhe metodat e mësimin dhe mësimnxënies të bazohen në zhvillimin e arftësive dhe në strukturën e të menduarit të nxënësve për t'u mundësuar nxitje dhe zhvillim në aftësitë e tyre intelektuale.

Në veçanti njohuritë teorike tregojnë se çdo kush që e organizon procesin mësimor dhe që merr pjesë në të duhet të kujdeset për moshën dhe karakteristikat individuale në zhvillimin e nxënësve.

### **Arsimi fillor për të rriturit**

Sipas rregullës, nxënësit në shkollë fillore të cilët pa sukses do ta mbarojnë klasën e IX në afatin e paraparë me ligj kanë mundësi të përfshihen në arsimin fillor për të rritur, e mandej të regjistrohen në programet e arsimit të mesëm. Për këtë lloj arsimimi do të hartohen programe mësimore dhe kushte tjera. Kjo zgjidhje është më e përshtatshme për nxënësit të cilët përparojnë më ngadal në shkollë.

### **Plani për mësim në vitin shkollor**

Në një vit shkollor sipas konceptit të ri, mësimi në shkollë fillore zgjat 38 javë, gjegjësisht 180 ditë pune shkollore. Që të arrihen këto ditë pune programi vjetor i shkollës është përcaktuar në tre tremujorë me dy pushime më të shkurtëra për nxënësit.

- Tremujori i parë zgjat prej 1 shtatorit deri më 30 nëntor;
- Tremujori i dytë prej 1 dhjetorit deri më 15 mars (duke e inkuadruar edhe pushimin më të shkurtër të nxënësve);
- Tremujori i tretë prej 16 mars deri më 10 qeshor (duke e inkuadruar edhe pushimin e dytë të shkurtër të nxënësve);

Prej 11 qeshorit deri më 1 shtator nxënësit kanë pushim veror.

Deri në miratimin e Ligjit të ri për arsimin fillor ende vazhdon organizimi ekzistues i mësimin në vitin shkollor.

Sipas rregullës, mësimi është i organizuar pesë ditë në javë, ndërsa për ti plotsuar ditët e punës shkollore është e nevojshme që gjatë vitit shkollor shkolla fillore të planifikojë nga disa ditë për aktivitetet e nxënësve nga lëmia e sportit, kulturës, teknikës, teknologjisë, ekologjisë etj. Orët mësimore zgjasin 45 minuta. Për nxënësit e moshës së hershme shkollore orët mund të zgjasin në mënyrë më fleksibile sipas qëllimeve të planifikuara.

Obligimet e nxënësve rriten gradualisht sipas lëndëve obligative nga periudha e parë, në klasën e I e deri në periudhën përfundimtare në klasën IX.

- Në periudhën e parë të mësimin nxënësit për lëndët obligative kanë nga 20 orë në klasë të I – të deri 22 orë në klasë të tretë; në periudhën e dytë prej 25 orë mësimore në klasë të IV deri më 27 orë në klasë të VI; dhe në periudhën përfundimtare prej 27 orë mësimore në klasë të VII-të deri më 31 orë në klasë të IX.

## *V. PLANIFIKIMI I MËSIMIT*

Me planin mësimor dhe programet mësimore të shkollave fillore janë përcaktuar lëndët e detyrueshme, orari i tyre sipas lëndëve dhe fondi javor dhe vjetor i orëve për nxënësit.

Lëndët zgjedhore, gjithashtu janë të planifikuara sipas klasave me fondin e orëve, rregullat për përcaktimin e nxënësve për lëndët zgjedhore, numri i nxënësve në grupet arsimore dhe obligimet e nxënësve për këto lëndë.

Shkolla ka për obligim që rregullisht të planifikojë dhe organizojë ndihmë për nxënësit me probleme në mësim me përcaktim të ditëve dhe orëve, si dhe për orët plotësuese dhe shtuese. Pjesë përbërëse e planit është koha për orën e kujdestarisë.

Është e domosdoshme t'iu ofroni prindërve dhe nxënësve program të zgjeruar që përfshin:

- qëndrim tërditorë ose të vazhdueshëm të nxënësve në shkollë.
- aktivitete të lira nga lëmia e kulturës, gjuhës, shkencave shoqërore, matematikës dhe lëndëve natyrore, sportit, teknikës, teknologjisë etj.

Për nxënësit prej klasës së VII, VIII dhe IX shkolla ka për obligim t'iu ofroj nxënësve të ndjekin mësimin në grupet me nxënësit (nga klasa e njejtë nga paralele të ndryshme) me njohuri dhe aftësi të ngjajshme që kanë interes të përfitojnë njohuri që i tejkalon standardet sipas lëndëve të veçanta.

Shkolla në mënyrë të domosdoshme i planifikon ditët dhe kohën për vizitën e prindërve në shkollë dhe për bisedë me arsimtarin.

Shkolla sipas programit të punës në pajtim me prindërit e nxënësve mund të organizon edhe mësim në natyrë.

Të gjitha elementet e përmendura përfshihen në planin mësimor, si dhe në sqarimin për zbatimin e tij. Më konkretisht, drejtimet didaktike për mësim janë përpunuar në programin mësimor sipas lëndëve dhe njësive të veçanta.



**PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR PREJ KLASËS SË I- IX**

Lëndët mësimore <sup>1</sup> Lëndët e detyrueshme	klasa																	
	I		II		III		IV		V		VI		VII		VIII		IX	
- Gjuhë maqedonishte	6	216	6	216	6	216	5	180	5	144	4	144	4	144	4	144	4	144
- Për nxënësit e bashkësive tjera gjuha e tyre amtare, shqipe, turke, serbe	-		-		-		2	72	2	72	3	108	3	108	2	72	2	72
- Gjuhë maqedonishte për nxënësit e bashkësive tjera																		
- Matematikë	4	144	4	144	4	144	4	144	4	144	4	144	4	144	4	144	4	144
- Gjuhë angleze	1	36	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72	3	108	3	108
- Gjuhë e dytë e huaj	-		-		-		-		-		2	72	2	72	2	72	2	72
- Arsimit figurativ	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72	1	36	1	36	1	36	1	36
- Arsimit muzikor	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72	1	36	1	36	1	36	1	36
- Njohja e mjedisit	2	72	3	108	3	108	-		-		-		-		-		-	
- Arsimit teknik <sup>2</sup>	-		-		-		1	36	2	72	-		-		-		-	
- Informatikë	-		-		-		-		-		2	72	1	36	-		-	
- Shoqëri	-		-		-		2	72	2	72	-		-		-		-	
- Gjeografi	-		-		-		-		-		-		2	72	2	72	2	72
- Histori	-		-		-		-		-		2	72	2	72	2	72	2	72
- Arsimit qytetar	-		-		-		-		-		-		-		1	36	1	36
- Natyrë	-		-		-		2	72	-		-		-		-		-	
- Shkencat natyrore	-		-		-		-		2	72	-		-		-		-	
- Shkencat natyrore dhe teknika	-		-		-		-		-		3	108	-		-		-	
- Biologji	-		-		-		-		-		-		2	72	2	72	2	72
- Fizik	-		-		-		-		-		-		-		2	72	2	72
- Kimi	-		-		-		-		-		-		-		2	72	2	72
- Arsimit fizik dhe shëndetësor	3	108	3	108	3	108	3	108	3	108	3	108	3	108	3	108	3	108

- Gjithsej orët	20	720	22	792	22	792	23(25)	828 (900)	24(26)	864 (936)	24(27)	864 (972)	24(27)	864 (972)	29(31)	1044 1116	29(31)	1044 1116
- Numri i lëndëve	7		7		7		9(10)		9(10)		10(11)		11(12)		13(14)		13(14)	
- Lëndët zgjedhore <sup>3</sup>																		
- Gjuha dhe kultura e vlllehëve <sup>4</sup>	-		-		1	36	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72
- Gjuha dhe kultura e romëve <sup>4</sup>	-		-		1	36	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72	2	72

<sup>1</sup> Ky plan mësimor realizohet edhe në paralelet me mësim në gjuhën shqipe, turke dhe serbe.

<sup>2</sup> Punë me letër, tekstil dhe dru.

<sup>3</sup> Nxënësi në klasë të njëjtë mund të zgjedh më së paku një, kurse mund të përcaktohet, për dy lëndë varësisht nga interesimi dhe në pajtueshmëri me prindin.

<sup>4</sup> Nxënësit që do t'i zgjedhin këto lëndë i mësojnë në mënyrë të vazhdueshme me nga dy orë në javë.

<sup>5</sup> Lëndën *Njohja e religjioneve* ose *Etikë* nxënësi mund ta zgjedh në klasën e VI ose VII, gjegjësisht mund ta mësojë në të dyja klasat.

<sup>6</sup> Shkolla iu ofron nxënësve listë të lëndëve zgjedhore në pajtim me planin mësimor: *mësim të përforcuar të gjuhëve të huaja, atdheu ynë, edukimi për mjedisin, hulumtime në vendlindje, vallëzim dhe valle popullore, projekte nga arti muzikor ose ai figurativ, arsim teknik, projekte nga informatika, sport zgjedhor, përparimi i shëndetit, kulturë klasike në civilizimin evropian dhe shkathtësi për jetë.*

<sup>7</sup> Planifikohen punë e: korit muzikor, prej 2 deri 5 orë në javë (varësisht nga zhvillimi i korrit), gjegjësisht prej 72 deri 180 orë në vit; orkestri i shkollës prej 2 deri 4 orë në javë (varësisht nga zhvillimi i orkestrit), gjegjësisht prej 72 deri 144 orë në vit.

Me programin vjetor të shkollës mund të planifikohen dy deri tri ditë gjatë vitit mësimor për aktivitetet e nxënësve nga lëmia e sportit, kulturës, ekologjisë, teknikës etj.

## **Karakteristikat themelore në mësim**

Me mësimin në shkollë fillore realizohen qëllimet themelore edukativo-arsimore. Mësimi planifikohet dhe zbatohet sipas programeve për lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore, sipas klasave, sipas planit mësimor për shkollë fillore.

Mësimi paraqet bazë për plotësimin e rezultateve të pritura në arsimin dhe edukimin fillor, me çka mundësohet kalim vertikal në shkollë të mesme. Lëndët e detyrueshme në shkollë fillore janë nga lëmia e: gjuhës dhe letërsisë, gjuhëve të huaja, shkencave shoqërore, matematikës, shkencave natyrore, biologjisë, fizikës dhe kimisë, arsimit qytetar dhe informatikës, artet dhe arsimit fizik dhe shëndetësor.

Me lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore në procesin mësimor krijohen mundësi për zbatimin e punës së individualizuar dhe grupore në mësimin sipas lëndëve të veçanta mësimore. Në këtë mënyrë është e nevojshme që nxënësve t'iu mundësohet që të përcaktohen edhe për detyra më të komplikuar, të plotësojnë kërkesa më të larta varësisht nga interesat e tyre, rezultatet dhe planet e arritura për arsimin e mëtejshëm. Në veçanti kjo mënyrë e organizimit të mësimin t'iu jep mundësi që të arrijnë rezultat edhe ata nxënës të cilët kanë vështirësi dhe të cilët përparojnë më ngadal në mësim.

## **Lëndët e detyrueshme**

Në shkollë fillore mësimi sipas të gjitha lëndëve zhvillohet në gjuhën maqedonishte, shqipe, turke dhe serbe. Në periudhën e parë zhvillimore në mësim prej klasës së I –III obligative janë këto lëndë: gjuha maqedonishte, gjegjësisht gjuhë shqipe, turke dhe serbe, matematikë, gjuhë angleze, arsim figurativ, arsim muzikor, njohja e mjedisit dhe edukim fizik dhe shëndetësor. Nxënësit prej klasës së I deri III mësojnë 7 lëndë.

Lëndët e detyrueshme në arsimin figurativ, arsimin muzikor dhe në arsimin shëndetësor do të mundësojnë forma më fleksibile të punës mësimore varësisht nga kushtet në shkollë. Me këto duhet tju mundësohet aktivitete nxënësve që janë të thelluar me punë kreative dhe hulumtuese dhe duhet të paraqesin kënaqësi për nxënësit.

Në periudhën e dytë prej klasës së IV-VI janë: gjuha maqedonishte, gjegjësisht gjuha shqipe, turke dhe serbe; gjuha maqedonishte për nxënësit e bashkësive të tjera, matematikë, gjuhë angleze, gjuhë e dytë e huaj, arsim figurativ, arsim muzikor, shoqëri, histori, arsimit teknik, informatikë, natyrë, shkencat natyrore dhe teknikë, shkencë natyrore dhe teknikë, arsimit fizik dhe shëndetësor. Përmbajtjet për arsimin teknik programohen në mësimin e njohjes së mjedisit në lëndën zgjedhore *krijimtari* që mësohet në klasën e IV dhe V si dhe në lëndën zgjedhore arsimit teknik në periudhën përfundimtare në arsimin fillor nëntëvjeçar. Në klasë të IV dhe V nxënësit mësojnë 10 lëndë ndërsa në klasën e VI 11 lëndë.

Në periudhën e parë dhe të dytë, lëndët mësimore mund të lidhen dhe shoqërohen në njësi lëndësh (p.sh., në lëndët njohja e mjedisit, shoqëria me përmbajtje nga biologjia, fizika, kimia, gjeografia ose mund të formohen lëmi për artet etj.) Me çrast janë ruajtur krijimi profesional dhe shkencor i përmbajtjeve, karakteristikave zhvillimore të nxënësve në disa periudha të zhvillimit, si dhe metodave dhe formave të mësimin dhe mësimnxënies.

Në lëndën mësimore arsimit fizik dhe shëndetësor prej klasës së I deri të V, arsimtari është i detyrueshëm 25% nga fondi i përgjithshëm i orëve të ndajë për përmbajtjet për arsimin shëndetësor, të cilët do të jenë edhe pjesë përbërëse e programit mësimor, si psh, përmbajtje për ballafaqim me stres, përmbajtje që janë të lidhura me sfidat e përditshmërisë, edukimi seksual, zgjidhja e konflikteve etj.), me të cilët do të realizohen përfitimet pozitive për zhvillimin e kompetencave sociale, emocionale dhe bihevioriste të nxënësve. Që të realizohet qëllimi, njohuritë dhe shkathtësitë duhet të zbulohen dhe praktikohen në jetën e shkollës duke shfrytëzuar metodologjinë e cila është e orientuar kah fëmija, interaktive dhe participuese. Këto përmbajtje është e nevojshme të implementohen në mësim edhe në klasët më të larta.

Në periudhën përfundimtare prej klasës së VII deri të IX të detyrueshme janë këto lëndë: gjuha maqedonishte, gjeogjisht shqipe, turke, serbe, gjuha maqedonishte për nxënësit e bashkësive të tjera, matematikë, gjuhë angleze, gjuha e dytë e huaj, arsimit figurativ, arsimit muzikor, gjeografi, histori, arsimit qytetar, informatik, biologji, fizik, kimi dhe arsimit fizik dhe shëndetësor. Në klasën e VII nxënësit kanë 12 kurse në klasën e VIII dhe IX nga 14 lëndë, përderisa numri i orëve është në kuadër të standardeve për arsimin në vendet e Unionit Evropian (prej 27 deri në 31 orë).

Gjatë përgatitjes së programeve mësimore prej klasës së I deri të IX duhet të mbahet llogari për shfrytëzimin optimal të teknologjisë informatike në mësim dhe të mësuar.

Për mësimin e gjuhës angleze prej klasës së I angazhohet arsimtar lëndor, kurse gjithashtu edhe për mësimin e shkencave natyrore në klasën e V dhe VI angazhohen arsimtarë të biologjisë, gjeografisë, fizikës dhe kimis. Në qoftë se shkolla ka mundësi mund të angazhojë arsimtarë lëndor për mësimin e arsimit muzikor dhe artistik si dhe për mësimin e arsimit teknik në klasën V.

Gjatë kësaj duhet të mbahet llogari që fondi i orëve të arsimitarit klasor në lëndët e detyrueshme në klasën e V të mos jetë më i vogël se 17 orë.

Në të gjitha lëndët e detyrueshme duke filluar prej klasës së VI ka arsimtarë lëndor. Me këtë mundësohet kalim më i lehtë prej mëimit klasor në mësimin lëndor.

Për shkak të lidhshmërisë më efektive të lëndëve dhe disiplinave është e domosdoshme që të përdoret praktika për planifikim ekipor të mëimit. Për këtë arsye paraqitet nevoja që të përgatitet plan për trajnimin e arsimtarëve që do të jetë në përputhje me fazat e vendosjes së ndryshimeve në shkollën fillore nëntëvjeçare. Për arsimtarët e periudhës trevjeçare duhet të përgatiten module të veçanta arsimore në të cilat do të përfshihen specifikat në mësim të cilat dalin nga inkuadrimi i hershëm i fëmijëve në shkollë.

Shkolla në përputhje me prindërit e nxënësve mund të planifikojë përkrahje adekuate profesionale për arsimtarët klasor edhe në realizimin e përmbajtjeve të veçanta mësimore nga sfera e arsimit fizik dhe shëndetësor, arsimit muzikor dhe figurativ, si dhe në lëndët tjera me angazhim të arsimtarëve lëndor në shkollë, prindërit edhe personat tjerë profesional të cilët kanë kompetenca në sferat e theksuara. Gjatë kësaj arsimtari klasor është përgjegjës për mësimin e tërësishëm në paralele. Aktivitetet e theksuara janë pjesë përbërëse e fondit të orëve të arsimitarit klasor.

## **Lëndët zgjedhore**

Varësisht nga interesimet e nxënësve secili nxënës mund të mësojë lëndë zgjedhore. Ato dedikohen për plotësimin e njohurive, pasurimin dhe sistematizimin e përvojave në lëmi të ndryshme, për lidhshmërinë e njohurive teorike dhe aktivitetet praktike, si dhe zbulimin e intersimit të nxënësve për profesionet dhe drejtimet. Ndaj kësaj janë përshtatur edhe metodat e punës: grumbullimi i përvojave nga aktivitetet hulumtuese në mësim dhe në vende të tjera në mjedis, puna laboratorike dhe eksperimentale, vëzhgimi i pavarur ose i orientuar, puna me projekte etj.

Me lëndët zgjedhore nuk ndryshohen lëndët e detyrueshme bazë, si psh. matematika, historia, biologjia, kimia dhe fizika etj. Por me këto u jepen mundësi nxënësve që t'i zgjerojnë dhe thellojnë përvojat dhe njohuritë e tyre. Me përmbajtjen e pasur dhe të llojllojshme të lëndëve zgjedhore puna në shkollë bëhet më tërheqëse dhe më interesante për nxënësit që në klasën e katërt deri në fund të shkollimit.

## **Përcaktimi i nxënësit për lëndët zgjedhore**

Lëndët zgjedhore që i ofron shkolla e që janë tërheqëse dhe i interesojnë nxënësit mund t'i zgjedh që nga klasa e III, kurse sipas rregullës nga klasa e IV. Në qoftë se ndodh që të mos ketë interesim për lëndë të caktuar që e adhuron nxënësi, atëherë mund të përcaktohet për atë lëndë për të cilën janë paraqitur më së paku 15 nxënës. Nxënësi në vitet e fundit mund të bëjë ndërrim të lëndës zgjedhore. Lëndët zgjedhore bëhen pjesë e fondit javor të orëve të nxënësit. Nxënësit vlerësohen për të arriturat në mësim dhe mësimnxënie edhe sipas lëndëve zgjedhore, ndërsa notat kanë ndikim në suksesin e përgjithshëm të nxënësit.

Secila shkollë madje edhe shkolla me numër më të vogël të paraleleve, e ka për obligim që nxënësve të klasës së njëjtë t'i ofron së paku tre lëndë zgjedhore. Nxënësit dhe prindërit e tyre me arsimtarin klasor, gjegjësisht udhëheqësin e paraleles duhet të bëjnë zgjedhje të këtyre lëndëve të cilat bëhen pjesë e obligimeve të tyre shkollore. Çdoherë duhet të mbahet llogari që në rradhë të parë të jetë interesimi dhe kujdesi i nxënësve që të mos rritet ngarkesa e tyre me lëndët e detyrueshme dhe ato zgjedhore.

Në përputhje me përcaktimet për respektimin e gjuhëve dhe identitetit kulturor të përkatësive të bashkësive, shkolla prej klasës së III deri të IX nxënësve ju ofron lëndët zgjedhore – *gjuha dhe kultura* e vllahëve, romëve, boshnjakëve. Nxënësit që do t'i kuptojnë këto lëndë mund t'i mësojnë në mënyrë të vazhdueshme deri në klasën e IX me nga 2 orë në javë.

Lëndët njohja e religjioneve dhe etika çdoherë përfshihen në propozimin e shkollës për lëndët zgjedhore që ua ofron nxënësve në klasën e VI dhe VII.

Në mjedise ku jetojnë përkatësi të bashkësive të ndryshme në lëndët zgjedhore mund ta ofrojë gjuhën shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera, sipas programit i cili zhvillohet prej klasës së VI deri të IX me nga dy orë në javë.

Varësisht nga kushtet dhe interesimit të nxënësve prej klasës së VII deri të IX shkolla ju ofron nxënësve edhe lëndë tjera zgjedhore:

a) nga sfera e gjuhëve (përforsimi i mësimin të gjuhës së parë dhe të dytë të huaj);

b) nga lëmia shoqëroro-humanitare lënda (atdheu ynë, me përmbajtje për përforsimin e patriotizmit dhe lojalitetit të Republikës së Maqedonisë

përmes përmbajtjeve për traditën shtetëro-krijuese, të drejtat dhe liritë e qytetarëve, përcaktimi për pranimin e vlerave të UE);

c) nga shkencat natyrore (edukimi i mjedisit ose hulumtimi i vendlindjes), me theks të veçantë aktivitetet hulumtuese për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, si dhe për traditat, zakonet dhe jeta bashkëkohore e qytetarëve në vendlindje);

ç) nga artet (vallëzimi dhe vallet popullore, projekte nga muzika ose arti figurativ);

d) nga informatika dhe teknika (arsimi teknik ose projekte nga informatika);

dh) nga lëmia e sportit (sport zgjedhor ose përparimi i shëndetit);

e) të mësuarit elementar të kulturës klasike si bazë e civilizimit evropian (kultura klasike në civilizimin evropian);

f) lëndë nga lëmia e shkathtësive për jetesë (me qëllim që të sigurohet balans në mes njohurive dhe shkathtësive që duhet t'i arrijnë nxënësit dhe të mundësohet afrimi i njohurive të arritura ndaj realitetit të përditshëm, si dhe pjesërisht të përshtatet kurrikulumit ndaj nevojave të bashkësisë lokale). Përmes këtyre lëndëve nxënësit aftësohen për arritjen e shkathtësive konkrete për përditshmërinë edhe atë në mjedisin e drejtpërdrejt të tyre – shembull, nëse nxënësit jetojnë në mjedis rural, do të kultivojnë kultura të ndryshme, nëse janë në vend turistik do të përpunojnë zbukurime, pastaj mund të fitojnë shkathtësi si p.sh. të gatujnë bukë, të bëjnë ëmbëlsira, përpunimin me dorë të zbukurimeve atj. Shkolla i përfshinë ato lëndë sipas mesatares për atë se cila do të ishte nevoja më adekuate e nxënësve në marrëveshje me nxënësit dhe bashkësinë lokale.

Nxënësi sipas planit mësimor në të njëjtën klasë mund të zgjedhë së paku një lëndë, kurse mund të përcaktohet edhe për dy lëndë varësisht nga interesi edhe në përputhje me prindërit.

Lëndët zgjedhore nga alinea **a)** deri në në aline **zh)** mësohen me nga 2 orë në javë në klasën e VII, VIII dhe IX.

Mësimi sipas lëndëve zgjedhore regullisht planifikohet, organizohet dhe realizohet sipas fondit të paraparë të orëve që është i vërtetuar sipas planit mësimor.

Lënda zgjedhore që do ta zgjedhë nxënësi bëhet i obligueshëm në orarin e tij, ndërsa siç u përmend vlerësohet edhe suksesi i nxënësit.

Byroja e zhvillimit të arsimit do të përgatit programe mësimore për lëndët zgjedhore që do të mbajnë edhe drejtiem didaktiko-metodike për planifikimin dhe realizimin e mësimin në të gjitha shkollat. Përveç kësaj me programet mësimore, si dhe për lëndët e detyrueshme, do të përcaktohen qëllime zhvillimore, përmbajtjet, aktivitetet dhe metodat në mësim, mënyra e vijimit dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve dhe normativat për kuadrin arsimor. Do të përgatitet edhe plan i veçantë për kualifikimet profesionale dhe trajnimi i arsimtarëve për lëndët zgjedhore, të cilët do të jenë në përputhje me fazat e ndryshimeve që do të aplikohen në shkolla.

### ***Obligimet e shkollës për lëndët zgjedhore***

Në pajtim me planin mësimor që është sjellur nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, si dhe me programet mësimore për lëndët zgjedhore në shkolla do të përcaktohen obligimet e arsimtarëve dhe nxënësve për organizimin e mësimin dhe të mësuarit.

Në bazë të anketës që zbatohet ndërmjet nxënësve dhe prindërve udhëheqësia e shkollës siguron informata se sa është interesimi i nxënësve (dhe prindërve) për lëndët zgjedhore. Në këtë mënyrë vërtetohen lëndët zgjedhore për të cilët janë paraqitur numër i konsiderueshëm i nxënësve. Në shkollat ku ka numër të konsiderueshëm të paraleleve për çdo klasë formohen grupe për mësimin e lëndës zgjedhore nësa ka të paraqitur më së paku 15 nxënës. Për lëndë të caktuara zgjedhore kur është interesimi më i vogël ose, në qoftë se në shkollë nuk ka paralele të mjaftueshme për organizimin e mësimin në lëndët zgjedhore me nxënës të klasës së njejtë, atëherë ky mësim mund të organizohet edhe në grupe të kombinuara, gjegjësisht me nxënës të klasave të ndryshme të cilëa punojnë në grupe të njejtë sipas programit të nivelit më të ulët, ndërsa tjerë në nivel më të lartë, që paraqet angazhim më të madh të arsimtarëve.

#### • **Puna e individualizuar dhe puna në grupe në mësim**

Në shkollë fillore prej klasës së I deri të VI nuk praktikohet diferencimi i jashtëm i nxënësve, megjithatë zhvillohen forma të ndryshme didaktike që na shpiejnë kah mësimi i individualizuar dhe në grupe që japin rezultate më të mira në mësimin e secilit nxënës.

Kështu në periudhën e shkollimit të nxënësve prej klasës së IV deri të VI kryesisht do të zhvillohen forma të ndryshme të organizimit të mësimin. Për shembull, për këtë qëllim sistematizohen kombinime të ndryshme të detyrave dhe përmbajtjeve për mësimin sipas niveleve të pajtueshmërisë që realizohen në mësimin e rregullt, ose në orë plotësuese të caktuara sipas mësimin të rregullt nxënësit mund të punojnë në grupe të posaçme (me nxënës me njohuri dhe aftësi të njejtë), veçanërisht për mësimin në gjuhën amtare, matematikë, gjuhë të huaj, si dhe në lëndët zjera sipas interesimit dhe aftësive të nxënësve. Nxënësit, për të cilët mbahet ky lloj mësimi në lëndë të ndryshme, mësimin e rregullt edhe më tej e ndjekin në të gjithë lëndët në paralelen am të tyre.

Në periudhën përfundimtare në klasën e VII deri të IX mund të organizohet, gjithashtu mësim pjesërisht i individualizuar dhe mësim në grupe sipas niveleve të ndërlikueshmërisë në shkollë me nxënës të paraleleve të ndryshme, por nga klasa të njejtë sipas lëndës për të cilën do të përcaktohen nxënësit. Ata nxënës që kanë shprehur njohuri dhe aftësi për lëndë të veçanta, e veçanërisht në gjuhën amtare, matematikë dhe gjuhë të huaj në klasën e VII, VIII dhe IX, mund të shpërndahen në grupe me nxënës me njohuri dhe aftësi të njejtë edhe atë me vëllim më së shumti 25% nga orët e përgjithshme për këto lëndë mësimore të punojnë në grupe sipas programeve me kërkesa të larta. Nxënësit edhe në këto lëndë për orët e pjesës së mbetur të mësimin janë në paralelet amë në klasën e tyre.

Në kriteret për zgjidhjen e nxënësve për formimin e grupeve për mësimin në gjuhën amtare, matematikë, gjuhë të huaj edhe në lëndë të tjera merren rezultatet nga testimi i njohurive të nxënësve me teste të standardizuara që bëhet në mënyrë interne pas mbarimit të klasës së III dhe IV, suksesi sipas lëndëve përkatëse gjatë shkollimit, e veçanërisht në klasën e VI, interesimi, dëshirat e nxënësve dhe pajtueshmëria e prindërve të tyre. Sipas kriterëve të përmendura nxënësit dhe prindërit e tyre sjellin vendim për pjesëmarrjen e nxënësit në mësim që do ta ndjek në grupet me nxënës me njohuri dhe aftësi të ngjajshme nga paralele të ndryshme në klasën e VII, VIII dhe IX.

Nxënësit në grupe mund të qëndrojnë gjatë tërë vitit shkollor ose të tërhiqen nga ky mësim, megjithatë gjatë vitit të njejtë ata nuk mund të kalojnë në grupet e lëndëve tjera.

Përmbajtjet dhe mënyrat e punës për mësimin në grupet me kërkesa më të larta janë përpunuar në programet mësimore sipas lëndëve adekuate në klasën e VII, VIII dhe IX në kapitull të veçantë – Mësim në nivel më të lartë. Zgjedhja e përmbajtjeve për mësimin në këto grupe nuk mund të shpie kah vendosja e profesionit, ndërsa gjithashtu ky lloj mësimi nuk mund të jep mundësi formale të ndryshme për përparimin e nxënësit në shkallë më të lartë të arsimit. Kujdesi për këto nxënës duhet të vazhdojë edhe në shkollat e mesme, me krijimin e mundësive pothuajse të njehta që nxënësit të punojnë në grupe mësimore të posaçme me kërkesa më të larta.

Për mësimin e niveleve më të larta nga aspekti i standardeve, përmbajtjet, qëllimet dhe lidhshmëria e tyre do të përgatitet koncept për planifikimin dhe punën e ekipit të arsimtarëve lëndor që do të angazhohen për këtë lloj mësimi. Ekipet lëndore do të përgatisin plane dhe to ta bashkërendisin punën e grupeve sipas qëllimeve mësimore dhe qëllimet në mësim, si dhe vijimi i rezultateve të nxënësve. Nxënësit do të mundën të vijnë në mësim me kërkesa më të larta nga paralelet e ndryshme në klasën e VII gjegjësisht VIII ose në klasën e IX, ku ju ligjerojnë arsimtarë të ndryshëm. Sipas kësaj do të nevojitet që në secilën shkollë detyrimisht të përgatitet plan për punën ekipore të arsimtarëve me grupet në mësim në nivel më të lartë.

### **Mësimi plotësues**

Mësimi plotësues organizohet për nxënës të cilët ballafaqohen me vështirësi të kohëpaskohshme në mësim dhe të cilët përparojnë më ngadal ose ngecin në përvetësimin e përmbajtjeve dhe detyrat tjera nga një ose më tepër lëndë mësimore. Ngecjet dhe vështirësitë në mësim mund të jenë pasojë nga më shumë shkaqe dhe të paraqiten në më shumë forma dhe në periudha të ndryshme kohore. Për këtë arsye ndihmë përkatëse në formë të mësimi plotësues mund t'i nevojitet një numri të madh nxënësish, e në disa raste edhe çdo nxënësi. Për vendosjen e vlerësimit të saktë dhe në kohë për nevojat e nxënësve (lidhur me ngecjet eventuale ose, mangësitë në mësim dhe në mësimnxënie) përgjegjësi të veçantë kanë arsimtarët klasor dhe lëndor, pedagogët dhe psikologët e shkollës dhe udhëheqësi i paraleles.

Për mësimin plotësues, grupet arsimore formohen në periudha të ndryshme, varësisht nga koha kur paraqiten dobësi të caktuar te disa nxënës. Ky mësim sipas rregullës, organizohet gjatë tërë vitit shkollor, paralelisht me mësimin e rregullt, para ose pas mësimi të rregullt, në kohën e lirë edhe në mënyrë të mësimi të vazhdueshëm në fund të vitit shkollor.

Përmbajtjet për mësimin plotësues dhe mënyra e punës, kryesisht janë specifike për çdo nxënës. Sa i përket kësaj është e nevojshme të zbatohen forma individuale dhe në forma në grupet e punës e nxënësve dhe puna ekipore e arsimtarëve. Për këtë arsye do të përgatitet koncept për programet plotësuese, me çka do të përpunohen qëllimet, përmbajtjet dhe format e punës që do t'i ofrojnë shkolla.



## **Mësimi shtues**

Mësimi shtues organizohet për nxënësit të cilët gjatë mësimit të rregullt arrijnë rezultate mbi mesataren dhe përveç kësaj paraqiten dhe vërtetohen me shkathtësi dhe talent të posaçëm në lëndë të caktuara mësimore. Nga kjo, sipas esencës dhe funksionit, mësimi shtues paraqet kujdes të organizuar dhe punë me nxënësit e talentuar. Edhe ky lloj mësimi në shkollë organizohet gjatë kohës së lirë të nxënësve, sipas përmbajtjeve programore të caktuara dhe varësisht nga kushtet kadrovike dhe të tjera në shkollë.

Identifikimi dhe zgjedhja e nxënësve për inkuadrim në mësimin shtues ka rëndësi qenësore. Identifikimi më i shpeshtë i nxënësve të talentuar bëhet me përcjelljen sistematike dhe vlerësimin e aftësive zhvillimore, të arriturat dhe nevojat e secilit nxënës. Nësa ka nevojë edhe kushte, zbatohen edhe procedura dhe kritere tjera plotësuese për zgjedhjen dhe inkuadrimin e nxënësve në mësimin shtues.

Për zgjedhjen e nxënësve si kritere duhet të përdoren rezultatet nga vlerësimet e të arriturave me testet e standardizuara në klasën e III dhe të IV.

Për organizim të suksesshëm të mësimit shtues është e domosdoshme të definohet roli i arsimtarëve dhe faktorët tjerë në shkollë, vetëqeverisja lokale dhe mjedisi më i gjerë, që të sigurohet bazë profesionale dhe cilësi më e mirë e mësimit shtues për nxënësit e talentuar. Për organizim dhe planifikim më të suksesshëm të mësimit shtues para shkollës vendosen detyra të veçanta për zgjedhjen dhe përgatitjen e mësimit që do të punojnë me nxënësit e talentuar, si dhe për formimin e përkrahjes financiare dhe kushtet tekniko-materiale për zbatimin e mësimit. Për shkollën është me rëndësi se në këtë mësim vjen në shprehje puna e pavarur e nxënësve, puna në grupe të vogla, formimi i sistemit dhe procedurat për aktivitete, zgjidhje problemesh nga natyra teorike dhe praktike, organizimi i debateve, puna në disa projekte, eksperimentimi dhe dëshmitë. Gjithashtu, me rëndësi është që të shqyrtohet përcjellja dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve.

Mësimi shtues realizohet sipas programeve mësimore. Kështu, mësimi për grupin e lëndëve natyrore dhe shoqërore mund të organizohet dhe të zbatohet nga ekipi i arsimtarëve të lëndëve të ngjajshme. Ky lloj mësimi nënkupton planifikim adekuat, organizim, zbatim të mësimit dhe vlerësim të të arriturave në procesin mësimor. Byroja e zhvillimit të arsimit do të përgatit koncept për planifikimin dhe punën e ekipeve të arsimtarëve lëndor që do të jenë të angazhuar për mësimin shtues.

## **Bashkësia e klasës**

Bashkësia e klasës luan rol të madh në organizimin e jetës dhe punës së nxënësve në shkollë fillore. Nxënësit në shkollë fillore organizohen në paralele edhe në klasa dhe më shpesh bashkësitë e nxënësve marrin pjesë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve që paraqiten në paralele të disa arsimtarët dhe nxënës të ndryshëm. Në orët e bashkësisë së klasës së nxënësve përpunohen rregullat për sjelljen e nxënësve dhe arsimtarëve në shkollë, mënyra e punës, përgjegjësitë dhe procedurat e komunikimit me shkollën, përmbajtje për zgjidhjen dhe ballafaqimin me konflikte. Nxënësit dhe arsimtari propozojnë dhe marrin masa për përmirësimin e kushteve për punë, organizojnë mënyra të ndryshme të ndihmës së nxënësve dhe ngjajshëm me atë.

Nxënësit organizohen në bashkësinë e tyre të nxënësve në kuadër të paraleles, duke filluar prej klasës së II deri të IX. Kështu që, puna e bashkësive të nxënësve zhvillohet sipas programeve që i propozojnë nxënësit, prindërit e tyre dhe arsimtari i cili është i detyruar për paralelen. Sipas rregullës, nxënësit nga bashkësia e paraleles zgjedhin përfaqësues të tyre të cilët marrin pjesë në punën e bashkësisë të nxënësve në kuadër të shkollës. Secilin vit shkollor bashkësia e klasës së nxënësve sjell program i cili përmban propozime të bashkësisë së nxënësve nga paralelet dhe organet tjera të shkollës.

Duke pasur parasysh funksionin e veçantë të aktiviteteve të nxënësve në bashkësinë e klasës, udhëheqësi i paraleles me nxënësit mban me nga një orë në javë në kohëzgjatje nga 40 minuta. Kjo periudhë mësimore përfshihet në kuadër të planit mësimor dhe programohet në orarin dhe programin vjetor të shkollës.

### **Programi i zgjeruar i shkollës**

Mësimi në shkollë fillore mund të organizohet në këtë mënyrë që do të mundësojë në raport me organizimin dhe sistematizimin e përmbajtjeve të plotësohet me programe të zgjeruara dhe hollësishme të cilët shkolla detyrimisht duhet tua ofrojë nxënësve (një pjesë e këtyre programeve i financon shteti, ndërsa nxënësit mund t'i zgjedhin, megjithatë ata nuk janë të detyrueshëm). Në programet e zgjeruara të cilat nxënësit mund t'i zgjedhin, megjithatë ata nuk janë të detyrueshëm). Në programet e zgjeruara të cilat shkolla duhet t'ua ofrojë nxënësve janë të përfshirë mundësi të ndryshme.

Shembull, qëndrimi i vazhdueshëm ose mësimi tërëditor u dedikohet nxënësve prej klasës së I deri të VI. Ata qëndrojnë në shkollë pas orëve të rregullta ku përkujdesen sipas nevojave të familjes. Për këto nxënës organizohen aktivitete të ndryshme: nxënësit i përgatitin detyrat e shtëpisë, ose plotësojnë obligime tjera shkollore, marrin pjesë në aktivitete të ndryshme, sportive nga arti figurativ ose muzikor, garojnë dhe argëtohen.

Byroja e zhvillimit të arsimit do të përgatit koncept për planifikimin dhe punën me nxënësit me qëndrim të vazhdueshëm dhe qëndrim tërëditor në shkollë, si dhe për mësimin hulumtues në natyrë.

## ***VI. VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE PËRPARIMI I NXËNËSVE***

Pjesë shumë e rëndësishme dhe konstitutive e konceptit për ndryshimet në arsimin dhe edukimin fillor është zhvillimi i sistemit bashkëkohorë i vlerësimit dhe përparimit që do t'i ketë parasysh karakteristikat dhe cilësinë e njohurive të nxënësve gjatë tri klasave të para (prej klasës së I deri të III), e mandej edhe në periudhën kur për zbatimin e mësimin do të përfshihen me arsimtarin klasor ose lëndor e veçanërisht në tre vitet përfundimtare të arsimit të detyrueshëm.

Me propozimin e ri prej klasës së I deri të III arsimtarët do t'i vlerësojnë të arriturat dhe përparimin e nxënësve në lëndë të ndryshme me nota me shkrim (notim përshkrues). Secili nxënës notohet në bazë të përcjelljes sistematike me forma dhe procedura të ndryshme për kontrollimin e njohurisë. Si bazë e notimit do të përdoret formular nacional (me udhëzim për vlerësim) ku merren parasysh qëllimet zhvillimore dhe njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që janë të zërthyera sipas temave (tërësive) mësimore për notimin me shkrim në lëndë të ndryshme dhe sipas klasave.

Prindërit dhe nxënësit marrin informata për suksesin në mësim dhe në mësimnxënie së paku tre herë në vjet, në çdo tremujorësh dhe në fund të vitit shkollor.

Në sjelljen e ligjit të ri për arsimin fillor do të mbahet modeli i deritanishëm për informimin e prindërve dhe nxënësit për suksesin në mësim dhe në mësimnxënie.

Në fund të klasës së tretë njohuritë e nxënësve vlerësohen me teste të standardizuara të njohurive në gjuhën amtare dhe në matematikë. Testet do të jenë të përshtatura me njohuritë dhe aftësitë e pritura (katalogje të njohurive) dhe do të përgatiten në Byronë e zhvillimit të arsimit dhe nga institucione tjera profesionale. Procedurat do të jenë të standardizuara. Vlerësimi do të zbatohet në mënyrë interne, për nxënësit dhe prindërit e tyre, dhe nuk guxojnë të kenë ndikim në nota e as në përparimin e nxënësve nga klasa e tretë në të katërt.

Nxënësi njoftohet me rezultatet që i ka arritur në testim dhe me rezultatet mesatare të të gjithë nxënësve në paralele. Me notat njoftohen edhe prindërit e nxënësve.

Në periudhën prej klasës së IV deri të VI arsimtarët mund të përdorin kombinim të notimit me shkrim dhe me numra në të gjitha lëndët. Gjithashtu, si prej klasës së IV deri të VI për notimin me shkrim përdoret formular nacional (me udhëzim për notimin). Mandej do të merren parasysh qëllimet dhe njohuritë zhvillimore, aftësitë dhe shkathtësitë që janë të zërthyer sipas temave (tërësive) mësimore për notimin me shkrim në lëndë dhe klasë të ndryshme. Kështu që notimi me numra vendoset për shkak të informimit të nxënësve me përmbajtjet e notave. Përshkrimet e të arriturave të nxënësve përgatiten në mënyrë të njëjtë si prej klasës së I deri të III. Kjo mënyrë e notimit do të ndihmojë për motivimin e nxënësve në mësim dhe në të mësuar, ndërsa prindërit do të kenë mundësi më të mëdha që të njoftohen në mënyrë më aktive me procesin e të mësuarit dhe vlerësimin e njohurive.

Informimet për suksesin e nxënësit siç u theksua përgatiten, gjatë vitit kurse në fund të vitit shkollor prej klasës së IV deri të VI nxënësi merr dëftesë për secilën klasë me nota numerike në lëndë të ndryshme me nota për suksesin e përgjithshëm.

Me qëllim të informatave kthyesë në shkolla për të arriturat dhe përparimin e nxënësve në mbarim të mësimin në klasën e VI bëhet vlerësimi i njohurive të nxënësve me teste nacionale të njohurive në gjuhën amtare, matematikë dhe gjuhë të huaj edhe për një lëndë që e cakton ministri. Procedurat do të jenë të standardizuara ndërsa vlerësimi do të zbatohet në mënyrë interne. Notat do të shfrytëzohen si matje për zgjedhjen e nxënësve në mësimin shtues në nivel më të lartë në gjuhën amtare, matematikë dhe në gjuhë të huaj në klasën e VII, VIII dhe IX. Nxënësi njoftohet me rezultatet që i ka arritur në testim dhe me rezultatet mesatare të të gjithë nxënësve në paralele. Me notat njoftohen edhe prindërit e nxënësve.

Rezultatet e testimit shfrytëzohen si informata plotësuese për të arriturat e nxënësve dhe cilësinë e njohurive të tyre, ndërsa me atë edhe për cilësinë në arsim dhe punën në shkollë. Megjithatë, edhe këto rezultate nuk mund të ndikojnë në notat e nxënësit në fund të vitit e as në përparimin e nxënësit në klasën e VII.

Prej klasës së VII deri të IX arsimtarët gjatë vitit e mbikëqyrin dhe vlerësojnë përparimin e nxënësve me nota numerike. Nxënësit dhe prindërit

marrin informata për suksesin e arritur më së paku tri herë gjatë vitit shkollor, ndërsa në fund të vitit shkollor dëftesë me nota numerike sipas lëndëve dhe nota për suksesin e përgjithshëm.

Në fund të vitit shkollor, gjegjësisht në klasën e IX njohuritë e nxënësve vlerësohen me teste nacionale të njohurive në gjuhën amtare dhe matematikë edhe për një lëndë të cilën do ta përcaktojë ministri.

Testet e këtij lloji të ashtuquajtur kontrollimi përfundimtar i njohurive do të përgatiten dhe zbatohen me qëllim që të maten njohuritë dhe shkathtësitë që i kanë arritur nxënësit në arsimin fillor nëntëvjeçar.

Vlerësimi i njohurive në lëndët e përmendura bëhet në mënyrë eksterne dhe në tërësi janë garantuar procedurat gjatë zbatimit të testimit dhe vlerësimit.

Rezultatet nga kontrollimi i njohurive me zbatimin e testeve nacionale shkollat do t'i shfrytëzojnë në pajtim me qëllimet që janë definuar për kontrollimin ekstern të njohurive. Këto rezultate nuk guxojnë të shpallen publikisht ose të shfrytëzohen si kritere për vlerësimin financiar në punën e shkollës dhe arsimtarëve. Kështu format eksterne të kontrollimit të njohurive do të kenë për qëllim që të modernizohet mënyra e përcjelljes dhe kontrollimit të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve gjatë vitit shkollor.

Megjithatë në praktikën mësimore theks të veçantë duhet t'i vihet përcjelljes formative të njohurive dhe zhvillimit të çdo individi. Gjegjësisht, sistemi i përcjelljes dhe vlerësimit të njohurive të nxënësve do të zhvillohet me përcjellje të rregullt gjatë mësimin me kontrollime me gojë, me shkrim dhe lloje tjera të detyrave, vendosja e testeve të standardizuara të njohurive, si dhe me aftësimin e arsimtarëve dhe nxënësve për vetëvlerësim.

Është e domosdoshme që të zhvillohen procedurat dhe metodat edhe për vetëvlerësim të shkollës në tërësi, gjatë së cilës në bazë të kritereve relevante duhet të vlerësohet programi vjetor për punën e shkollës, programet zhvillimore dhe rezultatet në mësim dhe në të mësuar, e veçanarisht të arriturat e nxënësve dhe klima e shkollës. Gjithashtu, nga kjo kuptojmë edhe vlerësimin e resurseve me të cilat disponon shkolla: kuadër, lokal, pajisje dhe mjete financiare si dhe udhëheqja dhe organizimi i shkollës. Byroja e zhvillimit të arsimit do të vendos kritere për aspektet e përmendura për vetëvlerësimin e shkollës.

Nxënësit prej klasës së I deri të VI sipas rregullës nuk përsëriten në klasën e njejtë edhe në kalimin prej klasës së VI deri të VII. Kështu nxënësi i cili nuk do t'i arrij standardet e caktuara nuk mbetet në klasë të njejtë, megjithatë në vitin e ardhshëm shkollor në klasën e VII përmes mësimin të organizuar plotësues duhet të ketë mundësi që ta plotësojë njohurin dhe dhe t'i arrij rezultatet e pritura.

Nxënësit të cilët në klasën e VII, VIII dhe IX kanë një ose dy nota negative mund të ndjekin mësim plotësues ose të hynë në riprovim para fillimit të vitit të ri shkollor. Ata mund të mbeten në klasë të njejtë në qoftë se në mësimin plotësues ose në riproprovim nuk i arrijnë njohuritë e parapara me programin mësimor ose nëse në fund të vitit shkollor kanë më tepër se dy nota negative.

Nxënësit të cilët edhe përveç mundësive për shoqërim në klasë të njejtë edhe më tej nuk do të munden me sukses ta mbarojnë arsimin e obligueshëm do të marrin vërtetim se e kanë plotësuar obligimin në arsimin fillor. Në vërtetim përfshihet suksezi nga klasa e fundit në të cilën nxënësi luan rol pozitiv në të gjithë lëndët.

Duhet të theksohet se vendimet e përmendura nuk janë të reja, por për shumicën prej tyre kemi përvojë me zbatimin e vlerësimeve nacionale në fund të

klasës së IV edhe në fund të klasës së VII. Elementet e caktuara në sistemin e vlerësimit mund edhe më tej të saktësohen ose edhe të rritet edhe numri i lëndëve për testimin përfundimtar të njohurive të nxënësve në klasën e nëntë.

Modeli i propozuar mund të zhvillohet me sukses me përpunim të hollësishëm të vlerësimit me shkrim i cili zbatohet në shkollat tona më shumë se tre vite shkollore në grupin klasor. Gjithashtu, mund të përfundohet modeli i testimit të njohurive të nxënësve në klasën e VIII që zbatohet në periudhën prej vitit 1992 deri në 1995 i cili ishte i pranueshëm mirë nga arsimtarët dhe nxënësit si dhe prindërit e tyre. Siç është e njohur në praktikën mësimore nxënësit dhe prindërit rregullisht informohen për suksesin gjatë tremujorëshit dhe gjysmëvjetorit, përderisa notat e nxënësve rrumbullaksohen dhe informohen në fund të vitit mësimor me dëftesë për suksesin e nxënësit. Përveç kësaj gjatë vitit shkollor nxënësit dhe prindërit e tyre vazhdimisht njoftohen për të arriturat e nxënësve në mbledhjet e prindërve si dhe në mënyra tjera.

## VII. SHKOLLIMI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË POSAÇME ARSIMORE

Sikurse në vendet tjera të zhvilluara, nocioni *nevoja të posaçme arsimore* ka të bëjë me fëmijët me pengesa në zhvillimin psiqik, me dëmtim në të pamurit dhe të verbërit, fëmijë të shurdhër dhe pengesa në dëgjim, si dhe fëmijë me pengesa në të folur. Ky nocion përfshin fëmijë me pengesa në livizje, fëmijë të sëmurë vazhdimisht, si dhe fëmijë me pengesa në sjellje dhe karakter të cilët kanë nevojë për ndihmë plotësuese profesionale ose për përshtatje, gjegjësisht programe të posaçme për edukim dhe arsimim.

Shkollat fillore janë të detyrueshme të realizojnë programe për fëmijët me nevoja të posaçme vetëm me një shkallë dhe lloj të caktuar të pengesës në zhvillim, të cilët mundën me sukses të inkuadrohen në mjedisin shkollor të rëndomtë. Për këtë arsye shkollat duhet të sigurojnë punëtorë profesional për përgatitjen dhe zbatimin e mësimin, si dhe për ndjekjen dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve. Sipas kësaj fëmijët me nevoja të posaçme në Republikën e Maqedonisë inkuadrohen në klasat e rregullta të shkollës fillore vetëm atje ku në shkolla ka arsimtarë dhe kushte adekuate, si dhe profesionist të caktuar për punën plotësuese me këta fëmijë (defektolog dhe kuadër tjetër të ngjajshëm).

Gjithashtu, shkollat fillore nuk duhet të jenë këmbëngulës për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme, e veçanërisht në qoftë se nuk kanë pajisje përkatëse dhe kuadër profesional.

Për arsimin fillor të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore ekzistojnë edhe shkolla fillore të posaçme, ente ose paralele të posaçme në shkollat e rregullta fillore. Mësimi në këto shkolla realizohet sipas planeve dhe programeve të adaptuara mësimore dhe adekuate për llojin dhe shkallën e nevojave arsimore të fëmijëve.

Komisionet adekuate profesionale në institucionet profesionale bëjnë vlerësimin dhe notimin e nxënësve me nevoja të posaçme dhe japin propozim për inkuadrimin e tyre në shkollat fillore të rregullta ose të posaçme. Vendimi për inkuadrimin e fëmijës e sjell prindi.

Suksesi në punën me fëmijët me nevoja të posaçme, gjithashtu edhe më tej më tepër do të varet nga qëndrimet dhe të kuptuarit e arsimtarit për arsimimin a fëmijëve të tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që prindërit të jenë të inkuadruar në të gjitha hapat, nga sjellja e vendimit për inkuadrimin e

fëmijëve në shkollë, planifikimi i punës, orari i kohës së punës dhe vlerësimi dhe përparimi i fëmijës sipas programit.

Arsimtarët, edukatorët, defektologët që janë të angazhuar për mësimin në grupe për fëmijët me nevoja të posaçme arsimore duhet të aftësohen në veçanti për këtë lloj pune. Gjithashtu, nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në shkolla do t'iu garantohet ndihmë profesionale këshillëdhënëse (me plotësimin dhe zhvillimin e planeve individuale arsimore për punën me fëmijët dhe me kërkesë të mënyrës përkatëse për integrim social), udhëheqje profesionale dhe përcjellja e punës, si dhe për zgjidhjen e problemeve profesionale në shkollë edhe në paralelet ku janë të përfshirë fëmijët me nevoja të posaçme arsimore në zhvillim. Ndihma profesionale do t'iu garantohet edhe prindërve të fëmijëve për të gjitha problemet me të cilat hasen gjatë realizimit të programit shkollor.

Në paralelen në të cilën do të përfshihet fëmija me nevoja të posaçme arsimore ka më pak nxënës sesa nga numri i rëndomtë, ndërsa në paralelen e njejtë mund të inkuadrohen më së shumti tre nxënës me nevoja të posaçme. Për këtë arsye do të vendoset rregullore e posaçme.

Për fëmijët me nevoja të posaçme në zhvillim të cilët janë të inkuadruar në shkollimin e rregullt do të organizohet ndihmë plotësuese për mësimin e individualizuar dhe forma të reja të punës. Ndihma e organizuar për nxënësit përshtatet sipas nevojave individuale.

Rëndësi më të madhe në shkollë do t'i kushtohet organizimit të punës profesionale plotësuese këshillëdhënëse për fëmijët me nevoja të posaçme. Për llojin e ndihmës së nevojshme (se a do të angazhohet arsimtar i posaçëm, defektolog ose ngjajshëm me të) vendim sjell shkolla në bashkëpunim me persona profesional varësisht nga nevojat e fëmijëve, si dhe në organizimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera me nxënësit në shkollë.

Për arsimin fillor të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore do të përpunohen plane të posaçme arsimore individuale me çka u mundësohet fëmijëve për socializim, përvetësim, njohuri, shprehi dhe shkathtësi tjera. Me programet dhe metodat në mësim rëndësi më të madhe do t'i kushtohet aftësimin të nxënësve për jetesë dhe punë.

Shkollat dhe paralelet e posaçme në shkollat e rregullta për arsimin fillor për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore organizohen sipas parimeve të njejtë si dhe shkollat e rregullta fillore. Aty është e nevojshme që vëmendje të posaçme t'i kushtohet aftësimin profesional dhe pedagogjik të arsimtarëve dhe edukatorëve dhe zhvillimit të shërbimeve për ndihmë këshillëdhënëse dhe punë profesionale me nxënësit dhe prindërit.

Shkollat e posaçme fillore dhe paralelet e posaçme në shkollat fillore të rregullta një pjesë të mësimin që ka të bëjë me socializimin dhe integrimin e fëmijëve mund ta organizojë edhe në shkolla të rregullta (në ditë, pjesë të caktuar të ditës, javës etj.) në marrëveshje me shkollat e rregullta.

### *VIII. AKTIVITETE JASHTËMËSIMORE*

Programi i shkollës përfshin aktivitete të ndryshme jashtëmësimore të nxënësve për përmbushjen e interesave individuale dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve për punë të përbashkët e cila kontribuon për përforcimin e besimit të reciprok, shoqërim në kohë të lirë dhe ngjajshëm me atë.

Në shkollë fillore aktivitetet e lira të nxënësve më së shpeshti organizohen në lëmin e shkencës, teknikës, artit, sportit, vetëmbrojtjes, përparimit të shëndetit ose me pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet kulturoro-artistike dhe shoqëroro-humanitare (pjesëmarrja në korrin e shkollës, orkestër, dramë, seksion recitues në aktivitetet për ndihmë personave tjerë etj). Në këtë mënyrë në shkollë krijohen mundësi që nxënësit të cilët kanë interesim për lëndë dhe lëmi të ndryshme, pamarr parasysh suksesin në mësim, të vërtetohen në të arriturat e tyre. Interesimi personal i nxënësit ka rëndësi primare për zgjedhjen e aktiviteteve jashtëmësimore. Shkolla fillore posedon kompetenca që të përkujdeset për krijimin e hapsirave, për kushtet kadrovike dhe materialo-teknike për pasurimin dhe kuptimsinë e qëllimeve dhe përmbajtjen e aktiviteteve të lira të nxënësve ndërsa lidhshmëria e përmbajtjeve në aktivitetet e lira të nxënësve në programe mësimore varet nga interesimi i nxënësve. Gjithashtu, pa marr parasysh nivelin e korrelacionit në mësim, me aktivitetet e lira pasurohet puna edukativo-arsimore e shkollës dhe me këtë ajo bëhet më tërheqëse bëhet për nxënësit.

Me planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të lira të nxënësve duhet të vendoset një qasje bashkëkohore që do të mundëson pjesëmarrje aktive të nxënësve në më shumë faza: zgjedhja, përzgjedhja e temave, grumbullimi i të dhënave dhe përpunimi i tyre, madje deri te prezentimi i rezultateve të aktiviteteve, gjer te përpjekja e tyre për zbatimin e tyre në shkollë në mjedisin jetësor .

Që të mos vijë deri te ngarkesa e tepruar e nxënësve me aktivitete të lira sipas rregullës secili nxënës merr pjesë në një aktivitet të lirë. Nxënësit të cilët marrin pjesë në korrin apo orkestrin e shkollës mund të angazhohen më së shumti me nga tri orë në javë.

Grupet apo seksionet e posaçme që organizohen për aktivitetet e lira të nxënësve mund të bashkohen sipas përmbajtjes dhe karakterit të aktiviteteve në asociacione më të mëdha tërheqëse të nxënësve. Kështu për shembull, në shkollë mund të formohen shoqata letrare, kooperativa të nxënësve, shoqata sportive, klube teknike, shoqata kulturoro-artistike. Ekzistojnë mundësi për lidhshmërinë e aktiviteteve të nxënësve në nivel edhe të komunës me organizata dhe bashkësi përkatëse (Kryqi i Kuq, Teknika popullore, Aradhat vëzhguese, Organizata e fëmijëve, Shoqata e pylltarëve dhe Shoqata ekologjike.

Aktivitetet e lira të nxënësve planifikohen më hollësisht me programin vjetor të shkollës fillore. Për këtë qëllim Byroja e zhvillimit të arsimit do të përgatitë baza programore me çka do të përcaktohen qëllimet e aktiviteteve të lira të ndryshme të nxënësve, organizimi i tyre dhe karakteristikat tjera specifike.

**Garat e nxënësve** përfshinë aktivitete për të cilat nxënësit shprehin interesim dhe me këto prezentohen të arriturat jo vetëm të nxënësve por edhe të shkollës në mësim dhe në sfera tjera. Garat mund të organizohen në nivel të shkollës, komunës dhe në kuadër të shtetit. Nxënësit më të suksesshëm marrin pjesë në gara ndërkombëtare.

**Puna e dobishme- humanitare dhe shoqërore** e nxënësve më tepër zbatohet në mjedisin lokal. Për këtë arsye përgatiten programe për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit, aksioneve punuese të nxënësve, organizohen grupe të nxënësve dhe asociacione me qëllime dhe përmbajtje të ndryshme për punën që e udhëheqin nxënësit. Sipas nevojës, nxënësit e rregullojnë shkollën, u ndihmojnë nxënësve tjerë në mësim, personave të hendikepuar si dhe me rast

social, marrin pjesë në lehtësimin e pasojave nga fatkeqësi elementare edhe në aktivitete tjera që kanë rëndësi më të madhe shoqërore dhe humanitare.

**Ekskurzionet e nxënësve** organizohen për zgjerimin e njohurive të nxënësve nga lëmi të ndryshme edukativo-arsimore dhe lëndë mësimore, e gjithashtu edhe për sport, rekreim dhe shoqërim në kohën e lirë. Ekskurzionet që janë në funksion të drejtëpërdrejt në mësim-ekskurzionet mësimore, realizohen në kuadër të ditëve të obligueshme mësimore që duhet t'i plotësojë nxënësi gjatë vitit shkollor.

Numri i ekskurzioneve gjatë vitit shkollor, qëllimi dhe përmbajtja e tyre, mënyra e organizimit dhe realizimit planifikohet sipas programit vjetor për punë dhe planit vjetor për mësimin në shkollë.

Përveç kësaj ekskurzionet planifikohen edhe në kuadër të lëndëve dhe lëmive të caktuara.

Në planifikimin e ekskurzioneve rëndësi dhe rol të veçantë duhet t'i kushtohet prindërve të nxënësve dhe të mbahet llogari që të gjithë fëmijët të inkuadrohen në të, pa marrë parasysh statusin social. Procedura e zbatimit të ekskurzioneve (qëllimet, përmbajtjet, kriteret, mënyra e realizimit etj.), rregullohen me rregullore të veçantë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

### ***Kujdesi për shëndetin e nxënësve***

Aktivitetet dhe përmbajtjet e ndryshme që kanë të bëjnë me ruajtjen e shëndetit të nxënësve janë të përfshira në programet mësimore, e veçanërisht në mësimin e sportit dhe edukimit shëndetësor, njohja e mjedisit, biologji, kimi, si dhe në aktivitetet e lira të nxënësve. Një pjesë e detyrave realizohen edhe në orën e bashkësisë së klasës.

Gjithashtu, mbrojtja dhe përparimi i shëndetit të nxënësve në shkollë fillore realizohet edhe me kontrollime të rregullta mjeksore, e kur ka nevojë merren edhe masa tjera. Shkolla në kuadër të mundësive objektive kujdeset për organizimin ushqimit të tërësishëm ose të pjesërisht të nxënësve edhe për kushtet higjienike, aktivitetet sportive, pushimet dimërore, verore, shëtitjet-pikniqe në natyrë etj.

Në programin vjetor të shkollës fillore planifikohen aktivitete me nxënësit për përparimin e shëndetit (si për shembull, për mënyrën e jetesës, ushqimin, formimin e vetëdijes për mbrojtje nga rreziqet nga përdorimi i drogës, duhani, nikotinizmi, alkooli, sida, si dhe tema tjera sipas zgjedhjes së nxënësve që kanë të bëjnë me përparimin e shëndetit.

### **Bashkëpunimi me mjedisin lokal**

Shkolla fillore përdor mënyra të ndryshme për lidhshmëri më të afërt me mjedisin lokal. Ky bashkëpunim më tepër përfshin:

- bashkëpunimi me familjen, veçanërisht me prindërit e nxënësve;
- bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale dhe institucionet edukativo-arsimore, institucionet nga sfera e kulturës, sipërmarrjet si dhe organet dhe organizatat tjera për pasurimin e përmbajtjeve dhe aktiviteteve të nxënësve;
- aktivitete të ndryshme shoqërore, kulturore dhe arsimore me popullatën e re dhe të moshuar nga mjedisi lokal;
- informim të opinionit më të gjerë për rezultatet që i arrin shkolla fillore;
- përfshierja e shkollës në aktivitetet kulturore dhe arsimore që organizohen në mjedisin lokal.



- Shkolla rregullisht duhet ta informojë opinionin për punën e saj, për gjendjet dhe problemet dhe të bashkëpunojë me institucionet tjera nga mjedisi lokal, me persona profesional nga sfera të ndryshme (letërsi, gazetari, punëtorë shëndetësor, teatër, muzeje, galeri etj.), që mund të ndihmojnë për organizim më cilësor të procesit arsimor dhe edukativ. Rëndësi të veçantë ka bashkëpunimi i vazhdueshëm që realizohet edhe me takimet e prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve të cilët informohen në mes veti për rezultatet në mësim dhe për çështjet tjera që janë të lidhura me nevojat dhe vështirësitë e nxënësve në mësim dhe mësimnxënie.

E nevojshme është që shkolla të përgatit programe dhe të organizojë aktivitete për kremtimin e festave të rëndësishme (festa e shkollës, festat shtetërore, e veçanërisht me rastin e fillimit dhe mbarimit të vitit shkollor etj.). Këto aktivitete planifikohen në mënyrë të obligueshme që të mundën nxënësit t'i prezantojnë rezultatet dhe të arriturat para prindërve dhe popullatës tjetër në mjedisin lokal dhe më gjerë. Përmes këtyre aktiviteteve shkolla i tregon të arriturat në arsim dhe aktivitetet e lira të nxënësve (korr, orkestër, grupet dramatike dhe letrare, veprimtari artistike etj.). Këto aktivitete planifikohen me programin për punën e shkollës edhe mbështeten me mjete të caktuara financiare për arsimim nga fondet e komunës dhe me donacione tjera.

Shkollat në mënyrë të pavarur fillore mundën të organizojnë gara për nxënësit ose të përfshihen në garat e njohurive dhe shkathtësive në lëndë dhe lëmi të ndryshme që organizohen në komunë. Ata kanë rëndësi për motivimin e nxënësve për pjesëmarrje të rregullt në aktivitetet e lira dhe në mësimin shtues. Garat e nxënësve organizohen edhe në bashkëpunim me institucione tjera profesionale nga mjedisi lokal dhe më i gjerë (organizatat për kujdesjen dhe edukimin e fëmijëve, konviktet e fëmijëve, teknika popullore, lidhja e matematikanëve, informatikanëve, fizikanëve, bibliotekat, muzejet etj., këshillat për siguri në komunikacion, shoqatat për sporte të ndryshme etj.).

Aktivitetet dhe bashkëpunimi me mjedisin lokal të cilat përfshihen në programin për punën e shkollës fillore mbështeten me mjete përkatëse financiare, nëse përmbajtjet, lloji dhe mënyra e bashkëpunimit me mjedisin lokal vërtetohen me programin për punën e shkollës për çdo vit shkollor.

## *IX. ARSIMI FILLOR PËR MUZIKË DHE BALET*

Arsimi dhe edukimi fillor i muzikës dhe baletit organizohet për krijimin e kushteve për zgjerimin e kulturës së muzikës dhe baletit dhe për përgatitjen e nxënësve për arsimin e mëtejshëm për këto lëmi të artit. Kjo veprimtari realizohet në shkollat për arsimin fillor të muzikës dhe baletit. Për përhapjen e arsimit dhe edukimit të muzikës dhe baletit mund të organizohen edhe paralele të ndara në shkollat fillore të rregullta të cilat në mënyrë organizative i përkasin shkollave për arsimin fillor të muzikës ose baletit. Me marrëveshje të veçanta rregullohen obligimet e shkollës në të cilat janë hapur paralele për arsimin fillor të muzikës dhe baletit.

Varësisht nga lloji i instrumentit arsimi fillor muzikor mund të zgjas më së shumti 6 vite. Arsimi fillor i baletit zgjat 5 vite. Kur ka nevojë, për përfshirje më të suksesshme të nxënësve në arsimin fillor të muzikës dhe baletit organizohet edhe mësimi përgatitor. Në këto raste kohëzgjatja e shkollimit vazhdon për një vit.

Viti përgatitor është përzgjedhës.

Plani dhe programi për mësim, normativat për hapsirën, pajisjet dhe mjetet mësimore, si dhe normativat për përgatitje profesionale dhe profili i kuadrit mësimor për arsimin fillor të muzikës dhe baletit sipas propozimit të shkollës i harton Byroja e zhvillimit të arsimit.

Në procesin arsimor dhe edukativ në këto shkolla dhe paralele mbisundon mësimi individual dhe në grupe. Për arsimin fillor të muzikës numri i orëve për nxënësit sillet më së shumti deri 7 orë në javë, ndërsa në shkollat për arsimin fillor të baletit më së shumti 16 orë në javë.

Kushtet për regjistrim dhe mënyra e dhënies së provimeve rregullohet me statutin e shkollës, kurse normativat për kuadrin arsimor janë vërtetuar sipas programeve arsimore.

**PLANI MËSIMOR**  
**për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvjeçar për këndim dhe instrumente:**  
**Kontrabas dhe fagot**

Lënda mësimore	Fondi javor i orëve sipas klasave	
	I	II
Këndim-Instrumet	2	2
Solfezh	2	2
Teoria e muzikës	1	1
Gjithsej orë:	5	5

Për realizimin e programit edukativo-arsimor në këndim, orët mësimore për instrumentet kontrabas dhe fagot zgjasin nga 30 min., ndërsa për solfezh dhe teori të muzikës zgjasin me nga 40 minuta.

**PLANI MËSIMOR**  
*Për arsimin fillor pesëvjeçar të muzikës për instrumentet më frymë  
(instrumente druri) gitarë klasike, harfe dhe instrumente me të goditur)*

Lëndët mësimore  
Fondi javor i orëve mësimore sipas klasave

Instrumenti	Përgatitor	I	II	III	IV	V
	1 Gjysmëvjetori i dytë	2	2	2	2	2
Solfezh me teori elementare të muzikës	2	2	2	2	/	/
Solfezh	/	/	/	/	2	2
Teoria e muzikës	/	/	/	/	1	1
Orkestri; Kori, grupe kamertale	/	/	/	/	2	2
Gjithsej orët	3	4	4	4	7	7

Për realizimin e programit për instrumentet frymore, gitara klasike, harfa, instrumente me të goditur në klasën e I, II dhe III zgjasin me nga 30 minuta, kurse në klasën e IV dhe V me nga 40 minuta.

### PLANI MËSIMOR

*Për arsimin fillor gjashtëvjeçar të muzikës për instrumentet:*

*Piano, violinë, violë, violonçel, flaut dhe harmonikë*

Plani mësimor

Fondi javor i orëve sipas klasave

Instrumenti	Përgatitor	I	II	III	IV	V	VI
	1 Gjysmëvjetori i dytë	2	2	2	2	2	2
Solfezh me teori elementare të muzikës	2	2	2	2	2	/	/
Solfezh	/	/	/	/		2	2
Teoria	/	/	/	/	/	1	1
Orkestri; Kori, grupe kamertale	/	/	/	/	2	2	2
Gjithsej orë mësimore	3	4	4	4	6	7	7

Në shkollën fillore të arsimit muzikor mund të organizohet edhe mësim sipas instrumenteve muzikore popullore me nga një orë të muzikës në javë (obligat), për nxënësit të cilët tani më i bien ndonjë instrumenti.

Për realizimin e programit edukativo-arsimor në instrumenteve piano, violinë, violonçel, flaut dhe harmonikë në klasën e I, II, III në shkollën fillore të muzikës orët zgjasin me nga 30 min, kurse në klasën e IV, V dhe VI me nga 40 minuta.

Mësimi për të gjitha instrumentet organizohet në formë individuale.

Për realizimin e programit në solfezh dhe teori të muzikës prej vitit përgatitor deri në klasën e VI zgjasin me nga 40 minuta.

Mësimi në solfezh dhe teori të muzikës organizohet në grupe prej 9 deri 15 nxënës.

Bashkëpunëtor i pianos – korepetitori mban orë bashkë me arsimtarin e instrumenteve me të goditur dhe instrumenteve frymore.

Korepeticioni (ndihma në të mësuar) për nxënësit e arsimit fillor nëntëvjeçar të muzikës zgjat nga 15 min. një herë në javë.

Korepeticioni për nxënësit në arsimin fillor pesëvjeçar të muzikës të cilët i mësojnë instrumentet frymore të drurit dhe metalit në klasën e I, II dhe III zgjat nga 15 minuta në javë ndërsa në klasën e IV dhe V me nga 30 minuta në javë.

Korepeticioni për nxënësit në arsimin fillor gjashtëvjeçar të muzikës të cilët i mësojnë instrumentet violinë, violë, violonçel dhe flaut prej klasës së I deri të IV zgjat 15 minuta, ndërsa për nxënësit prej klasës së V dhe VI me nga 30 min. një herë në javë.

Fondi i orëve të arsimtarëve për udhëheqjen e kore të fëmijëve njëjtinore

## X. ARSIMIMI I ARSIMTARËVE

Zhvillimi i konceptit për arsimimin e arsimtarëve në shkollë fillore bazohet në procedurat vijuese:

- në shkollë fillore në praktikën e deritanishme angazhohen arsimtarë klasor dhe lëndor;

- në grupet e vitit përgatitor janë të angazhuar edukatorë me arsimim të mbaruar të lartë dhe arsimtarë klasor;

- në shkollat ku është bërë përfshierja e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore janë të inkuadruar arsimtarë dhe defektolog.

Në tërë periudhën e zbatimit të planit të ri mësimor për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvjeçar duhet të përshejtohet trajnimi profesional dhe aftësimi metodiko-pedagogjik i arsimtarëve për zbatimin e programeve të reja mësimore.

Në klasën e I në shkollë fillore mësimin e realizojnë arsimtarë të edukimit parashkollor të cilët kanë mbaruar studime të larta arsimore.

Arsimtarët e mësimit klasor, gjithashtu, sipas konceptit të ri për arsimin fillor nëntëvjeçar e realizojnë mësimin në klasën e I dhe vazhdojnë të punojë me nxënësit e vet prej klasës së I deri të III, kështu që është i obliguar për realizimin e mësimit në të gjithë lëndët, përveç në gjuhën angleze që do ta mësojnë nxënësit prej klasës së I.

Arsimtarët e edukimin parashkollor secilin vit shkollor punojnë me grup të ri të nxënësve në klasën e I në shkollë fillore, gjegjësisht mund të udhëheqin grup me nxënës në klasën e I dhe në kopshtet shkollore.

Në paralelet në klasën e IV dhe V në shkollën fillore nëntëvjeçare për pjesën më të madhe të mësimit edhe më tej është i detyrueshëm arsimtari klasor, përveç mësimit në gjuhën angleze, gjuha maqedonishte për nxënësit e bashkësive të tjera dhe mësimi në shkencat natyrore në klasën e V. Në shkollat ku ka kushte në klasën e V mund të inkuadrohen arsimtarë lëndor edhe të arsimit muzikor, artistik dhe arsimit teknik. Mandej duhet të mbahet llogari që fondi i orëve i arsimtarit klasor në lëndët e detyrueshme në klasën e V të mos jet më i vogël se 17 orë.

Në klasën e VI mësimi i tërësishëm realizohet nga arsimtarë lëndor. Arsimtarët lëndor vazhdojnë të punojnë me nxënës deri në klasën e IX.

Koncepti i ri ka për qëllim që të gjithë arsimtarët të kenë të mbaruar arsimim të lartë me drejtim adekuat në fakultetet për arsimtarë.

Duke e pasur parasyshë përvojën pozitive në organizimin dhe realizimin e mësimit nga ana e arsimtarëve dylëndor (për lëndë të ngjajshme dhe të afërta) duhet të aktualizohet dhe të përpunohet në hollësi modeli i studimeve dylëndore dhe të përfshihen programe për studime për arsimtarët e fakulteteve që do t'i aftësojnë studentët për realizimin e mësimit sipas programeve të reja mësimore për shkollën fillore.

Duke i pasur parasyshë standardet ndërkombëtare për arsimimin e arsimtarëve të universiteteve dhe fakulteteve edhe një herë duhet të shqyrtohen programet studimore që të vendoset përpunimi në mes disiplinave mësimore për lëndët për të cilat përgatitet arsimtari dhe arsimit pedagogjik, metodiko-psikologjik dhe ushtrimet metodike gjatë studimeve. Rekomandohet që në grupet studimore për arsimtarët lëndor për shkollë fillore të ndahen më së paku 25% nga fondi i përgjithshëm i orëve gjatë studimeve për aftësimin pedagogjiko-

psikologjik dhe metodik të studentëve. Ky standard mendohet si komponentë shumë e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme për punë të suksesshme të arsimtarit në shkollë fillore.

Në programet studimore për arsimtarët klasor në shkollë fillore duhet të ndahen së paku 50% nga fondi i përgjithshëm i orëve gjatë studimeve për aftësimin metodiko-pedagogjik të studentëve.

Për aftësimin praktik të studentëve për planifikimin dhe realizimin e mësimit duhet të ndahen gjatë studimeve prej 6-10 javë për mbajtjen e ushtrimeve praktike me studentët në shkolla fillore. Vetëm në këtë mënyrë arsimit inicial i arsimtarëve në vendin tonë do të mund të afrohet me standardet për programet cilësore për arsimimin e arsimtarëve në vendet e zhvilluara në Evropë.

Për implementimin e vazhdueshëm të Konceptit të ri në periudhën 3+3+3, të cilët udhëhiqen sipas karakteristikave zhvillimore të nxënësve, është i nevojshëm edhe arsimit inicial për arsimtarët që t'i përshtatet konceptit të ri. Kështu, do të mundësohej që mësimin në dy periudhat e para ta realizon arsimtari klasor (përveç në lëndë të veçanta), kurse arsimtarët lëndor ta realizojnë mësimin në klasën e VII, VIII dhe IX. Me një përshtatje të tillë shteti do të fitonte arsim më të lirë dhe më të kapshëm për të gjithë fëmijët.

Deri tani koncepti sipas planifikimit të mësimit dhe zhvillimi i programeve të reja mësimore do t'i përcjell karakteristikat zhvillimore të fëmijëve, e në realizim të këtyre programeve do të udhëhiqet nga arsimit inicial i kuadrit arsimor ekzistues në shkolla.

Arsimtarët duhet të përmbahen me masa adekuate për përfshirjen edhe të studimeve pasuniversitare posaçërisht në sferën e didaktikës, si dhe për përfshirjen e studimeve të doktoraturës. Është e domosdoshme që në mënyrë më të organizuar të përshpejtohen edhe hulumtimet zhvillimore dhe projektet tjera hulumtuese në arsimin dhe edukimin fillor. Me ndihmë të këtyre kuadrove do të mund të zhvillohen institucionet dhe shërbimet për kryerjen e punës profesionale dhe tjetër këshillëdhënëse cila është e domosdoshme për zhvillimin e shkollës fillore.

Byroja e zhvillimit të arsimit në kuadër të kompetencave sipas Ligjit të ri duhet të përgatit plane për trajnim të vazhdueshëm të kuadrit arsimor, bashkëpunëtorëve profesional dhe drejtorët e shkollave fillore dhe të bëjë zgjidhje të programeve dhe oferta për trajnime që do të jenë në përputhje me fazat me të cilat do të aplikohen ndryshimet në shkollë. Për arsimtarët të cilët do të ligjerojnë gjuhë angleze në periudhën e parë edukativo-arsimore me rëndësi është të përgatiten module të posaçme arsimore ku do të përfshihen specifikat në mësimin e hershëm të gjuhëve.

Me Ligjin për arsimin fillor do të rregullohet sistemi i vlerësimit dhe përparimi i arsimtarëve në karrierë.

## *XI. KOMPETENCAT, TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË*

Koncepti i ri ka për qëllim përforcimin e shkollës dhe zhvillimin e praktikës për prezentimin e tij para prindërve dhe opinionit publik.

Për këtë arsye shkolla fillore boton publikim i cili është i kuptueshëm për prindërit dhe aty duhet të përshkruhet organizimi i punës së shkollës, karakteristikat e planit mësimor, të drejtat dhe obligimet e nxënësve. Gjithashtu, duhet

të sqarohen mundësitë e shkollës për organizim, për qëndrim të vazhdueshëm, mësim tërëditor, për aktivitetet sportive dhe garat me të cilat mund të marrin pjesë nxënësit në klasat më të larta. Me rëndësi të madhe janë edhe të dhënat për bibliotekën e shkollës, shërbimin këshilldhënës të shkollës, drejtorin dhe arsimtarët. Prindërit në publikim duhet të gjejnë të dhëna të qarta dhe të kuptueshme që shkolla ua ofron nxënësve dhe çka mund të presin prej tij.

Byroja e zhvillimit do të hartojë plan për informatat kryesore të cilat duhet t'i përfshijë publikimi për të dhënat e shkollës. Sipas planit do të përcaktohen pjesët kryesore të publikimit, ndërsa shkolla duhet ti fut edhe specifikat e veta.

Në shkollë grumbullohen të dhënat për nxënësit edhe për prindërit e tyre, për karakteristikat shëndetësore dhe specifikat që kanë të bëjnë me nxënësin, ku jetojnë dhe ku munden t'ju dërgohen raportet e domosdoshme.

Është i nevojshme të vendoset dokumentacion e ri pedagogjik në të cilin do të evidentohen të dhënat për suksesin dhe përparimin e nxënësit/nxënëses gjatë shkollimit, dëftesat që janë dhënë dhe dokumentet tjera për zhvillimin dhe të arriturat në shkollë. Të dhënat personale për nxënësin/nxënësen kanë të bëjnë edhe me gjendjen familjare dhe sociale, procedurat për ndihmë profesionale, mendime profesionale nga institucione tjera (qendra për punë sociale, institucione shëndetësore etj.) Për këto të dhëna nevojitet përputhje nga prindërit dhe ata ruhen në shkolla si fshehtësi profesionale sipas Ligjit për ruajtjen e të dhënave.

Arsimtari klasor, gjegjësisht udhëheqsi i paraleles është personi i cili më së miri e njeh jetën e fëmijës në klasën e vet. Me këto prindërit kanë më tepër biseda prej klasës së I deri të V, gjegjësisht prej klasës së VI deri të IX. Udhëheqësi i paraleles, si dhe arsimtari klasor i përcjell rezultatet e nxënësve në mësim dhe kujdeset për zgjidhjen e problemeve që paraqiten. Qëllimi i tyre kryesor është që nxënësit të jenë të sigurtë në shkollë.

Udhëheqësi i paraleles bashkëpunon me pedagogun dhe psikologun e shkollës, si dhe me drejtorin e shkollës dhe prindërit, e kur ka nevoj propozon masa edukative. Udhëheqësi i paraleles duhet të jetë shumë me përgjegjësi, komunikativ dhe i drejtëpërdrejt për komunikim, që ta udhëheqë paralelen dhe ta përfaqëson para arsimtarëve tjerë dhe para prindërve.

Ai duhet të mendoj, që sa më mirë t'i kuptojë nxënësit e vet dhe tju ndihmojë, të dijë të bisedojë me ata në orën me bashkësinë e klasës për problemet e tyre, t'i këshillojë prindërit, t'i njoftojë me problemet dhe t'i inkuadrojë në jetën dhe punën e shkollës. Në qoftë se arrin që të krijojë besim tek nxënësit e tyre, atëherë udhëheqësi i klasës do të mundet me sukses ta udhëheq paralelen.

Në rregulloren e veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve do të përpunohen më hollësisht.

### **Të drejtat dhe obligimet e nxënësit, shkollës, prindërve dhe komunës**

Për të drejtat dhe obligimet e nxënësve është e detyrueshme të botohet publikim që e merr çdo nxënës, e me këtë edhe prindëri. Këtë publikim e boton Byroja e zhvillimit të arsimit me përkrahje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Aty përpunohen në pika të shkurtëra *të drejtat e nxënësve* që kanë të bëjnë:

- ndjekja e mësimi dhe mjedisi shkollor i shëndoshë dhe i sigurtë, respektimi i kulturës, gjuha dhe karakteristikat tjera të nxënësve, të drejtat e barabarta të nxënësve pamarrparasysh përkatësinë gjinore dhe etnike, racën, besimin fetar, gjendjen sociale të familjes dhe rethanat tjera;

- ruajtja e të dhënave personale të nxënësit, respektimi i aftësive të nxënësit dhe dinjiteti i tij, karakteristikat zhvillimore, paranjohuritë, kureshtja dhe cilësitë tjera individuale;

- marrja e informatave cilësore, informimi me rregull dhe i hollësishëm i nxënësit për punën e tij, ndihmën dhe mbështetjen gjatë punës, si dhe të drejtë për pjesëmarrje adekuate të nxënësit gjatë formimit të aktiviteteve ditore, pjesëmarrja në aktivitetet në shkollë dhe në grupe të posaçme dhe aksione të përbashkëta.

Nxënësi në shkollë fillore ka përgjegjësi t'i respektojë arsimtarët, punëtorët tjerë dhe nxënësit në shkollë, t'i plotësojë obligimet e veta shkollore, rregullisht dhe në kohë ta ndjek mësimin. Nxënësve dhe arsimtarëve nuk guxon t'iu pengon në punë. Secili nxënës mban përgjegjësi të kujdeset për shëndetin dhe sigurin e vet dhe të mos i rezikojë të tjerët, t'i respektojë rregullat e rendit shtëpiak, ta ruaj pronën e shkollës dhe ta ruaj individualitetin e nxënësve dhe punëtorëve në shkollë dhe jashtë saj, të sillet me respekt ndaj të tjerëve dhe të kontribuon gjatë rregullimit të shkollës dhe mjedisit të saj. Nxënësi mban përgjegjësi që rregullisht të marrë pjesë në kujdestarin e caktuar në shkollë.

Nxënësi rregullisht merr pjesë në mësim, në aktivitetet në lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore dhe i respekton rregullat sa i përket orëve edhe në klasë. Nxënësit marrin pjesë në sjelljen e këtyre rregullave. Për çdo mungesë mbahet dokumentim i rregullt, ndërsa prindëri është i detyrueshëm ta informojë arsimtarin e klasës ose udhëheqësin e parakalles me gojë apo me shkrim për arsyet të cilët fëmija nuk ka qenë prezent në orë.

Me rregullore të veçantë rregullohen mënyrat e mbrojtjes së të drejtave të nxënësit në rastet kur shkelen të drejtat e tij, si dhe format e organizimit të mbrojtjes së nxënësve në shkollë, e veçanërisht në klasën e I kur vijnë në shkollë para fillimit të mësimin nëse prindërit duhet patjetër të shkojnë më herët në punë. Kjo formë e mbrojtjes mund të organizohet më së paku për 10 nxënës, të cilët vijnë në shkollë edhe nga vendet më të largëta. Koha e pranimit të fëmijëve në fund të mësimin në shkollë rregullohet sipas nevojave të prindërve, gjegjësisht fëmijët e tyre. Me rregullat e shkollës rregullohet edhe mënyra e marrjes së fëmijëve në fund të ditës së mësimin.

- Në shkollë organizohet qëndrimi i vazhdueshëm për nxënësit prej klasës së I -VI. Në këtë formë të organizimit të mësimin dhe aktiviteteve të fëmijëve vëmendje të posaçme do të nevojitet për nxënësit prej klasës së I deri të III. Gjatë kësaj nevojitet që numri i nxënësve në këto grupe të mos jetë më i madh se 25 fëmijë në grup.

- Duhet të rregullohen edhe të drejtat e fëmijëve për transportin deri në shkollë varësisht nga largësia e shkollës nga shtëpia ku jeton fëmija. Shkolla, prindërit dhe komuna (bashkësia lokale) dakordohen se si do të organizohet transporti për nxënësit për arrdhjen e tyre në shkollë. Gjithashtu, transporti planifikohet për nxënësit kur do të mbaron mësimi. Në rastet kur nxënësit janë në qëndrim të vazhdueshëm mësim tërëditor, atëherë prindërit do të duhet vetëm ta marrin fëmijën e tyre nga shkolla dhe të kujdesen për transportin e tyre deri në shtëpi.

- Me rregulloren duhet të rregullohet edhe e drejta e ankesës së nxënësit / prindërit për notën. Në fund të mësimin pas marrjes së dëftesës nëse prindëri dhe nxënësi mendojnë se në qoftë se në ndonjë lëndë nxënësi nuk është notuar

siç duhet, atëherë mund të dërgojnë ankesë me arsyetim. Për këto raste, lidhje me ankesën e nxënësit, do të jetë procedura të cilën do ta merr shkolla.

- Mbrojtja shëndetësore e nxënësve gjatë kohës së shkollimit përfshin:
  - zbatimin e kontrolave të detyrueshme mjeksore për fëmijët që janë regjistruar në klasën e I (kontollime të rregullta sistematike dhe vaksinime);
  - gjatë shkollimit vazhdojnë programet për vaksinim.

Ministria e Shëndetësisë çdo vit harton program me të cilin definohen llojet e vaksinave dhe moshat e fëmijëve.

- Vaksinimi bëhet në dispenserin e shkollës njëkohësisht me kontrollimet e obligueshme shkollore të cilat sipas rregullës, duhet të vendosen dhe mbahen çdo dy vjet. Gjatë realizimit të vaksinimit duhet të kontrollohet se a janë kryer me rregull të gjithë vaksinat të cilat janë të obligueshme për fëmijët dhe në përputhje me rezultatet e vërtetuar dhe vaksinimit. Në shkollë prindërit japin dokument për mbikëqyrje në të cilin janë të regjistruar të dhënat për vaksinimin e fëmijëve.

Nevojitet që të aplikohet librezë e posaçme shëndetësore për vaksinim dhe zhvillimin trupor të fëmijës. Aty duhet të vihen të dhënat për vaksinat për periudhën e tërësishme shkollore.

- Prindërit dhe shkolla mirren vesh për organizimin e ushqimit të fëmijëve në shkollë. Rregullisht duhet të kontrollohet cilësia e ushqimit që u jepet fëmijëve.

• E domosdoshme është që prindërit (kujdestarët) t'i përgatisin fëmijët për pjesëmarrje të sigurt në komunikacion. Nxënësit mund të marrin pjesë në komunikacion atëherë kur prindërit do të jenë të bindur se janë të aftë ta kuptojnë rrezikun në komunikacion dhe se i dijnë rregullat për sjelljen e këmbësorëve në komunikacion.

• Fëmijët në klasën e I duhet të jenë të shoqëruar deri në shkollë fillore dhe në shtëpinë e tyre. Fëmijët e moshës 7 vjeçare mund të shkojnë në shkollë pa shoqërim nëse për atë ka pajtim me shkrim nga ana e prindërve dhe në qoftë se fëmija jeton afër shkollës, e në rrugën pranë tij ka komunikacion të vogël.

Shkolla në bashkëpunim me institucionet tjera mund të ndërmer, masa preventive në komunikacionin rrugor, të organizojë siguri për fëmijët në pajtim me rregullat e caktuara.

Për sigurinë në mjedisin e shkollës duhet shumë më tepër të kujdeset pushteti vendor ku gjendet shkolla. Në rrugën që kalon për rreth shkollës doemos të përcaktohet shpejtësia më e madhe e lejuar e automjeteve, që të jenë të kujdesshëm vozitësit që t'i respektojnë kufizimet në komunikacion.

### **Masat edukative**

Shkolla krijon kushte jo vetëm për arsimimin por edhe për edukimin e fëmijëve. Edukimi i nxënësve zhvillohet me përmbajtjet, por edhe me shembujt e sjelljes që janë prezente në çdo moment në jetën e shkollës. Ndikim edukativ kanë edhe notat për suksesin në lëndët që i mësojnë fëmijët. Edukon çdo sjellje e arsimtarit, edukon çdo sjellje e mësuesit, edukojnë raportet ndërmjet nxënësve, madje edhe në mes nxënësve dhe prindërve. Edukon mjedisi i tërësishëm dhe jeta e shkollës, qëndrimi i përbashkët gjatë kohës së mësimi, gjatë kohës së pushimeve, gjatë kohës së aktiviteteve jashtëshkollore, ekskurzioneve, mësimi në natyrë etj.



Të gjithë në shkollë marrin pjesë në një proces të vetëm. Argumentet e përmendura tregojnë se në familje shkolla është mjedis i dytë ku nxënësit arrijnë përvojë sociale nga jeta e cila ka rëndësi të jashtëzakonshme edukative. Për formimin e rregullave dhe vlerave të përgjithshme qytetëruese, edukimi për tolerancë dhe respektimi i përkatësive, arsimtarët luajnë rol kyç me pikëpamjet e tyre demokratike dhe me shembujt e sjelljes personale. Ata edukojnë shumë më mirë nëse kanë bashkëpunim më të mirë me prindërit dhe bashkësinë e nxënësve të klasës. Me të gjitha rregullat njihet çdo nxënës. Me ata hollësisht njoftohen edhe prindërit.

Gjatë kësaj duhet të sillen rregulla për sjelljen e të punësuarëve dhe arsimtarëve në shkollë. Me këto duhet të caktohen masat për:

- vonesën në orë;
- mosrealizimin e orëve;
- pranimi i dhuratave (nga individë dhe të organizuar);
- përdorimi i notave të dobëta si mjet për disiplinë;
- ofendime gojore drejtuar ndaj individëve ose klasës në përgjithësi;
- kërcënime;
- dënimi fizik i nxënësve,
- shqetësime seksuale dhe keqpërdorime.

Tërheqjet më të lehta dhe më të rënda nga rregullat e shkollës që i bëjnë nxënësit dhe arsimtarët në shkollë, si dhe masat edukative për ata, sipas Ligjit për arsimin fillor, i cakton shkolla me rregullore të posaçme në aprovimin e të cilës marrin pjesë arsimtarët, nxënësit dhe prindërit.

## *XII. BOTIMI, ZGJEDHJA DHE VLERËSIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE DHE LITERATURA TJETËR SHKOLLORE*

Në arsimin fillor nëntëvjeçar vëmendje të posaçme do t'i kushtohet zgjedhjes dhe cilësisë të teksteve shkollore, doracakëve, revistave për fëmijë dhe literaturës tjetër për nxënësit.

Për përpilimin dhe botimin e teksteve shkollore do të vendosen standarde të larta në përputhje me Konceptin për tekst shkollor dhe programet shkollore. Përveç kësaj, Byroja e zhvillimit të arsimit në mënyrë të vazhdueshme do të punojë për vlerësimin e teksteve shkollore, doracakët dhe literaturës tjetër për punën edukativo-arsimore në shkolla fillore.

Në pajtim me Ligjin për arsimin fillor dhe Ligjin e Byrosë për zhvillimin e arsimit në kohë do të përgatiten plane për botimin e teksteve shkollore sipas fazave të zbatimit të Konceptit për arsimin fillor nëntëvjeçar. Gjatë kësaj, theks të veçantë do t'i përkushtohet zvogëlimit të ngarkesës së nxënësve.

Në këtë kuptim në periudhën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar do të shfrytëzohen vetëm tekstet shkollore kryesore për lëndët e detyrueshme në gjuhën maqedonishte, gjegjësisht shqipe, turke dhe serbe, matematikë dhe në njohjen e mjedisit.

Për të gjitha lëndët mësimore do të hartohen doracakë të veçantë për arsimtarët. Kjo praktikë do të zgjerohet edhe në periudhat e ardhshme arsimore në shkollën fillore.

Për këtë arsye do të nevojitet që Byroja e zhvillimit të arsimit në mënyrë të përshpejtuar t'i kryejë aktivitetet për vlerësimin e teksteve shkollore dhe

revistave shkollore dhe të jep mendim për përshtatjen e shkrimeve për tekst shkollor me programe mësimore me zbatim dhe zhvillim të metodologjisë (sistemi i procedurave, instrumenteve dhe kritereve) për vlerësimin e teksteve shkollore, doracakëve dhe literaturës tjetër që shfrytëzohet në shkolla.

Me ndryshimet e përmendura sistemore, si dhe me zbatimin konsekuent të dispozitave ligjore lidhur me tekstet shkollore do të rritet përgjegjësia e shkollës që të bëhet praktik deri në fund të vitit shkollor rregullisht të bëjnë zgjedhje të teksteve shkollore dhe të njoftohen prindërit dhe nxënësit se cilat libra do të shfrytëzohen në klasën vijuese.

Secila shkollë duhet ta merr përgjegjësinë për zgjidhjen e teksteve shkollore, ndërsa të dhënat për zgjidhjen e bërë rregullisht të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga të gjitha shkollat në Republikën e Maqedonisë më së voni deri më 25 qershor para se të fillojë pushimi veror.

### *XIII. MËNYRAT E APLIKIMIT TË NDRYSHIMEVE NË SISTEMIN SHKOLLOR*

#### **• Sigurimi i kushteve adekuate dhe gradualiteti**

Secili ndryshim në edukimin dhe arsimin parashkollor që është i lidhur me të arriturat e suksesit më të mirë mund të krijojë efekte të kundërta në qofë se paraprakisht nuk është kontrolluar dhe vlerësuar. Për këto arsye përpiqemi për përfshirje, gjegjësisht për aplikimin e ndryshimeve të planifikuara dhe të kuptimësuara mirë që janë kontrolluar dhe realizuar në praktikë. Për këtë arsye është theksuar kujdesi për përgatitjet e mësimit me përgatitjen e planit dhe programeve të reja mësimore, si dhe sigurimi i lokalit, pajisjes, kuadrit arsimor në kohë dhe trajnimi i tyre për zbatimin e programeve të reja mësimore.

Për zbatim të suksesshëm të programeve të reja mësimore në shkollë fillore duhet në mënyrë kritike të shqyrtohen dhe përfshihet përvoja që e kanë arritur shkollat edhe në vendet tjera. Gjatë kësaj shumë me rëndësi është përvoja që duhet të shfrytëzohet në raport me lidhjen e kopshteve dhe shkollave fillore, regjistrimi i fëmijëve në shkollë, mënyra e kalimit prej mësimit klasor në mësimin lëndor, përparimi i nxënësve gjatë shkollimit nëntëvjeçar, mënyra e ndjekjes dhe vlerësimi si dhe inkuadrimi i nxënësve në shkollë të mesme. Për zhvillimin më efikas të sistemit të arsimit dhe edukimit fillor është e nevojshme që të merren masa për inkuadrimin e tërësishëm të kopshteve fëmijërore nën kompetenca të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo zgjidhje është prezente në të gjitha vendet e zhvilluara, për shkak të lidhshmërisë së arsimit dhe edukimit parashkollor dhe fillor jo vetëm në mënyrë të organizuar, por edhe sipas qëllimeve dhe përmbajtjeve në sistemin arsimor në vend dhe shfrytëzimi racional i kushteve tjera kadrovike dhe hapsinore.

Gjatë aplikimit të elementeve të ndryshme në mësim dhe në aktivitete tjera në shkollë fillore duhet të ekziston plan i qartë dhe i zbatueshëm për të gjithë hapat që do të ndërmerren, si dhe për të priturat dhe efektet nga ato në përmirësimin e cilësisë në arsimin dhe edukimin fillor. Për këtë qëllim para fillimit të mësimit në secilën klasë nevojiten përgatitje meqë nuk do të jetë e mundshme të fillojë viti shkollor nëse nuk krijohen kushte normale për këtë, në qoftë se nuk janë të vërtetuara sipas programeve mësimore elemente tjera që e përbëjnë sistemin mësimor: format e ndryshme të individualizuara dhe puna në grupe, format e ndryshme të punës së individualizuar dhe punë grupore në mësim, format e shumta për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme

arsimore, përgatitjet e arsimtarëve, organizimi i transportit dhe qëndrimi i vazhdueshëm i nxënësve në shkollë dhe përgatitjet tjera të domosdoshme në mësim dhe mësimnxënie.

#### • **Përgjegjësia për cilësinë në arsim**

Veçantia e sistemit sigurohet me standardet e përgjithshme, programet mësimore dhe efektet/rezultatet e planifikuara dhe të realizuara.

Përgjegjësi të përbashkët për cilësinë në arsim kanë të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë në procesin mësimor dhe arsimor. Për këtë arsye paraqitet nevoja për vendosjen:

- bashkëpunimit të vazhdueshëm në mes të gjithë anëtarëve të kolektivit të shkollës me formimin dhe funksionimin të aktivave profesionale dhe ekipeve shkollë zhvillimore;

- bashkëpunimi në nivel lokal me formimin e ekipeve funksionale lokale;

- bashkëpunim të vazhdueshëm me bashkësinë lokale dhe më të gjerë shoqërore.

- Për cilësinë në arsim kontribuojnë të gjithë të interesuarit tjerët për arsim (prindërit, bashkësia lokale, asociacionet profesionale, radioja, mediat dhe asociacionet tjera). Me pjesëmarrjen e arsimtarëve, prindërve dhe bashkësisë lokale në programimin e punës së shkollës duhet të përmirësohet cilësia në arsim.

Me planifikimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore shkolla, gjithashtu, qëndron pas specifikave, karakteristikave dhe nevojave tjera të nxënësve të saj, prindërve dhe mjedisit lokal, ndërsa gjatë kësaj të mos shkatërrohet sistemi i arsimit dhe edukimit fillor.

Specifikat kulturore, gjuhësore dhe rajonale përfshihen në programin për punën në shkollë.

#### • **Zhvillimi i sistemit për ndjekjen e cilësisë në arsim**

